


RAPORT
PËR VLERËSIMIN E JASHTËM
INSTITUCIONAL DHE PROGRAMOR
TË
UNIVERSITETIT EUROPIAN TË TIRANËS

Grupi i Ekspertëve të Jashtëm:

Prof.As.Mimoza Cukalla, Kryetare



Prof.Kudret Çela, Anëtar



Msc Ridvan Hado, Anëtar



Diana Kalaja, Anëtar




Dr. Genta Skura, Anëtar



Prof.As. Petrit Nathanaili, Anëtar




Dr.Gjon Boriçi, Anëtar



Dr.Diana Lamani, Anëtar



Prof.As. Mimoza Kasimati, Anëtar




Tirane, me 29 Qershor 2009

Detyrat e Grupit të Vlerësimit të Jashtëm:

Vlerësimin Institucional dhe Kryetare e GVJ (zgjedhur nga vetë GVJ)


Prof.As.Mimoza Cukalla; Kryetare e degës mësimore, UPT



Vlerësimi: Drejtësi

Prof. Kudret Çela; Jurist, Fakulteti i Drejtësisë, UT

Msc Ridvan Hado; Gjyqtar



Vlerësimi: Marrëdhënie Publike-Komunikim

MA. Diana Kalaja

Zv. Drejtore e Përgjithëshme, Radio Televizioni Shqiptar.

Dr. Genta Skura

Pedagoge, Fakulteti Histori Filologjia, UT




Vlerësimi: Marrëdhënie Ndërkombëtare

Prof. As. Petrit Nathanaili, Pedagog, Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë, UT

Dr. Gjon Boriçi

Akademia Diplomatike Shqiptare



Vlerësimi: Financë-Bankë; Menaxhim Biznesi

Dr. Diana Lamani

Pedagoge, Fakulteti Ekonomik, UT

Prof.As. Mimoza Kasimati

Pedagoge, Fakulteti Ekonomik, UT



PËRMBAJTJA

1. Baza ligjore e aktivitetit të GVJ
2. Metodologjia
3. Baza ligjore e aktivitetit të UET
4. Të dhëna të përgjithshme për UET
5. Struktura organizative
6. Dokumentacioni bazë i Institucionit. Përgjegjësitë , Vendimmarrja
7. Analizë e proceseve të menaxhimit, edukimit dhe shkencore të UET
8. Analiza e programeve të studimit
9. Përfundime dhe rekomandime

SHKURTIME:

UET	Universiteti European i Tiranës
APAAL	Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë
MASH	Ministria e Arsimit dhe Shkencës
SWOT	Pikat e Forta, Pikat e Dobëta, Oportunitet dhe Kërcënimet
GVB	Grupi i Vlerësimit të Brendshëm
RVB	Raporti i Vlerësimit të Brendshëm
GVJ	Grupi i Vlerësimit të Jashtëm
RVJ	Raporti i Vlerësimit të Jashtëm
KSBC	Komisioni i sigurimit të brendshëm të cilësisë



1. Baza ligjore e aktivitetit të GVJ

Baza ligjore për vlerësimin e jashtëm të cilësisë është:

- Ligji Nr. 9741, dt 21.05.2007 "Për Arsimin e Lartë në RSh", (Nenet 60, 61 si dhe aktet e tjera nënligjore). Sigurimi i jashtëm i cilësisë, sipas këtyre dispozitave, realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të cilësisë dhe Akreditimit, i cili kryhet nga Agjencia Publike e Arsimit të Lartë ose agjenci të tjera akreditimi, pjesë e Rrjetit European për sigurimin e cilësisë në Arsimin e Lartë (ENQA).
- Vendimet e Këshillit të Ministrave për hapjen e programeve të studimit pranë UET.
- Udhëzimet e MASH_it për projektimin e programeve të studimit, për hapjen dhe funksionimin e institucioneve private të arsimit të lartë, për transferimin dhe njohjen e krediteve, për administrimin e dokumentacionit, etj,
- Standardet dhe udhëzuesit për sigurimin e cilësisë në ZEAL (ENQA)
- Udhëzuesin mbi vlerësimin e jashtëm të cilësisë në arsimin e lartë (APAAL)
- Aspektet dhe treguesit e vlerësimit të cilësisë në Arsimin e Lartë (APAAL)

2. Metodologjia


Ky raport është mbështetur në:

- Shqyrtimin e Raportit të Vlerësimit të Brendshëm, të hartuar nga grupi i vlerësimit të brendshëm të UET.
- Shqyrtimin e dokumentacionit bazë mbi të cilën organizohet e gjithë veprimtaria e universitetit (statuti, rregullore dhe udhëzime, dosjet e programeve të studimit, regjistrat themeltar, dokumentacioni i zyrës se burimeve njerëzore dhe financës, arkivës, sekretarisë mësimore).
- Vëzhgimet e kryera gjatë vizitës në vend si dhe në intervistimet e studentëve, pedagogëve, stafit drejtues të universitetit, stafit administrativ.

Gjatë vizitës në vend u realizuan takime me Rektorin e Universitetit, Dekanet e Fakulteteve: Shkencave Sociale, Juridik dhe Ekonomik, Grupin e Vlerësimit të Brendshëm, drejtuesit e njësive bazë si dhe stafin pedagogjik të këtyre fakulteteve, studentë, punonjësit e sekretarisë mësimore, administratës, arkivës etj. Gjithashtu u bë vizitë në mjediset mësimdhënëse të këtij universiteti, në bibliotekën e fakultetit, sallën e kompjuterave.

Në verifikimin e të dhënave u përdor përgjithësisht metoda e marrjes së mostrës, duke nxjerrë në mënyrë të rastësishme kampionet për verifikim. Megjithatë, në rastet të veçanta, ku dokumentacioni ishte jo voluminoz, është bërë verifikimi i të gjithë dokumentacionit (dosjet e stafit akademik, kontratat e punës, etj.). Gjykimi i grupit të punës u mbështet, ndërmjet të tjerave, edhe në intervistat e marra nga grupet e ndryshme të interesit (si: drejtues, GVB, stafi pedagogjik, studentë, punonjës të administratës, etj).

GVJ vlerëson angazhimin maksimal të drejtuesve të institucionit për të organizuar sa më mirë aktivitetet e kryera në mjediset e UET. Në të gjitha njësitë organizative u konstatua një vullnet i mirë për të qenë të hapur ndaj çdo kërkesë në lidhje me vlerësimin dhe për të vënë në dispozicion të gjithë dokumentacionit të kërkuar. GVJ punoi në kushte optimale për të realizuar misionin e tij.



Vlerësimi u krye në dy drejtime:

- a) Vlerësim Institucional dhe
- b) Vlerësim i Programeve të studimit të ciklit të parë në:
 1. Juridik i përgjithshëm i shoqëruar me profilet "E drejtë biznesi", "E drejtë Publike dhe Kushtetuese", "E drejtë Ndërkombëtare dhe Europiane".
 2. Marrëdhënie publike-komunikim
 3. Shkenca Politike
 4. Marrëdhënie Ndërkombëtare
 5. Financë-bankë
 6. Menaxhim Biznesi

Vlerësimi institucional u përqëndrua në aspektet ligjore, në organizimin strukturor të universitetit, organet kolegjinale, planet strategjike të zhvillimit të universitetit, ndarja e përgjegjësive dhe vendimmarrja, dokumentacioni bazë që rregullon aktivitetet e Universitetit, sistemi i cilësisë në universitet, menaxhimi i procesit mësimor, provimeve, menaxhimi financiar, menaxhimi i burimeve njerëzore, menaxhimi i teksteve, menaxhimi i hyrjeve në universitet, etj.


Vlerësimi i programeve të studimit u përqëndrua në analizën e programit të studimit, objektivave formues, kompetencat që fitohen, përputhshmëria e titullit të lëshuar me kurrikulën e ofruar, mënyrën e organizimit të kurrikulës, analiza e syllabuseve (programet e lëndëve), format e veprimtarive formuese për çdo disiplinë, mënyra e organizimit të vlerësimit të dijeve, kompetenca e stafit pedagogjik, literatura e përdorur etj.

3. Baza ligjore e Aktivitetit të UET

Shkolla e Lartë Universitare Private "Universiteti Europian i Tiranës" është person juridik i njohur me Vendimin Nr. 36117, Datë 07.07.2006 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ndryshuar me Vendimin Nr. 36117/1, Datë 05.04.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, i ndryshuar me Vendimin e Gjyqtarit të Vetëm, Nr. 36117/2, Datë 05.07.2007.

Shkolla e Lartë Universitare Private " Universiteti Europian i Tiranës" kryen aktivitetin e saj mbi bazën e dokumentave bazë ligjore të mëposhtëme:

- Në bazë të VKM Nr. 636, datë 20.09.2006, ofron këto programe studimi të ciklit të parë, Diplomë e Nivelit të Parë (DNP):
 1. DNP "Jurist i përgjithshëm," ose i shoqëruar me profilet:
 - a. Juridik biznesi
 - b. Juridik, e drejta publike dhe kushtetuese
 - c. Juridik, e drejta europiane dhe ndërkombëtare
 2. DNP "Komunikim – Marrëdhënie publike"
 3. DNP "Shkenca politike"



4. DNP "Marrëdhënie ndërkombëtare"
 5. DNP "Gazetari"
- Në bazë të VKM Nr. 255, datë 27.02.2008, ofrohen programe studimi:
 6. DNP "Ekonomik"
 7. DNP "Financë Bankë"
 8. DNP "Menaxhim Biznesi"
 9. DNP "Administrim publik."
 - VKM Nr.74, datë 21.01.2009, për "Hapjen e programeve të reja të studimit, të ciklit të dytë pranë shkollës së lartë Universitare private "Universiteti Europian i Tiranës" ofron programe studimi: Diplomë e Nivelit të Dytë në 7 programe studimi me 13 profile dhe Master i Nivelit të Parë në 11 programe studimi me 19 profile.

Programet e studimit "Ekonomik", "Administrim Publik" në fakultetin Ekonomik dhe "Gazetari" në Fakultetin e Shkencave Sociale nuk janë aktivizuar ende.

4. Të dhëna të përgjithshëm për UET

UET ofron në ciklin e parë 9 programe studimi DNP, nga të cilat deri tani janë aktivizuar 6 prej tyre (të cilat janë dhe objekt i këtij vlerësimi), në ciklin e dytë 7 programe studimi Diplomë e Nivelit të Dytë me 13 profile dhe 11 programe studimi Master i Nivelit të Parë me 19 profile.

Numri i përgjithshëm i stafit akademik të brendshëm dhe të jashtëm është përkatesisht 35 me 96, numri aktual i studentëve që ndjekin studimet në ciklin e parë është 1261 (nga 1354 të regjistruar për tre vjet) dhe numri i punonjësve të administratës është 39. Sipërfaqja totale e godinës në të cilën zhvillon veprimtarinë e tij UET-i është 5600 metra katror. Në nivel universiteti raporti pedagog efektiv/student veprimtarinë e tij UET-i është 5600 metra katror. Në nivel universiteti raporti pedagog efektiv/student është 1:36, ndërsa raporti staf akademik (brendshëm dhe të ftuar)/student është 1:9.6. Stafi administrativ përbën 29% të stafit akademik. Sipërfaqja e shfrytëzueshme për student është 4.44m²/student, që është në kufijtë minimal të standardeve të vendosura nga MASH, por mëse i përshtatshëm (të paktën për numrin e studentëve aktualë) për natyrën shoqërore të programeve të studimit që ofron ky institucion. Organizimi i mësimdhënjes në grupe leksionesh e seminaresh bëhet sipas kriterëve të dhëna në Udhëzimin e MASH Nr.30, datë 26.09.2007. Theksojmë se në këta tregues nuk janë marrë në konsideratë numri i studentëve të regjistruar në ciklin e dytë (MNP apo DND). Sallat janë të pajisura me mjetet e nevojshme didaktike në ndihmë të mësimdhënjes, si: tabela porcelani, flip charter, lidhje internet me dhe pa kabëll, kompjuter, video projektor, si dhe me sistem modern fonie fiks dhe të lëvizshëm. Sekretaria është e pajisur me një softëare për të menaxhuar orarin e mësimdhënjes dhe të provimeve. Kjo ka sjellë një menaxhim mjaft të mirë të të gjitha sallave të mësimdhënjes, të cilat kanë një kapacitet mbajtës në total me rreth 1200 vende. Sallat e mësimdhënjes kanë lartësi dhe ndriçim mjaft të mirë, gjë që i bën ato të përshtatshme për një zhvillim normal të mësimi.

Koment: Duke analizuar treguesit e mësipërm konstatojmë se deri tani infrastruktura e mësimdhënjes është e përshtatshme për numrin aktual të studentëve. Por nëse do të parashikohen edhe studentët e ciklit të dytë (MNP dhe DND), si dhe prurjet e reja në DNP, për vitin e ardhshëm akademik infrastruktura nuk do t'i përgjigjej rritjes së numrit të studentëve. Drejtuesit deklaruan për përshtatjen e një godine shtesë në mjedise mësimdhënëse.

5. Struktura Organizative

Shkolla e lartë universitare jopublike "Universiteti European i Tiranës" përbëhet nga pesë njësi kryesore: tre fakultete dhe dy institute:

- Fakulteti Juridik
- Fakulteti i Shkencave Sociale
- Fakulteti Ekonomik
- Instituti i Studimeve Sociale dhe të Politikave
- Instituti i Studimeve Historike

Struktura organizative jepet në Organigramën e Universitetit. Çdo Fakultet ka dy departamente dhe një qender. Menaxhimi i procesit mësimor në fakultete kryhet nga koordinatori i fakultetit, ndersa në nivel universiteti kryhet nga sekretari i përgjithshëm. Nën varësi të sekretarit të përgjithshëm janë sekretaria mësimore si dhe ato njësi administrative që lidhen me procesin mësimor si: zyra e kurrikulave, zyra e aktiviteteve, e karrierës, projekteve, arkiva-protokolli, etj. Sekretaria mësimore qëndrore mirëmban të gjithë regjistrat e procesit mësimor: regjistrin themeltar, regjistrin e amzës, procesverbalet e provimeve, regjistrat e mësimdhënjes, frekuentimin e pedagogëve, dosjet e studentëve. Në sekretari depozitohen edhe provimet e studentëve.

Në organigramë është e ndarë qartë linja akademike që kryesohet nga senati akademik dhe rektori me linjën administrative-financiare që kryesohet nga administratori dhe kancelari. Bashkëpunimi ndërmjet linjës financiare dhe linjës akademike realizohet nga administratori (sipas varësisë së shprehur në organigramë).

Organet kolegjiale këshillimore dhe vendimmarrëse në nivel Universiteti janë përkatësisht Bordi i Besimit dhe Senati Akademik, ndërsa në nivel fakulteti janë Këshillat e Fakulteteve, të cilat janë në proces formësimi e sipër. Autoritetet drejtuese në linjën akademike/shkencore përbëhen nga rektori, dekanët dhe përgjegjësat e departamenteve.


Stafi i brendshëm akademik, 35 gjithsej, kryen aktivitetin e vet mësimor shkencor i organizuar nëpër departamente pranë tre fakulteteve, të shpërndarë si më poshtë:

Fakulteti i shkencave sociale ka 16 pedagogë, staf akademik efektiv

Fakulteti juridik ka 9 pedagogë, staf akademik efektiv

Fakulteti ekonomik ka 10 pedagogë, staf akademik efektiv

Koment: Nga sa më sipër standardet numerike për funksionimin e një fakulteti apo departamenti nuk plotësohen nga të gjitha njësitë kryesore dhe njësitë bazë. Përjashtim bën Fakulteti e Shkencave Sociale me dy departamentet e tij: Departamenti i Shkencave Politike dhe Marrëdhënjeve Ndërkombëtare, dhe Departamenti i Gazetarisë dhe Komunikimit, të cilët plotësojnë standardet numerike të njësisë bazë dhe të stafit efektiv me tituj e grada. Për më tepër theksojmë se një numër i madh postesh drejtuese ka bërë që në UET nga 35 pedagog staf i brendshëm akademik të paktën 18 janë drejtues (afërsisht gjysma e tij). Kjo u konstatua edhe nga takimet e kryera me drejtues të niveleve të ndryshme të universitetit dhe stafin akademik. Megjithatë duhet të theksojmë se në UET po bëhet një punë e mirë për rekrutimin e stafit, gjë që reflektohet edhe me dinamikën e rritjes së numrit të stafit të brendshëm akademik nga krijimi deri tani, rritje që ka shkuar proporcional me zhvillimin e universitetit. Këtë e tregon edhe raporti pedagog i



brendshëm/student i cili në tre vjet është luhatur në diapazonin nga 1/25 deri në 1/36 si dhe raporti staf akademik/student i cili luhatet në kufijtë nga 1/6 deri 1/9.6. Gjatë tre viteve të aktivitetit në UET është ruajtur një raport përgjithësisht i njëjtë midis stafit të brendshëm dhe atij të jashtëm, si dhe midis stafit akademik dhe studentëve.

Pranë universitetit janë ngitur dy institute dhe pranë çdo fakulteti janë ngritur qendrat e kërkimit. Duhet theksuar se pavarësisht aktiviteteve që janë zhvilluar këto njësi nuk kanë marrë formën e tyre të plotë si njësi organizative. Ato kanë nga një drejtues dhe personel fluid, që është njëkohësisht edhe në departament edhe në qendër ose Institut. Theksojmë se ngritja e strukturave që do të jenë bazë e punës shkencore në universitet është një aspekt që duhet përshëndetur. Për të ardhmen universiteti duhet të fokusohet drejt dhënjes këtyre njësive fizionominë e plotë si qendra të mirëfillta kërkimi.

Si rezultat i numrit jo të madh të stafit akademik efektiv nëpër departamente, jeta e brendshme e departamentit dhe vendimmarrja realizohet me pjesëmarrjen e tërë njësisë. Departamenti mbledhet për probleme të ndryshme, gjë që është reflektuar edhe në proceverbalet e mbajtura rregullisht. Gjykojmë se me zhvillimin e mëtejshëm të departamenteve, rritjen e numrit të stafit të brendshëm, organizimi i jetës së brendshme të departamentit mbi bazën e grupeve mësimore shkencore do të ishte mjaft efektive.

UET të vendosë në prioritetet e tij plotësimin e standardeve numerike për funksionimin e njësive kryesore dhe njësive bazë, si dhe konsolidimin e tyre.


6. Dokumentacioni bazë i Institucionit. Përgjegjësitë dhe Vendimmarrja

Jeta e brendshme e Universitetit rregullohet nëpërmjet disa dokumenteve bazë: **Statuti, rregullorja mësimore dhe një sërë dokumenta të tjera (rregullore, udhëzime e kode) në zbatim të tyre.** Statuti është i ripunuar mbështetur në Ligjin Nr.9741, dt.21.05.2007 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. Në këto dokumenta përcaktohen:

- Përgjegjësitë dhe autoritetet vendimmarrëse, në të gjitha organet drejtuese qofshin këto kolegjinale apo monokratike.
- Organizimi i jetës së brendshme akademike: organizimi i studimeve, aktiviteteve mësimore, shkencore, shërbime etj.
- Rregullat e menaxhimit të procesit mësimor
- Rregullat e menaxhimit të jetës studentore
- Rregullat e menaxhimit të burimeve njerëzore, infrastrukturës, financave etj.

Në bazë të statutit të UET drejtimi në universitet realizohet nga organe kolegjinale, të cilat janë drejtuese ose këshilluese si dhe nga autoritetet drejtuese. Si organe kolegjinale në statut janë përcaktuar:

- Bordi i besimit (organ këshillimor i administratorit dhe senatit akademik)
- Senati akademik (organ kolegjal vendimmarrës)
- Rektorati (organ kolegjal ekzekutiv)
- Këshillat e fakulteteve (organ kolegjal vendimmarrës)
- Këshilli i etikës
- Këshilli i profesorëve



- Komiteti shkencor për organizimin e masterave.

Autoritetet drejtuese që veprojnë në UET janë:

- Rektori
- Dekani
- Drejtori i Institutit
- Përgjegjësi i departamentit/qendrës së kërkimit dhe zhvillimit

Bordi i besimit është një organ konsultativ i përbërë personalitete të fushave të ndryshme. Përbërja dhe numri i anëtarëve të Bordit përcaktohet me **vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve**. Funkcionet kryesore të Bordit të Besimit janë:

1. **Konsultim mbi zgjedhjet dhe politikat e UET-it.**
2. **Konsultim mbi projektet e zhvillimit.**
3. Lobim për imazhin e UET-it dhe lidhjet e UET-it me tregun e punës.
4. Lobim për sa i përket politikave të arsimit të lartë në Shqipëri.
5. **Jep pëlqimin për kandidaturën e Rektorit.**

Koment: Ngritja dhe funksionimi i një bordi këshillimor me personalitete të fushave të ndryshme synon në vendosjen e kontakteve të vazhdueshme dhe realizimin e lidhjeve më të mira me tregun e punës dhe përfaqësues të palëve të interesuar, gjë që siguron burime të përshtatshme informimi në lidhje me nevojat e tregut të punës. Nga ana tjetër bordi bëhet edhe pjesë e lobimit dhe e marketingut për UET. Kjo kërkon mjaft kujdes në menaxhim dhe në vendosjen e kufijve ndarës të qartë ndërmjet rolit të bordit këshillimor dhe senatit akademik. Risku i vendosjes së bordit mbi senatin akademik është një rrezik potencial, gjë që mund të çojë në asfiksimin e organeve kolegjinale vendimmarrëse dhe në ngushtimin e sferave të veprimtarisë së tyre, duke cënuar elementët e autonomisë së brendëshme dhe të lirisë akademike.

Senati Akademik është organ kolegjal vendimmarrës për çështje të drejtimit dhe të organizimit të veprimtarisë akademike në UET. Senati programon, bashkërendon, drejton dhe kontrollon veprimtaritë e mësimdhënies e të kërkimit shkencor dhe vlerëson efikasitetin e tyre. Senati Akademik drejtohet nga Kryetari i Senatit i cili është Rektori. Në bazë të statutit Senati Akademik përbëhet nga së paku 13 anëtarë. Anëtarë të Senatit Akademik të UET-it janë Rektori, Dekanët e Fakulteteve, të emëruar për shkak të detyrës, të cilët nuk përbëjnë më shumë se 1/3 e anëtarëve; anëtarët e zgjedhur, të cilët përbëjnë jo më pak se 2/3 e anëtarëve, janë përfaqësues të personelit mësimor shkencor të brendshëm dhe të jashtëm të zgjedhur nga departamentet, përfaqësues të Asamblesë së Ortakëve me status akademik, një përfaqësues nga këshilli studentor i institucionit/kryetari, i cili përfaqëson studentët në senat. Vendimmarrja për çështje brenda kompetencave të tij bëhet me shumicë të thjeshtë (50%+1) të votave të anëtarëve pjesëmarrës, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë statut. Senati i zhvillon mbledhjet e tij nëse sigurohet kuorumi i nevojshëm prej 2/3 të anëtarëve.

Koment: Aktualisht, mbështetur në listën e anëtarëve të senatit akademik për vitin akademik 2008-2009, vene ne dispozicion nga UET, senati ka në përbërjen e tij: 8 të brendshëm, 4 të jashtëm (nga të cilët një është prind) dhe 1 student. Nga stafi i brendshëm janë të gjithë drejtuesit e universitetit (administrator, rektor, dekanë dhe drejtor të instituteve, gjithsej 6), si dhe 2 përfaqësues të pedagogëve. Nga anëtarët e jashtëm 2 kanë statusin e stafit akademik të ftuar. Kjo do të thotë se në 13 anëtarë të senatit akademik 4

prej tyre zgjidhen nga komuniteti i stafit akademik (i brendshëm dhe i ftuar), 1 përzgjidhet nga komuniteti i studentëve, 1 nga komuniteti i prindërve, ndërsa të tjerët janë drejtues të niveleve të ndryshëm të universitetit. Duke parë me kujdes përbërjen e senatit rezulton se drejtuesit e niveleve të ndryshëm të universitetit përbëjnë rreth 46% të senatit, përfaqësues të stafit akademik vetëm 31% të senatit dhe përfaqësuesit e komunitetit të studentëve, prindërve dhe tregut përbëjnë 23%. Gjykojmë se në të ardhmen në përbërjen e senatit akademik duhet të rritet përfaqësimi nga stafi akademik, në përputhje me kërkesat e statutit, duke ruajtur një barazpeshë përfaqësimi ndërmjet fakulteteve. Kjo është e nevojshme për të siguruar një mekanizëm të balancuar votimi në vendimmarrje. Me rritjen e numrit të studentëve si dhe hapjen e ciklit të dytë të studimeve, duhet të ketë një përfaqësim më të madh nga studentët. Nga ana tjetër duke qenë se bordi i besimit ka përfaqësues të ndryshëm të tregut të punës, personalitete të fushave që mbulon universiteti, gjykojmë se në senat nuk ka pse të futen përfaqësues të prindërve apo të tregut të punës. Senati është organ pune kolegjiiale vendimmarrëse e universitetit që mbulon gjithë aktivitetin akademik dhe shkencor të tij. Si i tillë ai duhet të ketë të përbërje të gjithë aktoret e procesit edukativ që janë drejtuesit, stafi akademik, stafi administrativ dhe studentët.

GVJ gjykon se duhet të përmirësohen raportet e përfaqësimit në senatin akademik për të siguruar një mekanizëm të balancuar votimi në vendimmarrje dhe një përfaqësim më të madh të studentëve.

Në statutin e Universitetit shprehen funksionet kryesore të senatit akademik, të cilat në përgjithësi janë në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë," i ndryshuar. Do të ndalem vetëm në dy funksione për t'i komentuar:

- a. Miraton projekt-buxhetin e institucionit UET, të përgatitur nga rektorati dhe ia paraqet për miratim sipas kompetencave, Asamblesë së Ortakëve.


Koment: Ky funksion i senatit akademik me organigramen ekzistuese është e vështirë të realizohet. Sipas organigramës linja e administrimit financiar nuk është nën varësi të rektoratit, por të administratorit, i cili është pika kyçe që realizon lidhjen ndërmjet linjës akademike dhe asaj financiare. Gjykojmë se në këtë drejtim duhet të saktësohet i gjithë procesi i hartimit të projektbuxhetit të UET si dhe të përcaktohen më mirë funksionet dhe përgjegjësitë e njësive bazë, njësive kryesore dhe njësive të tjera administrative, për të bërë të mundur hartimin e një projektbuxheti sa më real dhe në përputhje me nevojat e njësive kryesore të universitetit.

- b. Miraton planin disaveçar të zhvillimit të institucionit dhe programin vjetor të veprimtarive të tij.
- c. Shpreh mendime në lidhje me programet e zhvillimit të UET-it.

Koment: Këto dy funksione duhet të saktësohen duke shprehur qartë se cili është organi që harton strategjinë e zhvillimit, cili është organi që e miraton atë, dhe kush është përgjegjës për zbatimin e strategjisë në plane një vjeçare dhe disa vjeçare dhe miratimin e tyre. Gjithashtu të specifikohet roli i bordit të besimit në këtë proces, si organ konsultativ.

UET duhet të saktësojë disa nga funksionet e senatit në lidhje me projektbuxhetin, programet dhe planet disaveçare të zhvillimit si dhe autoriteti vendimmarrës për këto procese.

Në vizitën e kryer në mjediset e universitetit GVJ gjeti dokumentacion të gjerë në lidhje me funksionimin e senatit që në konstituimin e tij. Kështu në arkivën e UET u verifikuan proceverbale të mbledhjeve të senatit, si dhe plani i punës i tij. **U konstatua që senati është mbledhur rregullisht që me krijimin e tij (2006-2007), problematikat dhe vendimmarrja ka qenë brenda funksioneve të senatit të përshkruar në statut, vendimet e senatit janë zbardhur rregullisht. Kjo është për t'u përshëndetur pasi tregon se ky organ kaq i rrëndësishëm kolegjiial në drejtimin e universitetit, ka qenë mjaft aktiv dhe ka luajtur rolin e duhur në jetën akademike të UET.**



Këshillat e Fakulteteve nuk kanë marrë formën e tyre të plotë. Deri tani vendimmarrja në nivel fakulteti është realizuar nga drejtuesit e njësive kryesore në bashkëpunim me ata të njësive bazë. Kjo është rrjedhojë e vetë dinamikës së rritjes që ka patur universiteti, i cili në fazat e para, nuk mund të krijojë të gjitha strukturat dhe organet kolegjiale. Por me rritjen e tij del e nevojshme formësimi dhe konsolidimi i këtyre organeve. Gjykojmë se krijimi i këshillave të fakulteteve dhe konstituimi i tyre duhet të përbëjë një nga përparësitë e UET në një të ardhme të afërme. Është për t'u përshëndetur fakti që në statutin e universitetit janë përcaktuar funksionet e këshillave të fakulteteve, gjë që tregon se për universitetin është prioritet ngritja e tyre. Megjithatë duhet të theksojmë që është e nevojshme të bëhet rishikimi i këtyre përgjegjësive që të mos ketë përplasje me përgjegjësitë e njësive të tjera organizative, konkretisht me atë të zyrës së zhvillimit të kurrikulave për programet e studimit.


Në statutin e universitetit shprehen funksionet dhe përgjegjësitë e zyrës së Zhvillimit të Kurrikulave nëpërmjet së cilës administrohen të gjitha programet e studimit në të gjitha nivelet. Konkretisht, **në bazë të statutit**, zyra e zhvillimit të kurrikulave merret me:

- a. përgatitjen e programeve të reja të studimit për të gjitha nivelet,
- b. me rishikimin e programeve të liçensuara që ofrohen në UET
- c. në bashkëpunim edhe me tregun e punës, sugjeron ndryshime dhe përmirësime të kurrikulave dhe ia paraqet për miratim strukturave përkatëse.
- d. Zyra **mund të kërkojë edhe mendimin** e ekspertit, sipas fushës dhe problematikës, në përgatitjen e materialeve të kërkuara, ose të raporteve të vlerësimit.
- e. Vlerëson propozimet e Bordit të Besimit ose të subjektit juridik për hapjen e programeve të reja të studimit, ndryshimin ose riorganizimin e programeve ekzistuese, dhe përgatit një raport vlerësimi.
- f. Mbështet Komisionin e Sigurimit të Brendshme të Cilësisë në rastet e përgatitjes së raporteve për vlerësime të programeve të studimit

Koment: Si sigurohet liria akademike brenda universitetit, kur përgatitja e programeve të reja të studimit, rishikimi i programeve ekzistuese nuk bëhet nga njësitë kryesore (fakultetet), por nga punonjësit e një zyre (që në fakt është 1 person). Nga ana tjetër edhe bashkëpunimin me ekspertët kjo zyrë e ka fakultative (shprehja **mund**). Nuk është e qartë se kush përgatit raportet e vlerësimit të programeve të studimit Zyra e kurrikulave apo komisioni i sigurimit të brendshëm të cilësisë, pika "e" dhe "f". Në përshkrimin e funksioneve të zyrës së zhvillimit të kurrikulave dhe komisionit të sigurimit të brendshëm të cilësisë në lidhje me rishikimin dhe vlerësimin e programeve të studimit. Propozimet e bordit të besimit për hapjen e programeve të reja vlerësohen nga zyra e zhvillimit të kurrikulave, ndryshimi dhe riorganizimi i programeve ekzistuese menaxhohet nga kjo zyrë, gjë që bie në kundërshtim me statutin, pika 22.2,b dhe anashkalon rolin e njësive kryesore të universitetit.

Meqenëse zyra e kurrikulave është krijuar vetëm në prill 2009 (sipas komenteve me shkrim të UET), universiteti duhet të rishikojë edhe një herë funksionet dhe përgjegjësitë e kësaj zyre në statut. Në stadin aktual dhe atë perspektiv të zhvillimit, universiteti duhet të ngrejë mekanizma shumë të qartë dhe formal për projektimin, monitorimin dhe rishikimin periodik të programeve të studimit për të shmangur përplasjen e përgjegjësive dhe për të përfshirë strukturat akademike në këtë proces.

GVJ gjykon se duhet të merren masa për të konsoliduar këshillat e fakulteteve duke rishikuar edhe një here përgjegjësitë në lidhje me hartimin, rishikimin periodik dhe ndryshimin e programeve të studimit, duke shmangur përplasjet e përgjegjësive me zyrën e zhvillimit të kurrikulave.



- 11 -

7. Analiza e proceseve të menaxhimit, edukimit dhe shkencore të UET

Grupi i Vlerësimit të Brendshëm (GVB) është ngritur me vendim të Senatit të Universitetit në datë 02.03.2009. Në përbërjen e tij ishin: 1. Dr. Tomi Treska (kryetar i GVB), përgjegjës i Departamentit të Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare; 2. Dr. Kreshnik Bello (sekretar), përgjegjës i Departamentit të Biznesit dhe Administrimit; 3. Doktorante Migena Leskoviku (anëtar), përgjegjës departamenti, i komanduar në Departamentin e të Drejtës Publike, 4. MA Elda Papa (anëtar), sekretare e përgjithshme, 5. Dr. Nevila Xhindi (anëtar), eksperte e jashtëme, 6. Ervin Salianji (anëtar), student.

Koment: Në përbërje të Grupit të Vlerësimit të Brendshëm janë të gjithë drejtues njësisish organizative, gjë që përbën konflikt interesi. Raporti i vetëvlerësimit është shqyrtuar nga senati akademik. Stafit akademik ishte i mirëinformuar në lidhje me procesin.

Raporti pasqyron të dhëna reale të mbështetura nga një dokumentacion i plotë për të gjitha aktivitetet e deklaruara. Grupi i vlerësimit të jashtëm gjeti një dokumentacion të plotë për të gjitha aspektet e vlerësimit në RVB. Nga pikëpamja përshkrimore, raporti është i plotë në shumicën e kapitujve të tij. Gjykojmë se analiza e programeve të studimit duhej të bëhej më e detajuar për përmbajtjen dhe cilësinë e programeve të studimit dhe jo në trajtë përgjithësuëse përshkruese siç jepet në raport. Do të ishte më mirë që RVB të hartoheshin mbi bazën e vlerësimit të brendshëm institucional të fakulteteve dhe jo përgjithësuëse për universitetin. Raportit i mungon fryma analizuëse, gjë që reflektohet edhe në analizën swot që e mbyll atë.

Në mënyrë më të detajuar analizën e aktiviteteve të kryera do ta bëjmë në përputhje me strukturën e raportit si më poshtëvijon:

7.1 MISIONI DHE OBJEKTIVAT


a) Qëllimet dhe objektivat e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor

Qëllimi themelor i UET-it **në fushën e mësimdhënies** është transmetimi tek studentët i një informacioni sa më cilësor e bashkëkohor në të gjitha disiplinat mësimore e lëndët me karakter të theksuar praktik, me synim përgatitjen e studentëve cilësorë, të aftë që të analizojnë dhe konkludojnë në mënyrë të pavarur, të aftë që të debatojnë e marrin vendime të sakta, të aftë që të orientohen menjëherë përballë tërësisë së informacioneve dhe specifikave të sektorëve e degëve ku ata specializohen.

Koment: GVJ konstatoi se universiteti punonte me seriozitet për realizimin e këtij qëllimi, gjë që shprehej në disa drejtime si p.sh. përpunimi e seleksionimi i programeve të disiplinave sa më cilësore për çdo lëndë, përdorimi i literaturës bazë dhe plotësuese libra, autorë dhe shtëpi botuese nga më të spikaturat e fushës, përdorimi i metodave e formave didaktiko-pedagogjike moderne e interaktive, trajnimi i vazhdueshëm i stafit pedagogjik dhe atij ndihmës administrativ, realizimi i kontakteve të vazhdueshme me studentët nëpërmjet tutoriatit dhe këshillimit akademik.

Qëllimi kryesor **i kërkimit shkencor** është pjesëmarrja dhe aftësimi i pedagogëve në procesin e kërkimit shkencor, angazhimi i tyre sa më i gjerë në botime e studime shkencore, organizimi periodik i konferencave shkencore nga çdo departament, botimi i katër revistave shkencore (Polis, Jus & Justicia, Economicus, "Sociological Analysis" (Studime sociologjike, në anglisht), botimi i monografive, teksteve mësimore apo studimeve të realizuara nga pedagogët, etj.

Koment: Në UET janë ngritur struktura për kërkimin shkencor si Institutet e kërkimit dhe qendrat e kërkimit dhe zhvillimit pranë çdo fakulteti. Nga ana tjetër në UET pedagogët kanë detyrimin e realizimit të botimeve apo pjesëmarrje në konferenca, i cili shprehet edhe në kontratat e tyre të punës. Kjo demonstron angazhimin e institucionit për realizimin e këtij objekti madhor.



- 12 -

b) Strategjitë afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata për arritjen e objektivave

Universiteti ka një strategji në tre nivele:


Strategjia afatshkurtër (1 – 3 vjeçare) synon në: konsolidimin dhe garantimin e funksionimit të gjithë sistemit në përputhje të plotë me «Procesin e Bolonjës» dhe kërkesat e ligjit «Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë»; ofrimin e të tri cikleve të studimit së bashku me diplomat përkatëse; konsolidimin e personelit akademik dhe atij ndihmës me pedagogë me tituj dhe grada shkencore; plotësimin dhe konsolidimin e gjithë strukturës akademike, kërkimore-shkencore e administrative; krijimin e kushteve dhe shërbimeve sa më të plota e cilësore për studentët dhe pedagogët.

Strategjia afatmesme (3 – 5 vjeçare) synon në: garantimin e një stafi mësimor të qëndrueshëm e cilësor në masën mbi 75% i brendshëm; shtimin e konsiderueshëm dhe përmirësimin cilësor të ambienteve mësimore dhe atyre të shërbimit për studentët dhe pedagogët; realizimin marrëveshjeve të bashkëpunimit me disa universitete e institucione të tjera universitare ballkanike, europiane e amerikane prestigjioze dhe realizimin e një sërë aktiviteteve akademike të përbashkëta me këto institucione; pjesëmarrjen në programet europiane të arsimit të lartë, për të realizuar shkëmbimin reciprok të studentëve e pedagogëve; realizimin e një sërë botimesh akademike - shkencore e monografish; organizimin e masterave të përbashkët me departamente apo universitete evropiane; kompletimin i Bibliotekës së UET-it me tituj librash, me periodikë revistash të specializuara, si dhe garantimin e përdorimit masiv nga ana e studentëve dhe pedagogëve të bibliotekave elektronike; studimin e mundësive për hapjen e profileve, degëve ose fakulteteve të reja, në përputhje me kërkesat e tregut dhe mundësitë financiare dhe organizative.

Strategjia afatgjatë (6 – 10 vjeçare) synon: profilizimin e universitetit dhe fakulteteve të tij në dy drejtime themelore:

(1) Universitet / fakultet i specializuar në lidhjet me biznesin dhe tregun e punës. Kjo nënkupton një profilizim më të ngushtë të diplomave në funksion të llojeve kryesore të degëve të biznesit (p.sh., "marketing makineri-pajisje", "fiskalitet", "menaxhimi i mediave", "reklama-promocion", "jurist biznesi", "drejtim bankar", "kontabiliteti kompanive", "menaxher kredie & risku", etj.), apo kërkesave evidente të tregut (p.sh., "menaxher projektsh", "administrim sistemesh informatike", "gazetari e profilizuar", "diplomaci ekonomike", "administrim sektorial – në sistemin shëndetësor, arsimor, pushtet lokal, biznese të ndryshme, etj.", "jurist për kontrata dhe marrëdhëniet me klientët", "komunikim & publicitet", "audit", etj). Ky drejtim strategjik i zhvillimit të universitetit parashikohet të realizohet nëpërmjet një lidhje të ngushtë me të gjitha llojet e biznesit.

(2) Universitet elitar në fushën akademike dhe shkencore, që nënkupton një orientim të dukshëm dhe të qartë në elitën akademike dhe shkencore, duke synuar përgatitje dhe diplomim të studentëve në fusha më akademike dhe shkencore, të tilla si: "Ekonomiks", "Administrim publik", "Sociologji", "Psikologji", "Jurist për të drejtën penale, civile, kushtetuese apo europiane", "Marrëdhënie Ndërkombëtare", "Filozofi", "Antropologji", "Komunikim", "Banka-tregje financiare", "E drejtë ndërkombëtare", "Zhvillimi i qëndrueshëm", "Diplomaci-gjeopolitikë", "Tregje & biznes ndërkombëtar", "Negocim konfliktsh", "Media", "Komunikim", "Politika ekonomike & zhvillim", "Studime europiane", "Studime mesdhetare", "Shkenca politike", etj. Universiteti do të synojë përgatitjen e studentëve cilësorë në fushën akademike dhe atë të kërkimit shkencor. Ky vizion strategjik parashikon krijimin e lidhje të ngushta me qendra kërkimore shkencore me reputacion, universitete elitë të këtij lloji në Europë dhe SHBA, angazhimin e pedagogëve të nivelit të lartë dhe me reputacion shkencor, lidhje me institute kërkimore-shkencore dhe qendra të mëdha akademike, etj, ofrimin e diplomave të përbashkëta me universitete apo departamente analoge në BE e SHBA, etj.



Koment: Strategjia afatgjatë e zhvillimit është mjaft ambicioze dhe realizimi i saj kërkon një angazhim total të drejtuesve dhe stafit të universitetit. Nuk është e lehtë të bëhesh brenda 10 vjetëve të krijimit (tre vjet kanë kaluar) një universitet elitare, të përgatisësh stafin e brendshëm me kompetenca mësimdhënje për të gjitha profilizimet e reja që përmenden, të realizosh kualifikimet shkencore të tij (doktoraturë, etj.). Kërkohej një plan të detajuar për realizimin e kësaj strategjie, me objektiva të matëshme si dhe parashikimin e të gjitha pengesave dhe rruget për kapërcimin e tyre. Megjithatë universiteti është në vitin e tretë të krijimit, në raport nuk konstatohet ndonjë analizë për realizimin e objektivave të shtruar në strategjinë afatshkurtër si krijimi i ciklit të tretë të studimit, konsolidimi i strukturave akademike dhe kërkimore-shkencore, konsolidimi i stafit akademik me tituj e grada.

Që kjo strategji të mos mbetet në letër, i rekomandojmë universitetit zërthimin e strategjisë në plane konkrete veprimi, të cilat duhet të jenë të matshme, të monitorueshme dhe objekt i analizave të vazhdueshme.

c) Si i ndjek UET ndryshimet në institucione homologe në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar

UET ndjek me vëmendje e kujdes parësor zhvillimet ligjore, institucionale dhe akademike në universitetet dhe institucionet arsimore analoge shqiptare, ato të trevave shqiptare në rajon si dhe në universitetet europiane dhe ndërkombëtare, duke u fokusuar në arritjet e tyre në përmirësimin e programeve e kurrikulave, metodave të mësimdhënies, kërkimit shkencor, organizimit institucional, botimeve, përshtatjen me tregun e punës, etj. Për këtë shfrytëzohen të gjitha burimet dhe mjetet e informimit. Universiteti merr pjesë dhe është aktiv në të gjitha veprimtaritë e organizuara në hapsirën shqiptare dhe rajonale të arsimit të lartë, si dhe ndjek me vëmendje botime të ndryshme, ecurinë dhe problematikën e procesit të Bolonjës, të reformave në sistemin arsimor shqiptar, europian dhe atij amerikan.

Koment: Mënyra e konceptimit të programeve të studimit me një bazë të gjerë zgjedhje nga studentët, ndryshe nga mënyra e konceptimit të tyre në universitetet e tjera shqiptare, tregon për vëmendjen e treguar nga UET për t'u mbështetur në praktikën botërore dhe për të ndjekur zhvillimet e tyre.


7.2 ANALIZA E PROGRAMEVE TË STUDIMIT, DIPLOMAVE

a) Struktura didaktike e UET në përgjithësi; oferta didaktike (programet e studimit)

UET ofron programe studimi të ciklit të parë me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale 3 vite akademike, që realizohen me së paku 180 ECTS në fushat e drejtësisë, shkencave sociale, ekonomik dhe lëshon **Diplomat e Nivelit të Parë (DNP) në:** "Juridik i përgjithshëm, ose i shoqëruar me profile" "Komunikim – Marrëdhënie publike"; "Shkenca politike"; "Marrëdhënie Ndërkombëtare"; "Ekonomik"; "Financë Bankë"; "Menaxhim Biznesi."

UET ofron edhe programe studimi të ciklit të dytë me kohë të plotë, përkatësisht DND (7 programe studimi) me kohëzgjatje normale dy vite akademike, që realizohen me së paku 120 kredite dhe MNP (11 programe studimi) me kohëzgjatje normale një vit akademike, që realizohen me së paku me 60 kredite. Këto të fundit nuk janë aktivizuar të gjitha, pasi hapja e tyre është miratuar vetëm më 21 janar 2009.

GVJ ka analizuar vetëm programet e studimit të ciklit të parë dhe të gjithë treguesit numerik i referohen këtyre programeve.




- 14 -

b) Hyrjet për programet e studimit të ciklit të parë:

Deri tani në UET aplikohet hyrja e lirë e studentëve në programet e studimit. Universiteti nuk ka vendosur ndonjë kriter maksimal pranimi në funksion të kapaciteteve të infrastrukturës dhe stafit akademik. Deri tani nuk është ndjerë nevoja e një kufizimi të tillë, pasi është bërë e mundur menaxhimi i numrit të studentëve të regjistruar. Universiteti ka vendosur një kufi të poshtëm që përcakton hapjen e një programi studimi. Mosplotësimi i këtij limiti ka çuar në mosaktivizimin deri tani të dy programeve studimi të Fakultetit Ekonomik dhe një të Fakultetit të Shkencave Sociale. Stafi drejtues zbaton disa politika nxitëse financiare për të bërë të mundur tërheqjen e nxënësve me notë mesatare të lartë duke ofruar ulje të tarifës së shkollimit deri në 30%; si dhe duke ofruar bursa ekselence për studentët me rezultate të shkëlqyera të studimeve në UET.

Hyrjet në universitet kanë pësuar rritje nga 175 në vitin akademik 2006-2007 në 765 në vitin akademik 2008-2009. Rritje të konsiderueshme ka pësuar numri i studentëve të regjistruar në Fakultetin Ekonomik, i cili megjithatë është hapur një vit më vonë, rezulton sot me një numër studentësh pak më të lartë se dy fakultetet e tjera:



Në tabelën e mëposhtme tregohet dinamika e regjistrimeve në UET për tre vjet.

Viti akademik	Totali i te regjistruarve	Nota mes.	Bursa	Të transferuar	Të çregjistruar	Të Shkëputur për kohësisht	Vazhdojnë Studimet
2006-2007	175	7.09	20	8	21	12	142
2007-2008	414	7.14	30	52	34	7	373
2008-2009	765	7.26	60	33	18	1	746
TOTALI UET	1354		110	93	73	20	1261

Koment: Konstatohet se numri i studentëve që vazhdojnë aktualisht studimet (1261) është më i vogël se ai i regjistruar në vit të parë (1354). Kjo tregon se universiteti ka një standard të caktuar për nivelin e

- 15 -

cilësisë së studentëve, të cilën mundohet ta ruaj. Fakti që janë çregjistruar (larguar) 73 studentë është një tregues për standardet e cilësisë që kërkon të ruaj universiteti.

Nga vizita e kryer në sekretari, rezultoi se regjistri themeltar mbahej në rregull. Regjistrimet bëheshin në fillim të vitit dhe mund të zgjateshin deri në nëntor, por jo më tej. Grupi konstatoi ndonjë regjistrim në mars, në fillim të semestrit të dytë, por këto ishin vetëm raste transferimesh studimesh. Me rregullore, UET kryen transferime në fillim të çdo semestri. Megjithatë duhet të theksojmë se transferimet para fillimit të semestrit të dytë ishin sporadike. Dosjet e studentëve ishin të plota, me dëftesa origjinale. Nga sondazhet që u kryen për kontrollin e dosjeve, rezultoi një studente, e cila nuk kishte dëftesa origjinale, pasi ndiqte njëkohësisht studimet në dy programe studimi në UT dhe në UET. Nga intervistimi i studentëve doli se kishte edhe disa studentë që ishin diplomuar më parë në një program tjetër studim (degë të dytë).

Nota mesatare në hyrje luhet në kufijtë 7.09-7.26. Nëse do të shikojmë shpërndarjen e mesatares së studentëve në hyrje, përqindja e studentëve me notë mesatare 9-10 vjen duke u rritur lehtësisht nga viti akademik 2006-2007 në vitin akademik 2008-2009. Në përqindje më të lartë janë nxënësit me notë mesatare 8-9, e cila, për vitin akademik 2008-2009 arrin në 21%.

Shpërndarja e mesatares së studentëve në hyrje:

Viti akademik	Nota mesatare 9-10	Nota mesatare 8-9
2006-2007	7%	13%
2007-2008	8%	16%
2008-2009	9%	21%

Koment: Këto statistika tregojnë se masat që ka marrë universiteti për të rritur cilësinë në hyrje janë efektive. Universiteti mund të analizojë më gjerësisht këto të dhëna statistikore dhe të masë efektivitetin e dhënjes së bursave.

c) Numri i stafit mësimdhënës për çdo kurs studimi: stafi i brendshëm dhe i jashtëm

Numri i personelit akademik të brendshëm dhe të jashtëm të angazhuar në programet e studimit DNP luhet në kufijtë 51 deri në 57 pedagogë dhe raporti pedagogë të brendshëm/të jashtëm varion nga 1:1.2 deri në 1:2.3. Kriteret e shpërndarjes së ngarkesës është e lidhur me statusin e pedagogut. Pedagogu efektiv ka si detyrim të jap maksimalisht deri në dy disiplina në semestër (në bazë të deklarimeve të drejtuesve). Në grupin e pedagogëve të jashtëm dallohen ata që kanë statusin senior si dhe pedagogët me ngarkesë të veçantë. Nga vrojtimi i shpërndarjes së ngarkesës ndërmjet stafit të brendshëm dhe të jashtëm për vitin akademik 2007-2008 konstatohet se shpërndarja e ngarkesës dhe e numrit të disiplinave është si më poshtë:

Tabela: Shpërndarja e ngarkesës për vitin akademik 2007-2008

Statusi i pedagogut	Ngarkesa në orë fizike	Ngarkesa në përqindje	Ngarkesa mesat. vjetore e pedag.	Numri mesatar i disiplinave	Variacioni i nr. të disiplinave
Efektiv	4045	56.5%	225 ore faktike	2.8	1-5
I jashtëm (i ftuar)	3110	43.5%	58 ore faktike	1.1	1-2

Shpërndarja e pedagogëve sipas numrit të lëndëve që ata mbulojnë për vitin akademik 2008-2009 është:

64% e pedagogëve (të brendshëm dhe të jashtëm) janë angazhuar në zhvillimin e një disipline;

19% e tyre janë angazhuar në 2 disiplina; 12% në 3 disiplina; 5% në 4 disiplina.

Koment: Konstatohet se shpërndarja e ngarkesës mësimore ndërmjet stafit të brendshëm e të jashtëm është akoma larg standardeve të përcaktuara në udhëzimin e MASH Nr.30, datë 26.09.2007 (rreth 2/3 e ngarkesës duhet të mbahet nga stafi i brendshëm). Megjithatë ngarkesa mesatare që mbajnë pedagogët efektiv është shumë herë më e madhe se ajo e pedagogëve të jashtëm. Përjashtim bëjnë vetëm stafi i jashtëm që kanë statusin me ngarkesë të veçantë. Ngarkesa mesatare vjetore e stafit të brendshëm është sipas standardeve të përcaktuar nga MASH (Udhëzimi 20), edhe pse institucionet private nuk e kanë detyrim zbatimin e këtij udhëzimi. Numri mesatar i disiplinave që ka dhënë çdo pedagog i brendshëm në vitin akademik 2007-2008 ka qenë afërsisht 3 me një variacion nga 1 në 5, edhe pse 64% e stafit zhvillon vetëm 1 disiplinë. Në vitin akademik 2008-2009, numri maksimal i disiplinave, që mund të japë një pedagog efektiv, është kufizuar deri në 4. (Ky fakt u pohua edhe nga stafi akademik, të cilët deklaruan se kanë detyrimin të japin deri në 2 disiplina për semestër).

Nga ana tjetër duhet të theksojmë se në listën e pedagogëve të jashtëm, figurojnë personalitete të shquar akademike dhe ekspertë profesional në fushat përkatëse të studimit.

Gjykojmë se universiteti duhet të bëjë përpjekje për të rregulluar standardet në lidhje me shpërndarjen e ngarkesës dhe të bëjë të mundur uljen e ngarkesës së pedagogëve efektivë, pasi kjo con në rritje të cilësisë së mësimdhënjes.

d) Shkalla e kalueshmërisë: numri i studentëve në hyrje dhe në dalje

Për vitin akademik 2006-2007, kalueshmëria për sezonin e provimeve në qershor llogaritet 52.5%, ndërsa në sezonin e riprovimeve në vjeshtë në 87%.

Për vitin akademik 2007-2008, kalueshmëria për sezonin e provimeve në qershor llogaritet 74%, ndërsa në sezonin e riprovimeve në vjeshtë kalueshmëria u rrit në 92%. Kalueshmëria e studentëve të vitit të dytë është më e lartë (rreth 86%) se e vitit të parë (rreth 69%)

Koment: Konstatohet se në vjeshtë nuk jemi para situatave të kalueshmërisë 100%, gjë që tregon një konsistencë në politikat e kontrollit të dijeve të studentëve.


e) Cilësia e kalueshmërisë: nota mesatare

Nëse shikojmë përqindjen e shpërndarjes së studentëve sipas notës mesatare në fund të vitit akademik 2007-2008, konstatohet se studentët me një notë mesatare 9-10 zenë rreth 7% të gjithë studentëve të UET, ndërsa ata me notë mesatare 8-9 zenë rreth 12%. Krahasuar këto shifra me notën mesatare 9-10 dhe 8-9 në hyrje për vitet akademike 2006-2007 dhe 2007-2008 përkatësisht 7-8% dhe 13-16%, shikojmë se pothuajse ruhet i njejt nivel cilësie dhe është tregues indirekt i objektivitetit të vlerësimit të studentëve.

Koment: Theksojmë se në rregulloren e studimeve dhe në mjaft udhëzime jepen kriteret e vlerësimit të studentëve dhe kufiri minimal për të kaluar. Në vlerësimin e studentëve merren në konsideratë të gjithë elementët përbërës të lëndës si edhe performanca e studentit gjatë vitit, e cila kontrollohet me provimet e ndërmjetëme. Në mënyrë më të detajuar këto shprehen në syllabuset e lëndëve. Nëse studenti nuk klasifikohet kalueshëm në sezonin e qershorit, atëhere të gjitha pikët e fituara gjatë vitit, përveç pikëve të esesë (maksimumi 20), zerohen dhe studenti në vjeshtë i nënshtrohet një teze më të plotë për maksimumi 80 pikë. Studenti ka të drejtë të përmirësojë në sezonin e vjeshtës deri në dy nota.

f) Koordinimi midis kurseve të studimit

Një nga parimet themelore që është mbajtur parasysh në hartimin e kurrikulave të programeve të studimit ka qenë parimi i interdisiplinaritetit. Për nga vetë natyra e tyre, programet e studimit DNP ofrojnë njohuri dhe aftësi më të përgjithshme, me fokus më të zgjeruar sesa programet e cikleve më të larta të studimit.



Për këtë arsye programet e ofruara nga 3 Fakultetet e UET-it janë të ndërthurura dhe kanë mjaft disiplina mësimore të përbashkëta. Sigurisht vendi që këto disiplina zënë në programet e studimit është i ndryshëm, bazuar në rolin që ato luajnë në formimin e studentit. Kështu p.sh., disiplina formuese të kategorive A dhe B tek programet e Fakultetit të Shkencave Sociale ofrohen si disiplina të zgjedhura ose integruese tek programet e Fakultetit Ekonomik dhe atij Juridik, në mënyrë që edhe studentët e këtyre fakulteteve të marrin disa njohuri bazë në fushën e shkencave sociale; e njëjta gjë mund të thuhet edhe për disiplinat formuese të dy fakulteteve të tjera. Si rezultat, krahas punës përgatitore që çdo njësi bazë kryen për planifikimin dhe zhvillimin e programeve përkatëse të studimit, një rol mjaft të rëndësishëm në këtë proces luan Sekretari i Përgjithshëm, për koordinimin e punës midis programeve të studimit. Nga ana tjetër, studentëve u ofrohet tutorati për t'i ndihmuar në zgjedhjen e disiplinave. Për çdo program studimi ka disa rregulla të përcaktuara në zgjedhjen e disiplinave, rregulla të cilat kanë të bëjnë me detyrimin e zgjedhjes në kategoritë përkatëse. Për vlerësimin në përmbajtje të kësaj forme referoju analizës së programeve të studimit.

7.3 PROGRAMET E STUDIMIT, ORGANIZIMI I KURRIKULAVE NË KUADËR TË PROCESIT TË BOLONJËS.

Universiteti European i Tiranës ka hapur në vitin akademik 2006-2007, 4 (katër) programe studimi Diplomë e Nivelit të Parë (DNP), të ciklit të parë të studimeve.

I. Fakulteti Juridik ofron programin e studimit DNP:

1. Juridik i përgjithshëm,

Synon përgatitjen e juristëve në nivelin universitar të karakterit të përgjithshëm, të cilët do të kenë bazat për profesionin e juristit, pjesëtarit të zyrave juridike, konsulent juridik. Ata janë të aftë për vazhduar studimet në programet Master i Nivelit të Parë dhe Diplomë e Nivelit të Dytë. Kjo diplomë mund të jetë e shoqëruar me profilet :

a. E drejtë biznesi

Synon t'u japë studentëve përmes grupit të lëndëve opsionale njohuri shtesë lidhur me të drejtën për biznesin, sistemin ekonomik, të drejtat e pronësive, format e reja ekonomike dhe kontraktuale etj.

b. E drejtë publike dhe kushtetuese

Synon t'u japë studentëve përmes grupit të lëndëve opsionale njohuri shtesë lidhur me të drejtën publike, të drejtën kushtetuese, dhe marrëdhëniet e tyre me sistemin politik.


c. E drejtë ndërkombëtare dhe europiane

Synon t'u japë studentëve përmes grupit të lëndëve opsionale njohuri shtesë lidhur me të drejtën e Bashkimit Evropian, traktatet e BE-së, të drejtën ndërkombëtare, institucionet ndërkombëtare etj.

II. Fakulteti i Shkencave Sociale ofron programet e studimit DNP:

1. Marrëdhënie publike-komunikim

Synon përgatitjen e specialistëve të nivelit universitar në Shkencat e Komunikimit dhe Marrëdhëniet Publike, të aftë të kryejnë funksione të ndryshme në tregun e punës si specialistë të medias dhe komunikimit.

 - 18 -

2. Shkenca Politike

Synon përgatitjen e specialistëve të nivelit universitar në shkencat politike, që të jenë të aftë të njohin shkencat politike në tërësi, për të punuar në sektorin e shoqërisë civile, në media, në organizmat politike, specialistë në administratën publike, në të gjithë sektorët e saj.

3. Marrëdhënie ndërkombëtare

Synon përgatitjen e specialistëve të nivelit universitar në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare

dhe diplomacisë, që të jenë të aftë të punojnë në sektorin e diplomacisë, të organizatave ndërkombëtare, në administratën publike.

Shënim: Programi i studimit **Gazetari** nuk është hapur si pasojë e mungesës së kërkesave për regjistrim.

Në vitin akademik 2007-2008 u licencuan 4 programe të tjera studimi DNP.

III. Fakulteti Ekonomik ofron programet DNP:

1. Financë & Banka

Përmes këtij kursi studimesh synohet përgatitja e ekonomistëve të specializuar në problemet financiare, kontabël, banka, shoqëri sigurimesh, etj., të cilët do të jenë të aftë të përmbushin detyrat dhe funksionet në pozicionet e financierit të firmave dhe bizneseve të ndryshme, të ekspertit kontabël të niveleve të ndryshme, të punonjësve të bankave dhe shoqërive të sigurimit, të eksperteve dhe analisteve të tregjeve financiare, të punonjësve të degëve të tatim-taksave, sistemit doganor, etj.

2. Menaxhim biznesi

Përmes këtij programi studimesh synohet përgatitja e ekonomistëve të specializuar në problemet drejtimin dhe menaxhimin të bizneseve të kategorive të ndryshme (biznes i vogël, biznes i madh), të bizneseve në sfera të ndryshme aktiviteti (prodhimi, shërbimesh, tregtar, mediatik, etj.), bizneseve private ose publike të llojeve të ndryshme, biznese kombëtare ose ndërkombëtare, etj.

Shënim: Programet e studimit **Administrim Publik** dhe **Ekonomik** nuk janë hapur si pasojë e mungesës së kërkesave për regjistrim.

b) Organizimi i Programeve të studimit

Programet e studimit janë organizuar mbështetur në kërkesat e Udhëzimit të MASH Nr. 15, datë 04/04/2008 "Për organizimin e studimeve në institucionet publike të arsimit të lartë". Disiplinat formuese janë të strukturuar brenda planit mësimor sipas veprimtarive të tyre formuese, duke u grupuar në gjashtë kategori:


A - Disiplina të formimit të përgjithshëm (bazë). 18-20% të programit të studimit.

B – Disiplina të formimit karakterizues të programit. 50-55% të programit të studimit.

C -Disiplina formuese të ngjashme ose integruese. 8-10% të programit të studimit.

D – Disiplina formuese të zgjedhura. 6-8 % të programit të studimit.

E – Veprimtari formuese. 9-11% të programit të studimit.

 - 19 -

F – Punimi i diplomës. Punimi i diplomës zhvillohet në vitin e tretë të programit të studimit dhe është mbyllja e këtij programi. Ky punim ka 7 kredite dhe zë rreth 4 % të programit.

Koment: Strukturimi i disiplinave sipas këtyre kategorive është në përputhje me kërkesat e Udhëzimit 15. Lëndët janë të organizuar me module duke siguruar në total 22 provime ose forma të tjera të vlerësimit të studentit. Nga këto disiplina ose module për të gjitha programet e studimit 15-16 disiplina janë të detyrueshme dhe përkatësisht 7-6 disiplina janë me zgjedhje nga një fond disiplinash të ofruara rreth 23-30. Kjo bëhet e mundur për vetë karakterin e programeve të studimit, të cilat janë të përafërta dhe interdiciplinore. Lëndët me zgjedhje janë kryesisht nga grupi BIII i disiplinave të formimit karakterizuese (2 disiplina), grupi C i disiplinave të ngjashme ose integruese (2 lëndë nga të cilat një është me dy module) dhe grupi D i disiplinave formuese me zgjedhje (dy disiplina). Mesatarisht lëndët me zgjedhje brenda grupeve të mësipërme luhatet në rreth 20% të krediteve totale. Çdo program studimi shoqërohet me rregulloren mësimore, në të cilën jepen informacioni i përmbledhur mbi aspektet organizative për programin përkatës të studimit si: struktura e programit mësimor, plani mësimor i detajuar ku lëndët janë të grupuar sipas veprimtarive formuese, objektivat formuese të disiplinave të ofruara, detyrimet kushtëzuese, ndarja e krediteve në orë pune në auditor dhe ore studimi individual, sistemi i vlerësimit dhe ekuivalentimi i sistemit kombëtar të vlerësimit në sistemin europian, mënyra e kontrollit dhe vlerësimit të dijeve, rregulla e riprovimeve, mbartjes, përmirësimit, rivlerësimit, transferimet, etj. Sistemi i tutoratit i ngritur ndihmon studentët në zgjedhjen e disiplinave opsionale mbi bazën e kritereve të vendosura.

Viti akademik në UET përbëhet nga dy semestra me shtrirje në 15 javë secili. Semestri i parë përfshin periudhën tetor - shkurt dhe semestri i dytë periudhën mars - qershor. Puna për planifikimin e lëndëve me zgjedhje për çdo semestër fillon jo më vonë se dy muaj përpara fillimit të vitit akademik. Ky proces kryhet nga Dekani i Fakultetit dhe Përgjegjësit e Departamenteve, në koordinim me Sekretarin e Përgjithshëm të universitetit.


Në UET, përveç semestrave kryesorë, zhvillohet edhe një semestër veror që i krijon mundësi studentëve të marrin jo më shumë se dy lëndë, të cilat zhvillohen në mënyrë intensive gjatë 5 javëve, duke respektuar ngarkesat mësimore sipas numrit të krediteve për lëndë.

c) Literatura dhe cilësia e saj

Përcaktimi i literaturës për çdo lëndë bëhet nëpërmjet diskutimeve të gjera në Departamente. Studentëve u vihet në dispozicion literatura e ndarë në këto kategori: literaturë bazë, literaturë plotësuese dhe literaturë e rekomanduar. Literatura pasqyrohet në programin e lëndëve, e detajuar për çdo temë. Si tekste bazë synohet të përdoren libra të botuar nga universitetet perëndimorë ose shtëpitë botuese më prestigjioze perëndimore. Për këtë departamentet vlerësojnë shkallën e pajisjes së tregut të librave akademike me botime bashkëkohore sipas fushave të lëndëve që mbulojnë. Për literaturën bazë të pambuluar departamentet, në bazë të një plani, i propozojnë UET Press-it listën e librave më të domosdoshëm që duhet të përkthehen e botohen. Synimi është që në një kohë sa më të shkurtër të gjithë lëndët të mbulohen më libra nga më të përparuarit në fushat përkatëse. Kur departamentet vlerësojnë si shumë të rëndësishme, për specifikat e lëndëve që trajtojnë, referimin e dukurive shoqërore tipike shqiptare, atëherë si literaturë plotësuese, ose e rekomanduar përdoren edhe tekste të përgatitura nga autorë shqiptarë. Në UET është inkurajuar botimi i teksteve monografike nga pedagogët. Këto tekste janë përdorur si literaturë plotësuese apo literaturë e rekomanduar.

Analiza e cilësisë së literaturës së përdorur shprehet në analizën e programeve të studimit.

d) Transferimi i sistemit europian të krediteve (ECTS); ngarkesa në pikë krediti brenda dhe jashtë auditorit

 - 20 -

Konceptimi dhe përcaktimi i krediteve në UET është ndërtuar në bazë të parimeve të procesit të Bolonjës, në përputhje me Ligjin "Për Arsimin e Lartë në RSH", dhe Udhëzimit të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr. 15, datë 04/04/2008 "Për organizimin e studimeve në institucionet publike të arsimit të lartë", me synim krijimi i mundësive për mobilitet dhe transferim të tyre nga njëri institucion i arsimit të lartë tek tjetri, brenda dhe jashtë vendit.


Ndarja e krediteve në orë pune për natyrën e disiplinave formuese bëhen si në tabelat e mëposhtëme:

Lëndë Teorike	Lëndë Praktike
6 ECTS = 150 orë punë	6 ECTS = 150 orë punë (lëndë praktike)
<i>Orë në auditor</i>	<i>Orë në auditor</i>
15 javë x (3 orë leksion + 1 orë seminar) = 60 orë	15 javë x (2 orë leksion + 2 orë seminar) = 60 orë
Në total: 60 orë	Në total: 60 orë
<i>Orë pune individuale</i>	<i>Orë pune individuale</i>
15 javë x 2 orë lexim për përgatitjen e kursit javor = 30 orë	15 javë x 2 orë lexim për përgatitjen e kursit javor = 30 orë
10 orë përgatitje për provimin e ndërmjetëm = 10 orë	10 orë përgatitje x 2 detyra praktike = 20 orë
30 orë kërkime në bibliotekë = 30 orë	25 orë kërkime në bibliotekë = 25 orë
20 orë për përgatitjen e provimit final = 20 orë	15 orë punë për përgatitjen e provimit përfundimtar = 15 orë
Në total: 90 orë	Në total: 90 orë

5 ECTS = 125 orë punë (lëndë teorike)	5 ECTS = 125 orë punë (lëndë praktike)
<i>Orë në auditor</i>	<i>Orë në auditor</i>
15 javë x (2 orë leksion + 1 orë seminar) = 45 orë	15 javë x (1 orë leksion + 2 orë seminar) = 45 orë
5 orë projekt detyra	5 orë projekt detyra
Në total: 50 orë	Në total: 50 orë
<i>Orë pune individuale</i>	<i>Orë pune individuale</i>
15 javë x 1.5 orë lexim për përgatitjen e kursit javor = 22.5 orë	15 javë x 1 orë lexim për përgatitjen e kursit javor = 15 orë
7.5 orë përgatitje për provimin e ndërmjetëm = 7.5 orë	10 orë përgatitje x 2 detyra praktike = 20 orë
30 orë punë kërkimore në bibliotekë = 30 orë	25 orë kërkime në bibliotekë = 25 orë
15 orë punë për përgatitjen e provimit përfundimtar = 15 orë	15 orë punë për përgatitjen e provimit përfundimtar = 15 orë
Në total: 75 orë	Në total: 75 orë

3 ECTS = 75 orë punë	3 ECTS = 75 orë punë
<i>Orë në auditor</i>	<i>Orë në auditor</i>
15 javë x (1 orë leksion + 1 orë seminar) = 30 orë	15 javë x 2 orë leksion/seminar = 30 orë
<i>Orë pune individuale</i>	<i>Orë pune individuale</i>
15 javë x 1 orë lexim për përgatitjen e kursit javor = 15 orë	15 javë x 1 orë lexim për përgatitjen e kursit javor = 15 orë
5 orë përgatitje për provimin e ndërmjetëm = 5 orë	5 orë përgatitje për provimin e ndërmjetëm = 5 orë
10 orë kërkime në bibliotekë = 10 orë	5 orë përgatitje x 2 detyra praktike = 10 orë
15 orë punë për përgatitjen e provimit përfundimtar = 15 orë	15 orë punë për përgatitjen e provimit përfundimtar = 15 orë
Në total: 45	Në total: 45

Koment: Universiteti ka përdorur kritere të njëjta të ndarjes së një krediti në orë mësimi dhe orë pune individuale. Në funksion të natyrës së lëndës dhe të sasisë së krediteve që ajo ka, janë përdorur raporte të ndryshme për orë mësimi teorik dhe orë mësimi praktik, por këto raporte ruhen të njëjta për disiplinat brenda një programi studimi dhe për të gjitha programet e studimit.



Kjo është për t'u përshëndetur, pasi krijon një ngarkesë reale në auditor të njejtë për të gjitha disiplinat e të njejtës natyrë.

Universiteti ka bërë edhe një ndarje të orëve të punës individuale në zëra të veçantë si: lexim për përgatitjen e kursit javor, orë pune në biblioteke, përgatitje për provimet e ndërmjetme dhe për provimin përfundimtar. Kjo lloj ndarje është origjinale, megjithëse nuk është shumë e qartë se ku janë mbështetur në ndarjen e orëve dhe përse u shërben kjo ndarje?!

Analiza e programeve të studimit jepen në raportet përkatëse të programeve të studimit, bashkëngjitur vlerësimt institucional

7.4 STAFI MËSIMDHËNËS DHE MBËSHTETËS

a) Struktura e stafit akademik

Megjithëse standardet për numrin e stafit efektiv me tituj dhe grada në shumicën e njësive bazë (për fakultetin juridik dhe ekonomik) nuk plotësohen, UET-i ka treguar shumë kujdes në politikat e përzgjedhjes së stafit akademik për programet e studimit. Duke qene se një përqindje jo e vogël (afërsisht 50% e disiplinave të ofruara) shtrihen në të gjitha programet e studimit, bën të mundur një shfrytëzim sa më racional të kapaciteteve të stafit akademik. Kështu gjejmë një shtrirje mjaft të mirë të stafit akademik me tituj e grada në të gjitha programet e studimit. E shprehur në përqindje angazhimi i stafit akademik me tituj e grada (të brendshëm dhe të jashtëm) në çdo program studimi është:

Statusi i personelit akademik	Fakulteti i Shkencave Sociale			Fakulteti Juridik				Fakulteti Ekonomik	
	Shkenca Politike	Marrëdhënie ndërkombëtare	Marrëdhënie publike-komunikim	Juridik i Përgjithshëm	E drejta Publike & Kushtetuese	E drejta Ndërkombëtare & Europiane	E drejtë Biznesi	Menaxhim-Biznesi	Finance-Banka
Totali	51	52	51	56	57	54	57	53	56
me tituj e grada	41%	42%	35%	37%	39%	39%	39%	48%	48%
Lektorë	49%	48%	65%	63%	61%	61%	61%	62%	62%

Koment: Kjo tabelë përmbledhëse tregon për përgjegjësinë dhe vëmendjen e treguar në afrimin e personaliteteve akademike dhe profesionistëve të fushave përkatëse në mësimdhënje. Politikat e UET në drejtim të përzgjedhjes së stafit akademik të jashtëm janë të tilla që u ofrojnë atyre edhe staturë të veçanta si "senior" ose "me ngarkesë të veçantë", të cilët pavarësisht se nuk mund të jenë staf i brendshëm akademik, kanë angazhime ndaj universitetit më të mëdha se pedagogët e tjerë të ftuar.

UET ka treguar vëmendje të veçantë në sigurimin e stafit të brendshëm akademik si dhe në rekrutimin e një stafi me tituj e grada ose edhe në proces doktorature. Kështu rekrutimi i stafit të brendshëm ka qenë:

Viti akademik	Me tituj & grada		Lektorë		Totali	Femra
	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra		
2006-2007	4	0	3	1	7	1
2007-2008	9	1	10	5	19	6
2008-2009	13	6	21	12	35	18

Koment:

politikë rekrutimi në përputhje me nevojat e institucionit si dhe ruajtje e disa raporteve të drejta ndërmjet stafit efektiv me tituj e grada në raport me numrin total. Për të tre vitet ky raport ka qenë

Shikohet një

përkatësisht: 57%, 47% dhe sot është 37%. Vëmendje i është kushtuar edhe rritjes së numrit të femrave në përbërje të stafit akademik efektiv, i cili sot është pothuajse i njëjtë me atë të meshkujve.

b) Raporti midis stafit mësimdhënës dhe numrit të studentëve për çdo kurs studimi

Raporti i stafit akademik me numrin e studentëve, i llogaritur në bazë njësie kryesore, luhet në kufijtë e më poshtëm:

VITI AKADEMIK 2008-2009	Fakulteti			Totali
	Juridik	Shkenca Sociale	Ekonomik	
Numri i studentëve	373	421	467	1261
Numri i pedagogëve	28	47	56	131
Raporti pedagogë /studentë	1:13	1:9	1:8	1:10
Të brendshëm	9	16	10	35
Raporti pedagogë të brendshëm /studentë	1:41	1:26	1:47	1:36

Koment: Raporti midis stafit akademik efektiv të njësive kryesore dhe studentëve përkatës luhet në kufijtë nga 1:26 në 1:47. Vlera më e ulët e këtij raporti është në fakultetin e shkencave sociale, ndërsa më e lartë në fakultetin ekonomik. Duhet të theksojmë se për shkak të interdisiplinaritetit të programeve të studimit, pedagogët në përgjithësi e shtrijnë aktivitetin e tyre mësimdhënës edhe në programet e tjera të studimit. Kjo bën që raportet pedagogë efektiv ndaj numrit të studentëve për çdo program studimi të shtrihet në diapazonin nga 1:4 në programin "Shkenca Politike" në 1:19 në programin "Juridik". Nga ana tjetër fakulteti ekonomik ka më pak se dy vjet jetë dhe numrin më të madh të studentëve të regjistruar.

UET duhet t'i kushtojë vëmendje plotësisht të stafit akademik sidomos për fakultetet ekonomik dhe juridik.

c) Mbulimi i lëndëve me pedagogë: numri i pedagogëve, numri i disiplinave, ngarkesa mësimore

UET ofron gjithsej 135 disiplinash mësimore në 9 programe studimi (me gjithë profilet e tyre). Numri i disiplinave që ofrohen në programet e studimit DNP, sipas njësive kryesore janë:

- Fakulteti Juridik: 35 disiplina
- Fakulteti i Shkencave Sociale: 58 disiplina
- Fakulteti Ekonomik: 42 disiplina

Për mbulimin e këtyre disiplinave mësimore gjatë vitit akademik 2008-2009 janë angazhuar 131 pedagogë. Në shpërndarjen e ngarkesës mësimore janë mbajtur parasysh këto kriter kryesore: kualifikimi i personelit akademik; fusha e ekspertizës për secilin anëtar; norma që duhet plotësuar; parimi që asnjë anëtar i personelit akademik të mos japë më shumë se 4 lëndë në një vit akademik. Në përgjithësi stafi akademik i jashtëm, i cili përbën sot rreth 73% të numrit total angazhohet në mësimdhënjen e vetëm 1 disipline. Vetëm një numër i vogël i tyre mund të angazhohet në mësimdhënjen e dy disiplinave. Kjo del qartë edhe nga shpërndarja e numrit të disiplinave për pedagogë (deklaruar nga RVB), për vitin akademik 2008-2009:

- 23 -

"64% e personelit akademik është angazhuar për të dhënë mësim vetëm në një disiplinë mësimore; 19% e personelit akademik është angazhuar në 2 disiplina mësimore; 12% në 3 disiplina dhe 5% në numrin maksimal të lejuar të disiplinave, 4 të tilla".

Në përgjithësi ngarkesa e pedagogëve ruan normat e vendosura nga MASH, duke diferencuar qartë ngarkesën e stafit akademik të ftuar, i cili përgjithësisht është deri në 100 orë mësimore në auditor dhe ngarkesën e stafit akademik efektiv, që në raste të veçanta ka shkuar edhe mbi 400 orë në vit. Disa pedagogë të ftuar, të cilëvevet u janë dhënë staturë të veçanta (senior dhe me ngarkesë të veçantë), mbajnë ngarkesë mësimore të krahasueshme me atë të stafit akademik të brendshëm. Shpërndarja e ngarkesës mësimore për vitin 2008-2009 (në bazë të RVB) është

"51% e pedagogëve kanë normë më të ulët se 100 orë mësimore në vit; përgjithësisht këta janë pedagogë të jashtëm; 27% e tyre kanë ngarkesë mësimore 100-200 orë mësimore në vit; 12% e tyre kanë ngarkesë mësimore 200-300 orë mësimore në vit. Përqindja e pedagogëve me normë nga 300-400 orë mësimore në vit dhe mbi 400 orë mësimore është mjaft e ulët, nga 5% secila".

Koment: Duke patur parasysh se pedagogët që kanë mbi 300 orë mësimi janë kryesisht efektiv, 10% i tyre do të thotë 13 pedagogë efektiv kanë ngarkesë mbi 300 orë mësimore dhe rreth 16 pedagogë kanë një ngarkesë brenda normave 200-300 orë. Meqenëse nr. i stafit të brendshëm akademik është 35, konstatohet që 37% e pedagogëve efektiv kanë një ngarkesë shumë të madhe mbi 300 orë mësimore në auditor. Kjo ngarkesë e madhe nuk i jep pedagogut mundësi kualifikimi dhe angazhimi në punë kërkimore dhe studimore. Numri i madh i disiplinave (deri në katër) dhe ngarkesa e madhe që mban një pjesë e stafit të brendshëm akademik, mund të sjellë krijimin e kushteve jo të favorshme sidomos për stafin akademik pa tituj e grada.

UET duhet të marrë masa të menjëhershme për rritjen e stafit akademik, sidomos me fillimin e programeve të studimit të ciklit të dytë (DND dhe MNP)

Shpërndarja e ngarkesës mësimore ndërmjet stafit akademik realizohet duke iu përmbajtur disa parimeve themelore:

- çdo anëtar i personelit akademik nuk mund të zhvillojë më shumë se 4 lëndë në vit akademik;
- mbahet parasysh që shpërndarja e lëndëve të një anëtari të personelit akademik të jetë e balancuar në të dy semestrat;
- për ndarjen e lëndëve merret parasysh niveli i ekspertizës kërkimore dhe akademike të çdo anëtari të stafit, si dhe domosdoshmëria që lëndët të kenë afërsi, lidhje organike mes tyre ose zhvillimi i tyre të jetë vijim i njëra-tjetrës;
- në rast se anëtari i stafit akademik zhvillon mësim në të dy ciklet e studimit, mbahet parasysh edhe shpërndarja e balancuar e lëndëve sipas cikleve të studimit (DNP – MNP/DND).

Në UET respektohen disa standarde të brendshme në lidhje me organizimin e grupeve mësimore: një grup seminari si rregull nuk e kalon numrin prej 30 studentësh, ndërkohe që një grup leksioni nuk përbëhet nga më shumë se tre grupe mësimore seminari (që do të thotë jo më shumë se 90 studentë).

Në UET është bërë kujdes që, përgjithësisht, anëtari më i kualifikuar i personelit akademik në një grup të caktuar lëndësh të mbulojë lëndën/lëndët që janë më të lidhura me specifikat e kursit përkatës. Ky rregull është shoqëruar me nevojën që në përcaktimin përfundimtar të ngarkesës mësimore të stafit të merret parasysh edhe eksperiencia në fushën e mësimdhënies.



Ngarkesa e personelit akademik vlerësohet përmes disa elementëve, përveç orëve mësimore në auditor: këto janë psh, Këshillim akademik (për pedagogët e brendshëm dhe të jashtëm); Tutoriat (vetëm për pedagogët e brendshëm); Botim artikujsh shkencorë në revistat e botuara nga fakultetet e UET-it; Drejtim temash diplome DNP dhe/ose DND, për këto të fundit pedagogu duhet të ketë minimalisht gradën Dr. Një pedagog efektiv ka nën udhëheqje deri në 8 tema diplome.

Format dhe sasia e ngarkesës për çdo anëtar të personelit akademik përcaktohet në kontratën e lidhur mes tij dhe UET-it.

Në kuadrin e marrëveshjeve të bashkëpunimit të miratuara me institucione të tjera të arsimit të lartë brenda dhe jashtë vendit, pedagogë të ndryshëm të UET-it, janë ftuar të japin mësim në kurse të caktuara studimi në disa universitete të huaja në Francë, Angli, Itali, Spanjë, SHBA, Greqi, Maqedoni, Kosovë, Turqi, etj., si dhe janë angazhuar në mësim-dhënie në disa universitete shqiptare si Universiteti "Fan Noli" i Korçës, Universiteti "Luigj Gurakuqi" i Shkodrës, Universiteti Bujqësor i Tiranës, Universiteti Polis, Universiteti "Luarasi", Universiteti Politeknik i Tiranës (Masteri IFG), etj.

d) Politikat e rekrutimit të stafit në zbatim të rregullave në fuqi

Rekrutimi i stafit mbështetet tërësisht në disa kriteret e elemente thelbësore të tilla si: (1) nevojat për staf të ri; (2) kërkesave për cilësinë dhe nivelin e kualifikimit të stafit, të përcaktuara në "Ligjin për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë", aktet nënligjore specifike, rregulloret dhe udhëzimet e veçanta të MASH-it, si dhe kërkesat e statutit dhe rregulloreve të vetë UET-it. UET ka hartuar procedura për rekrutimin e stafit, duke e bërë këtë proces transparent. ***Është për t'u theksuar se në rekrutimin e stafit akademik departamenti dhe fakulteti luajnë një rol të rëndësishëm në vendimmarrje, pasi janë pjesë e komisioneve ad-hoc që ngrihen për seleksionimin e kandidatëve.*** Kandidatëve të vlerësuar si të përshtatshëm dhe të përzgjedhur iu lihet në dispozicion një periudhë kohe për përgatitjen e programeve të lëndëve, ciklit të leksioneve e seminareve, shqyrtimit e përzgjedhjes së literaturës bazë e ndihmëse, njohjen me rregulloret dhe statutin e UET-it.

UET-i ka krijuar edhe dy kategori të veçanta të personelit akademik, për pedagogët e ftuar:

- Pedagogë "senior"
- Pedagogë "me ngarkesë të veçantë"

Për sa i përket kategorisë "senior", përzgjidhen autoritetet më në zë në fushën akademike, sociale apo institucionale, si p.sh. anëtarë të Akademisë së Shkencave të RSH-së, apo autoritete të tjera drejtues të institucioneve kryesore publike, ose private të vendit si ish-Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, ish-Prokurori i Përgjithshëm, ish-Kryetari i Gjykatës së Lartë, ish-anëtarë të Gjykatës Kushtetuese etj. Këta persona ofrohen të japin konsulencën dhe ekspertizën e tyre në formën e cikleve të veçanta të leksioneve, si udhëheqës të lektorëve, si orientues në hartimin e kurrikulave, si oponentë të programeve të lëndëve të veçanta etj, për shkak të përvojës së tyre të shquar në fushat përkatëse. Për këto autoritete janë hartuar kontrata të veçanta shërbimi.

Pedagogët "me ngarkesë të veçantë", janë pedagogë, të cilët nga pikëpamja e marrëdhënies së punës nuk janë me kohë të plotë, por që kanë një ngarkesë të caktuar për të plotësuar, duke pasur një bashkëpunim më të qëndrueshëm me UET-in.

e) Dokumentacioni i rekrutimit, dosjet e stafit

Dokumentacioni i depozituar për çdo anëtar të personelit akademik përmban:

- Kopje të diplomës së shkollës së lartë, shoqëruar me listë notash;



- Kopje të kualifikimeve të tjera të kryera;
- CV sipas modelit të hartuar nga UET;
- Kopje të pasaportës ose një dokument tjetër identifikimi;
- Librezë shëndetësore

Ndërsa për personelin e brendshëm akademik, krahas dokumentacionit të sipërpërmendur, dosja duhet të përmbajë edhe:

- Librezën e punës;
- Librezën e kontributeve shoqërore.

Koment: Krijimi i kategorisë pedagogë "senior", është një zgjedhje mjaft e mirë e UET, pasi bën të mundur tërheqjen drejtpërdrejtë të figurave e personaliteteve të shquar në fushat përkatëse të programeve të studimit jo vetëm në mësimdhënie, por edhe në ekspertizë e konsulencë në hartimin e programeve të studimit, duke realizuar një lidhje të mirë me tregun e punës. Nga shqyrtimi i dosjeve të personelit akademik, u konstatua se ato ishin të plota me të gjithë dokumentacionin e nevojshme të parashtruar në statut dhe rregulloret e brendshme. Nga ekspertët u verifikuan edhe deklaratimet në RVB në lidhje me shkallët e kualifikimit të personelit, të cilat ishin mjaft korekte, gjë që tregon për korektësinë e grupit të vlerësimit të brendshëm në hartimin e këtij raporti.


f) Shkalla e kualifikimit të stafit të jashtëm dhe kriteret e rekrutimit të tij

Raporti pedagogë të brendshëm/pedagogë të jashtëm në tre vite ka qenë pothuajse në të njëjtat nivele nga 1:3 në vitin akademik 2006-2007, në 1:2.7 në vitin akademik 2008-2009. **Kjo tregon kujdesin që është treguar për të mos përkeqësuar këtë raport (përmirësimi është i vogël). Megjithatë ky raport është përsëri jo në përputhje me kërkesat e MASH, udhëzimit Nr.30 datë 26.09.2007, i ndryshuar.**

Rekrutimi i stafit akademik të jashtëm bëhet në përputhje me nevojat për pedagogë bazuar në planet mësimore që zhvillohen në kuadrin e çdo Fakulteti/departamenti si dhe ngarkesat mësimore të miratuara në UET. Për të përzgjedhur një staf akademik të jashtëm sa më të kualifikuar dhe profesional, janë vendosur dhe zbatuar kriteret, ku si ndër me kryesoret janë: eksperiencia në mësimdhënie në nivel akademik; niveli i kualifikimit dhe diplomimit duke i dhënë përparësi kandidatëve me tituj dhe grada; cilësia dhe standardet e universitetit ku është diplomuar aplikanti, duke i dhënë përparësi universiteteve perëndimore; rezultatet personale profesionale të tij; aktiviteti kërkimor shkencor e botues; aftësitë komunikuese e etika; etj. Përzgjedhja e kandidaturave të stafit të jashtëm akademik bëhet me të njëjtat kriteret dhe procedura si edhe për përzgjedhjen e stafit të brendshëm. Për nevoja të veçanta dhe periudha të caktuara, në UET janë rekrutuar edhe pedagogë që nuk kanë grada e tituj akademikë, por që kanë një eksperiencë të gjatë e të suksesshme në profesionin dhe institucionin e tyre, janë specialistë të mirënjohur në fushën përkatëse, etj. Gjithashtu, në procesin akademik janë angazhuar edhe pedagogë të vendit apo të huaj nga universitetet partnere me UET-in apo universitete të tjera analoge. Pedagogët e huaj angazhohen në një semestër të plotë normal gjatë vitit mësimor, në semestrin e verës, ose në cikle të veçanta leksionesh e seminaresh brenda programit mësimor të një lënde.

Përqindja e pedagogëve të jashtëm me tituj e grada të aktivizuar këto 3 vite akademike, është rritur nga viti në vit nga 18% në vitin akademik 2006-2007 në 34% këtë vit.

g) Moshë mesatare e stafit mësimdhënës dhe raporti F/M



Shpërndarja e personelit akademik aktual sipas grup-moshës është: rreth 46% e pedagogëve i përkasin grup-moshës nga 25-34 vjeç; 24% i përkasin grup-moshës 35-44 vjeç; 19% grup-moshës 45-54 vjeç; 8% grup-moshës 55-64 vjeç. Mosha mesatare e personelit akademik të këtij viti llogaritet rreth 39 vjeç.

Koment: Vihet re se 46% e stafit akademik është në grupmoshën 25-34 vjeç, grup moshë që duhet të punojë për kualifikimin e tij. Për këtë grup moshë sidomos ato që janë pjesë e strukturave akademike të UET, kushtohet një vëmendje e veçantë për trajnimin e tyre në lidhje me metodat e mësimdhënjes, me kërkesat e universitetit, por nuk ka ndonjë vëmendje të veçantë për kualifikimin e tyre.

7.5 MËSIMDHËNIA

a) Organizimi dhe format e mësimdhënies: raporti midis tyre

Procesi mësimor zhvillohet me leksione, seminare, punë laboratorike, praktika profesionale, detyra praktike, ese/detyra kursi, provime të ndërmjetëm, provime përfundimtare dhe punim diplome. Mësimdhënia sigurohet nëpërmjet leksioneve dhe seminareve. Qëllimi kryesor i leksionit është shpjegimi i materialit mësimor nga ana e pedagogut. Seminari shërben për vlerësimin e procesit të nxënies nga ana e studentit. Gjatë seminarit pedagogët pyesin, nxisin, aktivizojnë dhe ndërveprojnë me studentët. Ata mund t'i organizojnë studentët në grupe, mund t'u caktojnë atyre prezantime individuale apo në grup, mund të zgjidhin ushtrime me studentët gjatë orës së seminarit etj. Qëllimi i praktikës është i dyfishtë. Në nivelin akademik ajo synon që studenti të arrijë që njohuritë teorike t'i shohë të zbatuara në praktikë. Për këtë qëllim UET-i garanton që institucioni apo pozicioni ku studentët do të kryejnë praktikën të jetë sa më i lidhur me fushën e studimit. Në nivelin me konkret praktika profesionale synon të shkathtësojë studentin në ambientin e punës dhe t'i ofrojë atij një mundësi për të krijuar njohje, kontakte dhe njohuri në lidhje me tregun e punës, gjë e cila do të lehtësojë përpjekjet e tij për punësim pas diplomimit. Eseta përbën një komponent kyç të procesit të mësimdhënies. Esetë e kërkuara në programet e studimit të ciklit të parë ndahen në tre kategori: *Esetë Argumentuese, Esetë Akademike, Esetë Kërkimore,*


Koment: Gjatë kryerjes së vizitës mbikqyrëse studentët e vitit të tretë filluan praktikën. Universiteti kishte marrë masat organizative për realizimin e praktikave. Praktikant ne funksion të fushave të studimit ishin organizuar në institucione të administratës publike, institucione të drejtësisë, etj

c) Cilësia e mësimdhënies

Stafit akademik me tituj e grada i ngarkohet përgjegjësia kryesore e organizimit dhe zhvillimit të disiplinave mësimore, për të cilat ata janë titullarë. Përgjithësisht, sidomos për disiplinat mësimore me ngarkesë të lartë, ata asistohen edhe nga lektorë të brendshëm ose të jashtëm për zhvillimin e orëve të seminarit. Pothuaj të gjithë lektorët e angazhuar në UET janë me Master të Nivelit të Dytë; përjashtim bëjnë vetëm lektorët e veprimtarive formuese si gjuhët e huaja. Anëtarët e stafit me tituj e grada kanë një CV të pasur me mjaft botime, artikuj, pjesëmarrje në konferenca, etj.

Në rritjen e cilësisë dhe bashkëkohësisë së mësimdhënies rëndësi i kushtohet dhe lidhjes së dijeve të transmetuara me praktikën dhe eksperiencën ndërkombëtare. Kjo qasje e tillë realizohet nëpërmjet ftesës në auditor të lektorëve me eksperiencë të spikatur vendas dhe të huaj, si dhe të praktikienëve të njohur kombëtarisht e ndërkombëtarisht për të përçuar dijet dhe eksperiencën e tyre në auditor.

Përzgjedhja e literaturës dhe sigurimi i saj për çdo lëndë të programit të studimit është një tjetër faktor i rëndësishëm, që ndikon drejtpërdrejt në cilësinë e mësimdhënies. Politika e ndjekur në UET kërkon që programi i lëndës të mbështetet në një ose dy tekste bazë, të përzgjedhur nga literatura më e mirë botërore, e cila i vihet në dispozicion studentit e përkthyer, redaktuar dhe shtypur nga UET press. Literatura e rekomanduar përfshin literaturën e autorëve më të mirë shqiptarë dhe të huaj që vihet në

 - 27 -

dispozicion nga biblioteka e UET-it ose nëpërmjet shërbimeve *online* ku UET-i është abonuar. Syllabuset pasqyrojnë literaturën që rekomandohet për çdo disiplinë.

Klasat e leksionit janë të pajisura me kompjuter dhe projektues, të cilët lejojnë përdorimin gjerësisht të prezantimit me PoëerPoint, apo shfaqjen e filmave për qëllime didaktike që rezultojnë në kombinimin e paraqitjes vizuale me atë verbale, me qëllim përfundimtar të ofruar dhe nxitjen e debatit.

Për garantimin e standardeve bashkëkohore të mësimdhënies pedagogët trajnohen, informohen dhe inkurajohen të shkëmbejnë eksperiencat e tyre pozitive për metodat e reja të mësimdhënies në leksione e seminare. Inkurajohen metodat interaktive dhe të menduarit kritik, krahas asaj të lidhjes së teorisë me praktikën.

Tutoriat dhe këshillimi akademik: Në këto veprimtari është përmirësuar shërbimi ndaj studentit ku çdo pedagog i brendshëm ka 30 studentë nën kujdestarinë e tij. Pedagogët e brendshëm qëndrojnë 2-3 orë në javë në dispozicion të studentëve që kanë nën kujdestari, për t'i këshilluar dhe ndihmuar në mbarëvajtjen e studimeve të tyre. Gjithashtu çdo pedagog i jashtëm qëndron një orë në javë në dispozicion të studentëve, për të sqaruar çdo paqartësi që ata mund të kenë lidhur me lëndën, apo detyrimet ndaj saj.

Koment: Në Universitet ishte një dhomë për organizimin e tutoratit, me një grafik ku përcaktohej orari i zhvillimit të tutoratit për çdo pedagog të ndarë sipas fakulteteve. Tutorati nuk ishte i organizuar me grupe fikse studentesh për çdo pedagogë, por të gjithë pedagogët e fakulteteve kishin përgjegjësi për të gjithë studentët e tyre dhe i ndihmonin kryesisht në zgjedhjet e lëndëve brenda rregullave të përcaktuara në programin e studimit dhe rregulloren mësimore, për udhëzimet dhe rregullat e Universitetit, për praktikën apo edhe temat e diplomave. Studenti gjente në çdo kohë një anëtar të stafit të tij akademik në dhomën e tutoratit. Kjo mënyrë organizimi shmang ndikimet e individëve në grupe të mëdha studentesh në përzgjedhjen e disiplinave, duke bërë të mundur që studentit të dëgjoj më shumë se një këshillë dhe të vendos vetë se cilat lëndë do të ndjek.


Vlerësimi i performancës së pedagogut realizohet nga studentët, kolegët dhe titullarët e fakultetit, dekanit apo përgjegjësit të departamentit. Kjo i shërben garantimit të cilësisë së mësimdhënies. Rezultatet e vlerësimit i bëhen prezent pedagogut, i cili reflekton për atë çka duhet bërë në përmirësim të procesit të mësimdhënies, qoftë në leksione apo seminare.

d) Kontrolli i njohurive, format e kontrollit, objektiviteti në vlerësimin e studentëve

Vlerësimi i përgatitjes akademike të studentit mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm. Vlerësimi i vazhdueshëm është që ta vendosë studentin në punë përgjatë të gjithë vitit. Ai rrit nivelin e objektivitetit dhe transparencën në vlerësimin e studentit. Nota përfundimtare është rezultante e kombinimit të elementëve të mëposhtëm:

- Provimit përfundimtar (40%)
- Provimit të ndërmjetëm (30%)
- Esesë/detyra praktike (2 detyra) (20%)
- Nivelit të diskutimit në seminare (10%)
- Frekuentimit të leksioneve (10 pikë bonus)

Provimi përfundimtar ka qëllimisht vlerën 40% të notës përfundimtare, në mënyrë që një student, i cili nuk ka punuar gjatë semestrit, ta ketë të pamundur të marrë notë kaluese bazuar vetëm në këtë komponent të



vlerësimi. Në sezonin e riprovimeve në vjeshtë, për lëndët teorike provimi ka 80% të vlerësimi dhe 20% përcaktohet nga vlerësimi i marrë për esenë e dorëzuar gjatë semestrit. Për lëndët praktike provimi ka 100% të vlerësimi. Teza e riprovimit synohet të jetë e një vështirësie më të lartë, për të dekurajuar lënien e provimeve për këtë sezon provimesh, por gjithashtu i jep mundësi studentëve që për ndonjë arsye kanë humbur pikë gjatë semestrit të mund të rifitojnë pikët e humbura nëse si përfundim kanë realizuar një përvetësim të mirë të lëndës.

Kontrolli i njohurive ka pasur dhe vazhdon të ketë një qëllim të dyfishtë: (i) vlerësimin e studenteve dhe (ii) nxitjen e aftësive argumentuese dhe njohurive të studentëve. Të dy qëllimet janë zbatuar në mënyrë të ndërlidhur me njëra – tjetrën, duke bërë të mundur të testohet edhe informacioni që studenti ka, por edhe aftësinë e tij/saj për të argumentuar/analizuar. Pyetjet me zhvillim janë konceptuar në formën e një eseje argumentuese. Në këtë mënyrë vlerësohet njëkohësisht edhe niveli i informacionit të studentit, por edhe aftësia e tij për ta aplikuar atë konkretisht.

Krahas pyetjeve që testojnë aftësitë analitike, jepen edhe pyetje që testojnë informacionin që studenti ka marrë gjatë lëndës, pasi një testim vetëm i aftësive analitike rrezikon të penalizojë ata studentë që mësojnë në mënyrë mekanike dhe riprodhuese. Në formatin e tezës së provimit rekomandohet që:

1. 20- 30% e vlerësimi përbëhet me pyetje që kontrollojnë njohuritë;
2. 40 - 50% me pyetje që testojnë aftësinë analitike; dhe
3. 20 – 30% me pyetje me zhvillim në formën e esesë argumentuese.

Tezat e provimit janë të sekretuara me barkode, në mënyrë që të ruhet anonimati i studentit deri në korigjimin e provimit nga pedagogu, për të shmangur ndikimin e vlerësimi të pedagogut nga faktorë që nuk kanë lidhje me cilësinë e zhvillimit të tezës. Ç sekretimi kryhet nga sekretaria mësimore pas dorëzimit të tezave të korigjuara.

Studentit i krijohet mundësia për të sqaruar çdo paqartësi apo pretendim lidhur me vlerësimin, fillimisht me pedagogun e lëndës dhe, në rast se, edhe pas takimit sqarues me pedagogun, studenti ka ankesa për vlerësimin e marrë, mund të kërkojë ngritjen e një komisioni shqyrtues nga Departamenti. Vendimi i komisionit është përfundimtar. Studenti ka të drejtën e përmirësimit të notës; kjo mund të kryhet vetëm në sezonin e vjeshtës.

Për akordimin e 10% të vlerësimi për nivelin e aktivizimit në seminare, pedagogëve iu kërkohet të marrin parasysh jo vetëm numrin e mungesave të çdo studenti gjatë seminareve, por edhe shkallën e aktivizimit të çdo studenti në orët e seminarit.

Për të siguruar vlerësimin me objektivitet të eseve të punuara nga studentët, UET ka përgatitur udhëzues për elementet e esesë që duhet të vlerësohen: Parashtrimi i tezës, Argumentimi, Përfundimi.

UET përdor mekanizma që nxisin frekuentimin e orëve të leksionit nga studentët, duke futur maksimumi 10 pikë bonus për frekuentuesit e rregullt të leksioneve, të pranishëm në jo më pak se në 80% të tyre. Evidenca e pranisë së studentëve në auditor merret përmes firmosjes së listprezencës nga ana e tyre.

Koment: Mekanizmat e ngritur për kontrollin e performancës së pedagogut, përdorimi i teknologjive të sotme në mësimdhënje, përzgjedhja e literaturës si dhe një mekanizëm vlerësimi të detajuar, dhe të dokumentuar tregojnë për vëmendjen që tregon UET në lidhje me cilësinë e mësimdhënjes. Të gjitha mekanizmat janë të shprehura në rregulloret dhe udhëzimet e UET. Nga verifikimi në praktikë rezultoi se këto zbatoheshin me korektësi, megjithë rezistencën që mund të hasen si rezultat i shkallës së ndërgjegjësimit të stafit akademik.



e) Metodatat e mësimdhënies

Në procesin e mësimdhënjes bëhen përpjekje për të inkurajuar përdorimin e teknikave dhe metodave bashkëkohore si në leksion ashtu edhe në seminare. Teknikat që përdoren më shumë në leksion janë: Strukturimi i leksionit për të krijuar lidhjen me temat pararendëse dhe materialet studimore, realizimi i bashkëveprimit ndërmjet pedagogut dhe studentit për ta çuar studentin drejt përfundimit nëpërmjet arsyetimit, realizimi i mbylljes së tematikës duke bërë përmbledhjen dhe konkluzionet e çështjeve të diskutuara. Seminaret janë interaktive dhe universiteti rekomandon përdorimin e disa të teknikave dhe metodave si: Metoda Sokratike nëpërmjet të cilës studentët drejtohen drejt gjetjes së zgjidhjes, duke bërë përpjekje që të përfshihen të gjithë studentët; ndarja në grupe të vogla diskutimi, të cilëve u jepen detyra, për zgjidhjen e të cilave studentët analizojnë dukuri, zbatojnë teori, ushtrjnë gjykim, ose kryejnë një kombinim të këtyre aktiviteteve. Në punën në grup mund të përdoren teknika të ndryshme. Studimet e rasteve (case study) janë një tjetër teknikë e organizimit të seminareve. Ato janë të rëndësishme për të mësuar analizën e informacionit, vendim-marrjen ose zgjidhjen e problemit. Simulimet iu japin studentëve praktikë vendimmarrjeje, por në një mënyrë tjetër, më tërheqëse. Brainstorming (stuhia e mendjes/trurit) është një tjetër teknikë që përdoret në orët e seminareve. Ushtrime në klasë është një teknikë që i detyron studentet të zbatojnë konceptet që sapo mësuan, dhe zakonisht sjell pyetje të cilat studentët nuk i kishin menduar gjatë leksionit. Konkursi synon të nxjerrë dijet më të mira të nxënësve dhe të përvetësuar nga studentët dhe të identifikojë shtresën elitare mes studenteve brenda auditorit. Prezantimi është një teknikë që përbën një formë përmblylëse të një pune të caktuar, e cila rekomandohet të marrë trajtën e mbrojtjes së punimit, më shumë se një prezantim i thjeshtë, duke u shoqëruar me seancë pyetje – përgjigje – debat mes studentëve. “Panairi i ideve” është një formë e re e prezantimit të punimeve individuale të studentëve, nëpërmjet të cilës vlerësohen jo vetëm studentët që prezantojnë punimet e tyre, por edhe “vizitorët” për shkallën e interesit dhe të ekspertizës së treguar.

Koment: Metodatat e reja të mësimdhënjes janë mjaft të larmishme dhe në funksion të drejtpërdrejt të cilësisë së nxënjes së studentëve. Këto metoda rekomandohen dhe akoma nuk janë bërë dominuese.

Për përhapjen dhe konsolidimin e tyre është e nevojshme trajnimi i stafit në mënyrë ekstensive me këto forma e metoda me lektorë dhe trajnues vendas dhe të huaj.

f) Përdorimi i teknologjive të reja të mësimdhënies: kompjutera, mjete audiovizive etj.

Infrastruktura didaktike në ndihmë të mësimdhënjes (PC, projektor, sistem audio, internet, laborator informatike, printera, fotokopje, biblioteka, telefonia, sistem rrjeti të mbrojtur, etj) është e konsoliduar. Kjo ndikon që studentit t'i sigurohet shërbimi i nevojshëm për realizimin e objektivave të tij akademike e kërkimore.

g) Kontrolli i brendshëm i mësimdhënies

UET-i ka ngritur dhe implementuar sistemin e monitorimit dhe kontrollit të brendshëm i cilësisë së mësimdhënies me anë të së cilës synon arritjen e objektivave dhe standardeve bashkëkohore të sigurimit të cilësisë. Kontrolli i brendshëm i mësimdhënies është pjesë e rëndësishme e vlerësimit të performancës së stafit akademik. Kontrolli dhe vlerësimi realizohet nëpërmjet katër rrugëve:

- **Vetëvlerësimi dhe vlerësimi në nivel paralel**
- **Vlerësimi nga përgjegjësi i departamentit dhe dekani,**
- **Vlerësimi i studentëve,** i cili organizohet nëpërmjet pyetësorëve. Rezultatet e vlerësimeve të studentëve i janë bërë të ditura dekanatit si dhe pedagogëve.

- **Vlerësimi nga sekretaria mësimore**, e cila monitoron teknikisht zbatimin me korrektësi të orarit të mësimit, prezencën e pedagogut në orën e mësimit, si dhe respektimin e kohëzgjatjes së orës mësimore.

Rezultatet regjistrohen dhe i bëhen të ditur pedagogut.

Koment: GVJ gjeti gjurmë faktike (evidenca) të monitorimeve dhe kontrolleve të organizuara nga drejtuesit e njësive, studentët dhe sekretaria mësimore. Rezultatet e tyre kanë qene pjesë e analizave vjetore.

GVJ rekomandon forcimin e këtij procesi dhe shfrytëzimin e tij drejt rritjes së efektivitetit të procesit mësimor.

7.6 KËRKIMI SHKENCOR

a) Politika e kërkimit shkencor në të gjitha nivelet e UET-it

Në filozofinë dhe misionin e UET-it kërkimi shkencor zë një vend të rëndësishme. Në përmbushje të këtij misioni, veprimtaria kërkimore shkencore është shtrirë në disa drejtime:

- **Revistat shkencore**

Çdo fakultet ka revistën e tij shkencore, e cila, si rregull, botohet dy herë në vit, nën drejtimin e kryeredaktorit përkatës. UET-i boton revistat Polis, Jus&Justicia, *Economicus*, Sociological Analysis, e cila është më bord editorial ndërkombëtar dhe botohet në gjuhën angleze. Pedagogët e brendshëm kanë përparësi në botimet e tyre, duke ruajtur kritere të rrepta shkencore.

- **Konferencat shkencore**

Çdo fakultet ka detyrimin të organizojë së paku dy konferenca shkencore në vit, tematika e të cilave është e lidhur me atë të revistët përkatës shkencore. Konferencat shkencore përgjithësisht i përgjigjen fushave të studimit të fakulteteve përkatës. UET-i ka financuar me një buxhet të posaçëm këto konferenca.

- **Botimet shkencore**

Pedagogët e brendshëm inkurajohen të botojnë libra shkencorë në kuadrin e Shtëpisë botuese UET-Press. Këto punime shkencore duhet të jenë autentike, me kritere akademike të rrepta, duke iu nënshtruar të gjitha kritereve perëndimore për botime të këtij lloji. Ato duhet të jenë me interes dhe vlerë për fushat e kërkimit të UET-it. Fakulteti, Departamenti përkatës dhe UET - Press përcaktojnë vlerën shkencore, titujt dhe kalendarin.

Universiteti ka ligjëruar implementimin e vitit sabbatik për personelin akademik me grada e tituj, i cili e përdor atë të punojë për përparimin e tij akademik ose për të kryer një studim/monografi autentike që të botohet në UET - Press. Në një rast të tillë, projekti i tij i kërkimit kërkohet të miratohet nga Këshilli shkencor i fakultetit dhe nga UET - Press.

- **Grupet e kërkimit**

UET-i inkurajon krijimin dhe veprimtarinë e grupeve të kërkimit, të strukturuar përreth pedagogëve me tituj dhe grada brenda departamentit, ose bashkëpunime midis departamenteve.

ASB

- 31 -

Sub *OP* *Alley* *DZ* *PA* *PW* *Quarney*

Koment: Grupet e kërkimit akoma nuk kanë marrë formë të plotë, por është pozitiv fakti që drejtimi i universitetit i ka parashikuar dhe ka marrë edhe masat organizative për funksionimin sa më mirë të tyre.

• **Institutet dhe Qendrat e kërkimit**

Për organizimin, bashkëveprimin dhe drejtimin cilësor dhe efektiv të kërkimit shkencor dhe në funksion të përmbushjes së filozofisë dhe misionit të UET-it janë krijuar njësi kryesore (Institute) dhe njësi bazë (Qendra të kërkimit shkencor). Secili nga Institutet ka për detyrë të organizojë dy konferenca (kombëtare ose ndërkombëtare) në vit, në të cilat kumtohen rezultatet e veprimtarisë së tyre studimore. Në to, si rregull ftohen të marrin pjesë edhe studiues të huaj, të cilët janë bashkëpunëtorë të jashtëm të instituteve.

Puna kërkimore shkencore e pedagogëve dhe e punonjësve shkencorë të UET-it lehtësohet nga biblioteka, e cila, si pjesë e infrastrukturës shkencore të UET-it i mundëson stafit akademik shfrytëzimin e një literature shumë të pasur bashkëkohore (libra dhe revista akademike) të arkivuar në sistemet e bibliotekave elektronike *Questia* dhe *Jstor*.

Koment: GVJ konstatoi se këto njësi janë në formim e sipër. Ato kanë vetëm drejtuesin. Nuk është e qartë se si do të funksionojnë këto njësi, nëse nuk kanë një staf efektiv, i cili do të ketë si detyrë kryesisht kryerjen e aktiviteteve studimore dhe projekte, mbi bazën e organizimit të grupeve kërkimore. Gjithashtu nuk është e qartë lidhja ndërmjet dy instituteve dhe qendrës së kërkimit pranë fakultetit të shkencave sociale, të cilët kanë të njëjtat fusha studimi. Në buxhetin aktual nuk kishte ndonjë zë të veçantë për aktivitetet e instituteve. Mbështetja financiare për të gjitha aktivitetet e planifikuara miratohet nga Administratori mbi propozimin e Institutit/Qendrës. Konstatohet një lloj autonomie e menaxhimit financiar të instituteve dhe qendrave ndaj strukturës akademike (dekan-ректор), pasi kemi një lidhje të drejtpërdrejtë të tyre me administratorin.

UET duhet t'i kushtojë rrëndësi parësore konsolidimit të instituteve dhe qendrave, saktësisht të funksioneve dhe lidhjes së tyre me Fakultetet dhe departamentet, përcaktimi i fushave studimore dhe të kërkimit të tyre, si dhe mekanizmat financiarë për mbështetjen e tyre.

b) Botime, pjesëmarje në konferenca, projekte, etj.

Koment: Në RVB listohet një numër i madh botimesh në pesë vjetët e fundit (193 tekste, libra, artikuj). Duhet të theksojmë se GVB duhet të jetë shumë i kujdesshëm në kryerjen e deklarimeve të tilla, pasi CV_të personale të pedagogëve që tregojnë aktivitetet e tyre shkencore para punësimit në universitet nuk mund të llogariten si kontribut i universitetit. Ky është vetëm një tregues i vëmendjes së universitetit për të rekrutuar një staf të tillë.

Nga verifikimet e bëra në zyrën e burimeve njerëzore dhe kontratat e lidhura, rezultoi se një numër i konsiderueshëm kontratash janë lidhur në vitin akademik 2008-2009. Kjo është rrjedhojë e dinamikës së zhvillimit të universitetit. Por nuk mund të pretendohet se për një vit këta pedagogë kanë realizuar botimet e deklaruara.

Në RVB deklarohet se për tre vjet (tetor 2006 – shkurt 2009) stafi akademik ka marrë pjesë në 157 referime në konferenca dhe 21 raporte kërkimore studimore. Duke patur parasysh se numri i stafit akademik të brendshëm nga krijimi i universitetit deri sot ka qenë përkatësisht 7, 19, dhe 35 punonjës, realizimi i tërë këtyre referimeve dhe raporteve në vetëm 30 muaj, nuk është shumë bindëse. Para se të bëhen deklarime të tilla duhet të përcaktohen se cilat aktivitete të stafit dhe universitetit do të quhen aktivitete të mirëfillta shkencore.

Deklarimi i organizimit të 20 aktiviteteve shkencore për tre vjet (Konferenca) (rreth 7 të tilla në vit) nuk është reale, pasi nuk mund të quhet aktivitet shkencor çdo lloj veprimtarie që mund të organizohet, ku



UET luan vetëm rolin e organizatorit ose të bashkëorganizatorit. **Fakt që nuk mohohet është se Universiteti ka organizuar mbi 46 seminare me lektorë të jashtëm, vendas ose të huaj, ku interesi dhe pjesëmarrja e studentëve është e madhe.**

c) Lidhja e kërkimit shkencor me procesin mësimor

I gjithë stafi akademik është i angazhuar në procesin e integritit të rezultateve të punës së tyre kërkimore - shkencore veçanërisht në procesin e mësimdhënies, duke përfshirë jo vetëm në leksione, por edhe seminare, publikimet e tyre në monografi shkencore dhe në revistat që boton UET-i. Shpesh për këtë qëllim organizohen edhe seminare dhe tryeza diskutimesh akademike, me pjesëmarrjen e gjerë të stafit akademik dhe studentëve.

Një mënyrë shumë efektive përmes së cilës realizohet lidhja e kërkimit shkencor me procesin mësimor është organizimi periodik (çdo javë) i tryezave të debatit në fusha të tilla si filozofia, sociologjia, shkencat politike dhe marrëdhëniet ndërkombëtare. Këto tryeza drejtohen nga pedagogët dhe tërheqin një masë të madhe studentësh dhe anëtarësh të stafit akademik.

d) Përfshirja e studentëve në kërkimin shkencor

UET-i ka në thelb të filozofisë së tij kërkimin shkencor dhe në këtë kuadër përfshirjen e studentëve në këtë veprimtari të rëndësishme. Ndër aktivitetet shkencore ku janë përfshirë edhe studentët përmenden:


- "Sondazhet e organizuara nga Qendra e Studimeve Politike pranë UET-it."
- "Universiteti Veror European: "Përdorimet e normës: politika, shoqëria dhe pushteti" Sarandë 1-11 shtator 2008, Organizuar nga Universiteti European i Tiranës, në kuadër të rjetit ndërkombëtar të studiuesve OFFRES.
- "Studimi i Institutit të Studimeve Sociale dhe Politikave: "Realiteti politik, kulturor dhe ekonomik – social i Shqipërisë, 20 vjet mbas fillimit të procesit të tranzicionit demokratik".
- "Botimi i një përmbledhje aktesh e dokumentesh të Ministrisë së Jashtme të Britanisë së Madhe, për periudhën e viteve 1922 – 1938".

Koment: Një nga elementët më të rëndësishëm të veprimtarisë kërkimore shkencore në universitet është kualifikimi i stafit të brendshëm akademik. Duke patur parasysh se numri i stafit të brendshëm me tituj e grada është nën standardet e përcaktuar në ligjin Nr. 9741, dt 21.05.2007 "Për Arsimin e Lartë në RSh", si dhe faktin që në përbërje të stafit grupmosha 25 deri 34 vjeç është në përqindje mjaft të lartë, atëherë vëmendja kryesore e drejtuesve të universitetit duhet të orientohet drejt kualifikimit të stafit. GVJ nuk gjeti ndonjë plan për kualifikimin e stafit akademik pa gradë shkencore dhe as ndonjë masë të marrë nga Universiteti për të krijuar kushte reale për kualifikimin e të rinjve. Stafi deklaroi se kishin një mbështetje financiare për pjesëmarrje në konferenca dhe aktivitete të tjera në ndihmë të kualifikimit, e cila bëhej me miratimin e administratorit.

Nga kqyrja e dokumentacionit financiar rezultoi se universiteti mbështeste financiarisht aktivitete të tilla si blerje librash, përkthime, organizime konferencash, etj, të cilat miratoheshin drejtpërsëdrejti nga administratori.

Me rritjen dhe konsolidimin e universitetit bëhet e nevojshme krijimi i mekanizmave mjaft të qartë, transparent dhe jodiskriminues për mbështetjen dhe financimin e aktiviteteve shkencore, në të gjitha njësitë e UET si dhe për krijimin e kushteve për kualifikimin e stafit të ri akademik.

- 33 -



7.7 STUDENTËT

a) Hyrjet në universitet:

UET ka hartuar udhëzime të veçanta në lidhje me politikat dhe procedurat e pranimit të studentëve në të dy ciklet e studimit, në të cilat përfshihen: Informimin dhe ndërgjegjësimin; Parimet; Kriteret e pranimit; Procedurat e pranimit.

Në lidhje me informimin dhe ndërgjegjësimin organizohen një sërë aktiviteteve si:

- Takime informuese, sqaruese, dhe ndërgjegjësuere me nxënës të gjimnazeve të Tiranës dhe qyteteve të tjera të vendit, si dhe takime e biseda gjysmë formale në institucione e organizata ku mendohet se ka interes për ndjekjen e studimeve të ciklit të dytë.
- Seminare, tryeza të rrumbullakëta, leksione hyrëse dhe veprimtari të tjera me karakter mësimor-informues-argëtues me nxënës të gjimnazeve të Tiranës dhe qyteteve të tjera të vendit në mjediset e UET-it, si dhe me grupe studentësh të ciklit të parë të studimeve, të cilët shfaqin prirje për vijimin e studimeve në cikle më të larta.
- Përgatitje e materialeve informuese – sqaruese – ndërgjegjësuere, si fletë-palosje, postera, broshura etj, si dhe atyre vizive si: spote televizive, mesazhe promovionale, etj.
- Organizim logjistik, orientues, me mbështetje të burimeve njerëzore të UET-it, në “Javët e Regjistrimit,” gjatë të cilave, të interesuarit informohen, sqarohen, këshillohen mbi sistemin e studimeve në UET, procedurat e aplikimit dhe pranimit, si dhe pajisen me dokumentacionin përkatës për të dy ciklet.

Nëpërmjet politikave, kriterëve dhe procedurave, synohet të përzgjidhen për të vazhduar studimet kandidatët me rezultatet më të larta. Për këtë bëhet një politikë e mirë nëpërmjet bursave për të tjerë nxënës të mirë të shkollave të mesme. *Deri tani në UET nuk ka ndonjë kriter specifik për hyrjet në ciklin e parë, as përsa i përket cilësisë në hyrje, as përsa i përket sasisë (kuota). I vetmi kriter është që një program studimi nuk hapet nëse nuk plotësohet numri i minimal i studentëve.*

Përzgjedhja e kandidatëve për programet e ciklit të parë të studimeve bëhet nga një komision përkatës i caktuar nga Dekanati, duke u bazuar në një formular pranimi dhe mbështetur në dokumentacionin e paraqitur dhe mesatares së shkollës së mesme, ose të një diplome tjetër të Nivelit të Parë.

Koment: *Është mjaft pozitiv fakti që në UET nuk ka diskriminim të asnjë lloji, racor, fetar, etj në menaxhimin e hyrjeve në universitet. UET është mirë të përcaktojë kapacitetet maksimale që mund të përballojë për infrastrukturën dhe burimet njerëzore që disponon. Kjo është e nevojshme për të siguruar konsistencë në arritjen e indikatorëve të cilësisë (raportet staf i brendshëm/studentë dhe sipërfaqe m²/studentë), si dhe indikatorët që lidhen me ngarkesën e stafit akademik.*

UET të bëjë planifikimet e tij të brendshme mbi bazën e mundësive dhe kapaciteteve maksimale të përballimit të fluksit të studentëve për çdo fakultet dhe të përcaktojë për çdo vit numrin maksimal të hyrjeve në universitet.

b) Ngarkesa mësimore e studentëve në auditor dhe jashtë tij

Ngarkesa mësimore e studentëve shprehet në rregulloren e çdo programi studimi. Në këto rregullore pasqyrohet ndarja e ngarkesës së studentit për çdo kredit në orë në auditor dhe orë pune individuale. Kjo ndarje është në favor të orëve të punës individuale. Kjo ka sjellë që ngarkesa javore në auditor e studentit të jetë rreth 20 orë në javë, e cila është brenda standardeve të vendosura nga MASH, Udhëzimi Nr.15,

- 34 -



datë 04/04/2008 "Për organizimin e studimeve në institucionet publike të arsimit të lartë". Meqenëse në programet e studimit rreth 20-25% e krediteve meren me zgjedhje të disiplinave, studenti mund të marrë në një vit më shumë se 60 kredite. Sasia e krediteve që studenti merr me lëndë të detyrueshme është 140-141 ECTS

c) Temat e diplomave

Për të fituar "Diplomën e Nivelit të Parë" studentët, përveç arritjes së rezultateve pozitive në programin e studimit, duhet të mbrojnë edhe një punim individual. Departamentet, në kuadrin e Fakulteteve përkatëse, kanë përgjegjësinë kryesore për realizimin e procesit të përgatitjes, të udhëheqjes, të monitorimit, të prezantimit dhe të vlerësimit të punimit dhe të mbrojtjes së tezës së diplomës. Departamentet propozojnë çdo vit akademik një listë me emrat e udhëheqësve potencialë që janë pjesë e stafit akademik të UET-it. Në përpilimin e listës mbahet parasysh që udhëheqësit e propozuar të jenë ekspertë të fushës së kërkimit në programin e studimit që propozohet, kanë kualifikimet e kërkuara, kohën dhe angazhimin për t'i ofruar kandidatit një udhëheqje cilësore të kërkimit dhe një menaxhim cilësor të punës së tij. Numri maksimal për udhëheqje temash diplome DNP për pedagogët e brendshëm është **8 studentë**.

Për mbarëvajtjen e punimit të diplomës është hartuar edhe një udhëzues i veçantë mbi procedurat e përgatitjes, mbikëqyrjes dhe e shqyrtimit të ecurisë së kërkimit dhe të mbrojtjes së tezës. Udhëheqësi mban takime të rregullta me studentin (të paktën 2-3 orë në javë) për të dhënë këshilla dhe për të qenë në dijeni të ecurisë së kërkimit. Udhëheqësi, gjithashtu ka përgjegjësinë të vetëdijësojë studentin për rrezikun e falsifikimeve dhe të plagjiaturës, në përputhje me politikat e integritetit akademik.


Komisioni i vlerësimit përbëhet nga tre pedagogë të Fakultetit ose UET-it, ose specialistë të fushës që punojnë në institucione shkencore. Një nga pedagogët është drejtuesi i diplomës ndërsa dy të tjerët luajnë rolin e oponentëve. Anëtarët e komisionit dhe recentët duhet të kenë të paktën gradën Master i Nivelit të Dytë.

Për një vlerësim më të mirë dhe objektiv të temës së diplomës sugjerojmë që komisioni i mbrojtjes të përfshijë më shumë anëtarë. Gjithashtu numri maksimal 8 i udhëheqjes së temave për një pedagog na duket i lartë.

d) Llojet e aktiviteteve të studentëve

Universiteti i ka kushtuar vëmendje realizimit të aktiviteteve të ndryshme me studentët nga viti 2006-2009, dhe përdorimit të formave të ndryshme të stimujve, si:

- "Bursat e ekselencës dhe Çmimi i Rektorit", që i akordohen studentëve me mesatare të lartë, si dhe për ESE-në më të mirë, si dhe bursa për fëmijët e policëve të vvarë, fëmijët e komunitetit Rom, bursa për talentet e reja, bursa për të rinjtë e forumeve politike, etj.
- Njohje me rregullat e golfit
- Dhënje informacionesh mbi Mundësinë e studimit në Queen Mary, University of London
- Shfaqja e filmit "Persepolis" me temë "Revolucioni Islamik i vitit 1997 në Iran".
- Takime të organizuara me studentët në lidhje me shqetësimet, problemet, sugjerimet, etj.
- Tryezat e Rrumbullakëta ose "LECTIO"-t.



e) Punësimi i të diplomuarve: aksesimi në tregun e punës dhe përputhja e tyre me këtë treg

UET nëpërmjet planifikimit dhe organizimit të praktikave, synon që studentëve t'iu mundësohet një njohje e drejtpërdrejtë dhe konkrete e tregut të punës, vendosja e kontakteve me institucione publike dhe private, si dhe me individët drejtues të tyre, duke u kujdesur që zhvillimi i këtyre praktikave të kryhet në institucionet që i përgjigjen më mirë fushës së studimit të studentit.

Pjesëmarrja në panairët e punës, krijimi i kontakteve nëpërmjet memorandumeve të bashkëpunimit me institucionet publike, si dhe me operatorët e sektorit privat, janë disa nga mënyrat që po përdoren për të informuar studentët dhe mundësuar aksesin e tyre në tregun e punës, në përputhje me kërkesat e tij.

Meqenëse brezi i parë i studentëve nuk ka dalë akoma në tregun e punës, nuk mund të gjykojmë mbi gjetje reale për shkallën e punësimit të studentëve të UET.

f) Informimi i studentëve me të drejtat dhe detyrat, programet mësimore, udhëzues të kurseve të studimit etj.

Informimi i studentëve në lidhje me programet e studimit dhe kurrikulat realizohet që në momentin e parë të kontaktit të tyre me stafin akademik dhe administrativ të UET-it, gjatë *javës së orientimit* në fillim të çdo viti akademik, si dhe përmes njoftimeve të vazhdueshme që shpallen nga Sekretaria ose Dekanatet dhe përmes faqes së internetit të UET-it. Në çdo fillim semestri, studentët informohen për programin e lëndës, i cili u vihet në dispozicion.

Studentët informohen gjatë orëve të Tutoriatit dhe Këshillimit Akademik, ku ata mund të sqarohen për çdo paqartësi që kanë në lidhje me sistemin e studimeve dhe programin mësimor dhe mund të marrin asistencën e nevojshme për mbarëvajtjen e studimeve të tyre.

g) Përfshirja e studentëve në përmirësimin e programeve, të procesit të mësimdhënies dhe përfaqësimi i tyre në strukturat qeverisëse të UET-it

Gjatë periudhës 2006-2009, përfshirja e studentëve në procesin e hartimit dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programeve mësimore ka qenë një përpjekje konstante dhe e vazhdueshme. Studentët më aktivë dhe më të mirë në mbarim të vitit të parë dhe të dytë, përfaqësues të Këshillit Studentor, të rrjetit të bursistëve të UET-it, studentë të ardhur nga universitete evropiane e amerikane, apo dhe studentë në marrëdhënie pune që njohin nga afër tregun e punës, etj., janë përfshirë në gjithë etapat dhe fazat e diskutimit dhe miratimit të programeve.

Angazhimi i studentëve për të vlerësuar nivelin, përmbajtjen dhe cilësinë e mësimdhënies është zhvilluar nëpërmjet organizimit të katër anketime masive me shumicën dërrmuese të studentëve për të marrë vlerësimet e tyre për përmbajtjen e programit dhe lëndëve të veçanta, metodat dhe metodologjinë e zhvillimit të mësimin, nivelin e komunikimit të pedagogëve, efektivitetin e literaturës së përdorur, cilësinë e zhvillimit të leksioneve dhe seminareve, efikasitetin e aktiviteteve plotësuese, etj. Të dhënat e nxjerra kanë qenë objekt shqyrtimi për përmirësimin e punës.

Përfaqësimi i studentëve në strukturat qeverisëse është realizuar nëpërmjet përfshirjes së përfaqësuesve të tyre në këto struktura. Konkretisht, Presidenti i Këshillit Studentor është anëtar i Senatit Akademik të UET, një përfaqësues tjetër i Këshillit Studentor është anëtar i Rektoratit, tre përfaqësues nga këshillat studentore të fakulteteve janë anëtarë të dekanateve të fakulteteve. Gjithashtu, një student është anëtar në Këshillin e Etikës, një anëtar i Këshillit Studentor është pjesëtar i Komisionit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.



Koment: Aktivizimi i studentëve në organet kolegjiale vendimmarrëse është i rëndësishëm dhe duhet të shtrihet edhe në këshillat e fakulteteve pasi ato të marrin formën e tyre të plotë. Nuk mund të gjykojmë për efikasitetin e pjesëmarrjes së studentëve në të gjitha mbledhjet e organizuara të departamenteve, dekanateve, rektoratit, por i rekomandojmë UET të gjejë forma më efikase për të tërhequr realisht mendimin e studentëve në përmirësimin e jetës akademike si dhe për të gjallëruar aktivitetet socialkulturore të tyre.

7.8 FASILITET, BURIMET MATERIALE, LOGJISTIKA DHE SHERBIMET E TJERA NDAJ KOMUNITETIT.

a) Mjediset dhe asetet e duhura për kryerjen e procesit mësimor: sallat e leksioneve, laboratorët, mjetet e pajisjet për përgatitjen teorike dhe praktike

Në dispozicion të zhvillimit të procesit mësimor janë 23 salla leksionesh dhe seminaresh. Konkretisht, ka 5 salla leksionesh me kapacitet prej 100 vendesh secila, 1 sallë leksionesh me kapacitet 200 vende, 1 laborator informatike me kapacitet 30 vende, 1 sallë seminaresh me kapacitet 20 vende, si dhe 15 salla seminaresh me nga 30 vende secila. Çdo sallë leksioni është e pajisur me tabela porcelani, flip charter, lidhje internet me dhe pa kabëll, kompjuter, video projektor, si dhe me sistem modern fonie fiks dhe të lëvizshëm. Numri maksimal i studentëve që mund të jenë në mësim në të njëjtën kohë është 1200.

Studentët janë pajisur me karta dixhitale studenti, të cilat përmbajnë të dhëna lidhur me identitetin, fakultetin, degën, ID e studentit, si dhe bar kodin, i cili mundëson përfitimin e shërbimeve që ofrohen në UET.

b) Lidhjet me internet, pajisje kompjuterike për stafin e studentët

Në total, në ambientet e UET-it janë rreth 163 kompjutera aktivë, 21 printera, 2 fotokopje, 3 laptopë, 6 projektorë, 6 sisteme fonie, 3 TV, 2 Ëireless Acces Points, etj.

Lidhja me internetin ofrohet në çdo PC në UET, me përjashtim të atyre në sallat të leksionit, ku nuk është parë e arsyeshme të ofrohet. Në shërbim të studentëve është një sallë kompjuterash, ku aktualisht ndodhen 74 të tillë, të lidhur gjithashtu edhe me një printer rrjeti. Një punonjës ndihmon studentët për printimet, si dhe për probleme të ndryshme që mund të hasen gjatë punës së tyre. Edhe në bibliotekë, krahas 2 kompjuterave për punonjësit, ndodhen edhe 5 kompjutera të tjerë në shërbim të studentëve, edhe këta të lidhur me internet. Gjithashtu në ambientet e UET-it ofrohet edhe Internet ëireless falas për të gjithë studentët, si dhe për klientët që frekuentojnë lokalën BAR UET.

Stafit drejtues, akademik dhe administrativ, janë të pajisura me PC dhe printer. Çdo pedagog i brendshëm ka një PC që e përdor vetëm ai. Për pedagogët e jashtëm ka një PC në çdo sallë pedagogësh. Sekretaria qendrore është e pajisur me një PC për çdo sekretare, si dhe tre printera. Edhe zyra ku zhvillohet tutoriati dhe këshillimi akademik është e pajisur me 2 PC dhe një printer.

Sistemi kompjuterik mbrohet nga ndërhyrjet e jashtme me anë të një sistemi mbrojtës të fjalës së fundit të teknologjisë. Gjithashtu në çdo PC është instaluar *McAfee Antivirus*, i cili menaxhohet në mënyrë qendrore nga zyra e IT-së. Shërbimi *Email*, *Fileserver* dhe *Domain Controller* mbulohet me 3 servera, prodhim i fundvitit 2008. Dosja *My Documents* e çdo kompjuteri ruhet në Server për arsye sigurie

c) Libraria, biblioteka dhe kapaciteti i tyre në raport me stafin dhe studentët

Libraria universitare dhe biblioteka janë pjesë e rëndësishme e infrastrukturës mësimore e shkencore të UET-it.

Libraria plotëson përgjithësisht nevojat bazë për tekstet e domosdoshëm mësimorë të përkthyer në shqip dhe leksionet e shumëfishuar që jepen në auditor nga pedagogët, si edhe nevojat për literaturë suplementare pothuajse për të gjitha lëndët që përfshihen në programet mësimore.

Biblioteka ka një sipërfaqe prej rreth 300 metra katror, 6 poste pune me kompjutera për stafin dhe studentët, mundësi lidhje me internet jo-kabllor, si dhe 120 vende studimi. Në ndihmë të studentëve punon një staf i kualifikuar dhe me përvojë. Biblioteka përmban një fond që pasurohet vazhdimisht me tekste mësimore, libra dhe periodikë shkencorë në gjuhën shqipe, por edhe në gjuhë të huaj (kryesisht në anglisht, frëngjisht dhe italisht). Pjesa më e madhe e teksteve dhe monografive që përdoren si materiale bazë, apo rekomandohen në programet mësimore disponohen në disa kopje. Biblioteka ka në fondin e saj mbi 1690 tituj librash (tekste, monografi, manuale, fjalorë, enciklopedi), një pjesë e madhe e të cilave disponohen në më shumë se 3 kopje. Për të përmbushur nevojat e stafit akademik dhe kërkimor-shkencor, biblioteka porosit vazhdimisht tituj të ndryshëm përmes shërbimeve në Internet si amazon.com dhe nga botues të ndryshëm në vende të ndryshëm të Europës dhe në Shtetet e Bashkuara.

Biblioteka e UET-it disponon gjithashtu një koleksion periodikësh shkencorë në fusha të ndryshme, në shqip dhe në gjuhë të huaj, një pjesë e të cilëve janë siguruar përmes abonimit vjetor e në vazhdimësi.

Për t'u ardhur në ndihmë sa më mirë studentëve dhe pedagogëve me literaturë (libra dhe revista akademike) të arkivuar në sistemet e bibliotekave elektronike *Questia* dhe *Jstor*, biblioteka mundëson shfrytëzimin falas të fondeve të këtyre sistemeve.

Në kuadër të Consorciimit Universitar Shqiptar, në të cilin bëjnë pjesë: Universiteti Europian i Tiranës, Universiteti "Polis", Akademia e Filmit "Marubi" dhe Fakulteti i Drejtësisë "Luarasi", bibliotekat e tyre konsiderohen si asete për përdorim reciprok nga studentët që frekuentojnë këto institucione të arsimit të lartë.

Për të siguruar mbulimin e të gjitha disiplinave që zhvillohen në UET, biblioteka e këtij universiteti mban lidhje bashkëpunimi me Bibliotekën Kombëtare, me bibliotekat e disa fakulteteve të Universitetit të Tiranës dhe të disa universiteteve jopublike.

Studentëve u ofrohen shërbime të tjera për studentët: salla studimi, fotokopje, printim, kërkim literature, shërbim informacioni, stafi i shërbimit etj. Salla e kompjuterave është në dispozicion të studentëve çdo ditë të javës. Studentët kanë në dispozicion 80 poste pune, internet pa limit, si dhe printerat për të printuar materialet mësimore. Këtu ata asistohen nga një staf i specializuar.

f) Shërbime të tjera për stafin dhe studentët: mjedise sportive, çlodhëse, argëtuese etj.

Për krijimin e një ambienti sa më komod dhe funksional, në ambientet e UET-it ndodhet një bar, i cili ofron shërbimet bazë për plotësimin e nevojave të stafit dhe studentëve. Këto ambiente janë të hapura dhe pa pagesë për studentet dhe stafin në rastin kur ata zhvillojnë evenimente argëtuese. Në shërbim të studentëve dhe stafit është edhe restoranti i shkollës, i cili ofron ushqim cilësor dhe me kosto relativisht të ulët. Në total këto ambiente kanë një sipërfaqe prej 500 metra katrorë dhe një kapacitet prej 160 vendesh. Në mjediset përreth shkollës ofrohet parkim me një kapacitet prej 130 vende parkimi.



g) Shërbime të tjera për komunitetin: informacion, marrëdhënie më publikun, shërbime për të tretë etj.

Universiteti European i Tiranës kryen këto shërbime ndaj komunitetit:

1. Mbështetjen e studentëve nga shtresat më të pafavorizuara dhe të diskriminuara të shoqërisë.
2. Mbështetjen e studentëve që kanë vuajtur pasojat e tragjedive familjare ose kolektive.
3. Mbështetjen ndaj shkollave të mesme në rritjen e kapaciteteve të tyre mësimdhënëse.
4. Orientimin e maturantëve për të kuptuar sistemin e arsimit të lartë, Procesin e Bolonjës si dhe përputhjen e studimeve të larta me tregun e punës.
5. Sponsorizim i veprimtarive kulturore: ekspozita pikturore, fotografie dhe instalacioni në mjediset e tij, qoftë për studentë të tij, qoftë për krijues jashtë universitetit.
6. Dhurim vullnetar i gjakut për fëmijët talasemikë.

7.9 FINANCIMI DHE MENAXHIMI I BURIMEVE FINANCIARE.

Veprimtaria e FJ financohet nga shoqëria "U.E.T" shpk, e cila si burim financiar ka të ardhurat nga veprimtaria arsimore që ndahen në tre kategori:

- Në të ardhurat të vitit korent
- Të ardhura të marra në avancë
- Financimi me anë të kresidë nga banka dhe interesat bankare.

Në gjithë procesinin e financimit dhe të menaxhimit të burimeve financiare u vu re një transparencë e plotë.

7.10 SISTEMI I BRENDSEHM I SIGURIMIT TE CILËSISË.

Në UET është ngritur Komisionit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (KSBC) dhe në statut dhe rregullore janë përcaktuar përgjegjësitë dhe funksionet e tij. Deri tani ky komision ka patur funksionet e grupit të vlerësimit të brendshëm dhe ka funksionuar si i tillë. **Deri tani në UET është punuar mjaft mirë në hartimin e një dokumentacioni të plotë për të gjitha aktivitetet e procesit akademik që realizon universiteti.** Kjo bën që në të gjitha njësitë bazë dhe njësitë kryesore të punohet me të njejtë rregulla dhe standarde. GVJ ju vunë në dispozicion i gjithë dokumentacioni i hartuar, i cili ishte implementuar gjerësisht. Ne gjetëm që departamentet punonin me këto dokumentacione. Edhe pedagogëve ju jepej dokumentacioni mbi bazën e të cilave orientohej puna e tyre e përditëshme. I gjithë dokumentacioni (në sekretari, protokoll, rektorat, zyrën e kurrikulave, sekretari i përgjithshëm, finance, dekanate dhe departamente) administrohej mjaft mirë. Të gjitha strukturat kolegjinale dhe monokratike kishin të përcaktuar qartë përgjegjësitë dhe autoritetin vendimmarrës. Strukturat ishin të angazhuara në kontrollin e vazhdueshëm të cilësisë. Mekanizmat e kontrollit të cilësisë së procesit mësimor funksiononin rregullisht në të gjitha njësitë.



Koment: Në UET janë institucionalizuar elementë të sistemit të sigurimit të cilësisë, por nuk është ngritur dhe nuk funksionon një sistem i plotë i dokumentuar që të garantojë sigurimin e cilësisë në të gjitha aktivitetet e tij, në përputhje me standardet e sigurimit të brendshëm të cilësisë së ENQAs.

- Kështu është pozitiv fakti që ka politika dhe strategji të shkruara në lidhje me zhvillimin e universitetit, por kjo nuk është e shoqëruar me një program të detajuar edhe me zë të veçantë në buxhet për të arritur objektivat e vëna. Menaxhimi i procesit të hartimit dhe rishikimit të programeve të studimit bëhet nga zyra e zhvillimit të kurrikulave, duke anashkaluar njësitë bazë dhe ato kryesore. Nuk janë përcaktuar procedurat për realizimin e këtij procesi, duke rritur gjithëpërfshirjen e stafit akademik në procesin e projektimit të programeve të reja të studimit si dhe tërheqja e programuar e nevojave të tregut.
- Në UET nuk ka kritere për kontrollin e hyrjeve në universitet, për të bërë të mundur arritjen e cilësive të kërkuara në dalje. Procesi i regjistrimit të studentëve është i rregullt dhe i dokumentuar konform me kërkesat e legjislationit tonë. Regjistrat themeltar janë të plotësuar në rregull që tregon se i është kushtuar një rëndësi e veçantë krijimit, mirëmbajtjes dhe ruajtjes të sistemit të të dhënave. Përgjegjësitë për këtë janë të përcaktuara dhe administrata është e përgjegjshme për punën e saj.
- Në Institucion ishte institucionalizuar procesi i marrjes së feedbackut nga studenti. Janë realizuar anketime dhe rezultatet e tyre janë përpunuar nga administrata qendrore. Rezultatet e tyre kanë qenë objekt i analizës vjetore të procesit mësimor. Kontrolli i procesit mësimor realizohet edhe nëpërmjet monitorimeve të vazhdueshme të realizuara nga departamenti, dekanati dhe sekretaria mësimore.
- Në statutin dhe rregulloren e studimeve një vëmendje e veçantë i kushtohet kontrollit të dijeve të studentëve. Forma e vlerësimit të dijeve të studentëve për çdo lëndë është e përcaktuar në syllabuset e programit të studimit, ku provimit përfundimtar i lihet rreth 40% të vlerësimit total. 60% të vlerësimit e zë vlerësimi që merr studenti përgjatë kontrolleve të ndërmjetme të kryera gjatë vitit në lëndën përkatëse si dhe vlerësimet e marra në esse. Sistemi i vlerësimit të dijeve është i mirëmenaxhuar, çdo vlerësim i ndërmjetëm linte gjurmë dhe nuk kishte rrjedhje të informacionit gjë që mund të çonte në inflacion të notës.
- Sistemi i informimit të studentëve është ngritur dhe funksionon mirë. Tutorati i studentëve dhe këshillimi akademik është institucionalizuar,
- Cilësia arrihet kur stafi ka nivelin e kualifikimeve dhe kompetencat për të përballuar mësimdhënjen në fushat përkatëse. Në lidhje me stafin nuk ka politika dhe plane të shkruara për sigurimin e kualifikimit të tij. Ka dëshirë të mirë për të mbështetur financiarisht aktivitetet shkencore të tyre. Egziston mbështetje financiare dhe procedura për botime tekstesh dhe përkthime literature nga shtëpia botuese UET -press, por nuk ka në buxhet ndonjë zë të veçantë për kërkimin shkencor. UET ka bërë përpjekje mjaft të mira për të futur kërkimin shkencor si një nga aktivitetet e kryesore të tij, duke ngritur struktura (institutet dhe qendrat), realizuar aktivitete të ndryshme dhe botuar revista, të cilat quhen shkencore. Por duhet theksuar strukturat duhet të marrin formën e tyre të plotë dhe të përcaktohen qartë raportet ndërmjet këtyre strukturave dhe departamenteve e fakulteteve.
- Institucioni i ka kushtuar vëmendje të veçantë sigurimit të kushteve normale të punës. Infrastruktura që ofrohet për realizimin e procesit mësimor është e mjaftueshme Në lidhje me jetesën, aktivitetet jashtëshkollore dhe kreacionit të studentëve duhet të kushtohet vëmendje më e madhe. UET nuk ofron konvikte për studentët që nuk banojnë në Tiranë.

Koment: KSBC, i cili në bazë të Udhëzimit nr.23 të UET, ka funksionin e kryerjes së vetvlerësimit nuk mund të ketë në përbërje të tij drejtues të njësive që vlerësohen. **Universiteti të marrë masa për**

organizimin më të mirë të KSBC dhe të sigurojë mungesën e konfliktit të interesit në përbërje të GVB.

7.11 BASHKËPUNIMI KOMBËTAR, NDËRKOMBËTAR DHE MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN DHE TREGUN E PUNËS.

a) Bashkëpunimi kombëtar dhe marrëdhënjet me publikun e tregun e punës

Megjithëse UET është një institucion i ri arsimor, i ka kushtuar vëmendje mjaft të madhe krijimit të lidhjeve dhe bashkëpunimit me institucione të tjera të arsimit të lartë si brenda vendit ashtu edhe jashtë vendit. Për t'u përmendur është bashkëpunimi i veçantë dhe i gjerë që realizohet me tre IAL të tjera në kuadrin e Concorsiumit Universitar Shqiptar, të krijuar më 21 shtator 2007. Në këtë konsorcium universitar bëjnë pjesë IAL-të jopublike "Polis", "Luarasi" dhe "Marubi," dhe "UET-i". Përveç kësaj UET ka kontakte me IAL të tjera publike dhe private në vendin tonë, të cilat realizohen në forma të ndryshme, qoftë në formën e shkëmbimit të stafit akademik, bashkëpunimi në fushën e botimeve, në organizimin e konferencave, në shkëmbimin e eksperiencave, bashkëpunimin midis bibliotekave, etj. *Megjithatë GVJ nuk ju vu në dispozicion ndonjë marrëveshje institucionale dypalëshe për bashkëpunim me këto universitete.*

UET ka ngritur edhe një njësi organizative, Zyra e Aktiviteteve, për koordinimin e këtyre aktiviteteve. Çdo aktivitet dokumentohet dhe ruhet në arkiv.

Mobiliteti i stafit akademik të UET-it brenda sistemit të arsimit të lartë të vendit tonë, është realizuar deri tani nëpërmjet angazhimit të tij në dhënien e cikleve të shkëputura të leksioneve apo kurseve të plota në disa universitete të vendit si p.sh., në Universitetin "Fan Noli" në Korçë, Universitetin e Shkodrës "Luigj Gurakuqi", Universitetin Politeknik të Tiranës (Masteri IFG), Universitetin Bujqësor të Tiranës, Universitetin e Tiranës, Polis, "Luarasi", etj.

Bashkëpunimin me institucione të tjera shtetërore dhe komunitetin UET-i e realizon me organizimin e konferencave, takimeve, forumeve universitare dhe ndëruniversitare, në të cilat ftohen pedagogë shqiptarë e të huaj, për të mbajtur konferenca dhe leksione të hapura. Ambientet e UET-it kanë qenë e vazhdojnë të jenë të hapura për ekspozita pikturore e fotografie, koncerte apo shfaqje të tjera artistike, si dhe aktivitete të organizatave të tjera të një profili me interes për fushat e studimit që përfshihen në UET.

Lidhjet me komunitetin e biznesit synohet realizohen me përfshirjen e tyre në hartimin e politikave dhe në hallkat e rëndësishme drejtuese të universitetit. UET ka lidhur memorandume bashkëpunimi apo marrëveshje dypalëshe ku përfshihen krijimi i kushteve të zhvillimit të praktikave, punësim të mëtejshëm të studentëve të diplomuar, bashkëpunime në fushata sensibilizuese në çështje të interesit të përbashkët, etj.

UET të synojë në të ardhmen forcimin e zgjerimin e këtyre bashkëpunimeve dhe komunikimeve me qëllim institucionalizimin e tyre dhe përfshirjen gjithnjë e më shumë në çështje me interes të përbashkët.

Në UET-i është krijuar Zyra e Karrierës dhe Punësimit, e cila grumbullon dhe vë në dispozicion të studentëve të gjithë informacionin e nevojshëm për tregun e punës, si dhe për kualifikime të mëtejshme të ofruara nga institucione arsimore të larta, si ato për nivelin Master dhe Doktoraturë.

Stafi akademik i UET dhe studentët janë pjesë e debateve dhe emisioneve televizive. Anëtarë të stafit akademik dhe studentët janë bërë vazhdimisht pjesë e nismave për të ndihmuar familjet dhe individët në nevojë, si dhe kanë dhuruar gjak në fushatat e ndërmarra nga shoqata.



Handwritten signatures in blue ink at the bottom of the page, including a large signature 'Keb' at the top right, and several other signatures below it, such as 'PW' and 'Geras'.

b) Bashkëpunimi ndërkombëtar

UET-i ka kontakte me disa institucione analoge ndërkombëtare si p.sh., Universitetin e Barit (Itali), Universitetin e Leçes (Itali), Universitetin Ekonomik të Athinës (Greqi); Universitetin e Thesalisë (Greqi), Universitetin e Tetovës (Maqedoni), Universitetin e Ankarasë (Turqi), CIHEAM-IAM Montpellier (France), Universitetin Paris 8 (Francë), Universitetin Paris 10 Nanterre (France), Universitetin e Gjenevës (Zvicër), Universiteti Riinvest (Kosovë), Universitetin "Via del Mar" (Kili), etj.

Me një pjesë të këtyre institucioneve ka filluar procedura e lidhjes së marrëveshjeve të bashkëpunimit reciprok institucional me program dhe objektiva të përbashkëta disa-vjeçare. Me disa prej tyre janë realizuar shkëmbime pedagogësh, vizita studentësh, konsultime për lëndë dhe botime të ndryshme, konferenca të përbashkëta shkencore, etj.

7.12 Analiza SWOT

RVB mbyllet me një analizë SWOT, ku shprehen pikat e forta, pikat e dobëta, oportunitetet dhe kërcënimet. *Megjithëse në këtë analizë të bërë ka elementë që qëndrojnë, GVJ gjykon se përcaktimi i pikave të forta dhe të dobëta nga GVB nuk ka ardhur si rezultat i një analize kritike të gjithë veprimtarisë së universitetit për këto tre vjet. Në përgjithësi raportit i mungon fryma analitike për të përcaktuar se çfarë ka shkuar mirë dhe çfarë duhet përmirësuar. Fryma e raportit ishte përgjithësisht përshkruese, (të dhënat e deklaruara janë korrekte), në disa raste edhe euforike në demonstrimin e arritjeve të universitetit (psh deklaratimet për aktivitetet shkencore). Për më tepër oportunitetet dhe kërcënimet nuk kishin lidhje organike me analizën e pikave të dobëta, gjë që përveç të tjerave e tregon edhe renditja e gabuar që i është bërë kësaj analize (oportunitet – kërcënim – anë të dobëta – anë të forta).*

8. ANALIZA E PROGRAMEVE TË STUDIMIT

8.1 FAKULTETI I SHKENCAVE SOCIALE

UET-i synon të përgatisë studentë të aftë të analizojnë, konkludojnë dhe të debatojnë. Kjo shprehet në vizionin e universitetit, në të cilën shpallet: "Gjate përgatitjes së studenteve do të synohet me shumë perparësi cilësia e informacionit dhe aftësitë analitike – kritike të studenteve." Ky synim mbështetet nga kurrikula e programit të studimit "Marrëdhënie publike-Komunikim", në të cilën ka disiplina të kategorisë A dhe BI, që synojnë të formojnë të menduarin kritik.

8.1.1 Struktura organizative e Fakultetit të Shkencave Sociale

Fakulteti i shkencave sociale është njësi kryesore organizative që ka 2 departamente dhe një qendër kërkimi, Departamentin e Gazetarisë dhe Komunikimit, Departamentin e Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare dhe Qendra e Fakultetit. Fakulteti i shkencave sociale ka filluar aktivitetin si njësi kryesore në vitin akademik 2006-2007 me një staf akademik (efektiv dhe të jashtëm) prej 19 pedagogësh, nga të cilët 9 në Departamentin e Gazetari-Komunikimit dhe 10 në atë të Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare, ndërsa sot janë të angazhuar në mësimdhënie nga ky fakultet 47 pedagogë, nga të cilët 21 në Departamentin e Gazetarisë dhe Komunikimit dhe 26 në Departamentin e Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare. Aktualisht në fakultetin e shkencave sociale janë 16 pedagogë të brendshëm.

Në Departamentin e Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare janë: 9 pedagogë të brendshëm dhe 17 të jashtëm. Nga këta, 1 mban titullin "Profesor" (i jashtëm), një mban titullin "Profesor i



Asociuar" (i brendshëm); 4 janë me gradën "Doktor" (2 të brendshëm dhe 2 të jashtëm), dhe nga 20 lektorët e angazhuar, 6 janë të brendshëm.

Në Departamentin e Gazetarisë dhe Komunikimit aktualisht janë: 7 pedagogë të brendshëm dhe 14 të jashtëm. Nga këta, 1 është me titullin "Profesor", (i jashtëm), 1 me titullin "Profesor i asociuar" (i jashtëm), 4 janë me gradën "Doktor" (të brendshëm), 3 janë në proces doktoreture (2 të brendshëm dhe 1 i jashtëm). Raporti i stafit efektiv/staf i jashtëm të angazhuar në mësimdhënie në programin e studimit "Marrëdhënie publike – Komunikim" është 1:1.6. Ky raport duhet të përmirësohet në drejtim të rritjes së numrit të stafit të brendshëm në nivel universiteti.

Fakulteti i shkencave sociale i plotëson standardet numerike për funksionimin e njësive bazë dhe njësive kryesore.

Numri i studentëve të regjistruar në programet e studimit të ciklit të parë të këtij fakulteti (tre të tilla) ka luhatur nga 114 në vitin akademik 2006-2007 në 181 në vitin akademik 2008-2009, duke dhënë sot një numër total prej 456 studentësh. Nga këta 161 studentë janë aktualisht të regjistruar në programin e studimit "Marrëdhënie publike – Komunikim". Fakulteti i shkencave sociale ka nën administrimin e tij tre programe studimi të ciklit të parë, të aktivizuara që në vitin e parë:

1. DNP "Marrëdhënie publike – Komunikim"
2. DNP "Shkenca politike"
3. DNP "Marrëdhënie ndërkombëtare"

Ndërkohë që një program studimi i ciklit të parë DNP "Gazetari" nuk është aktivizuar për shkak të mungesës së regjistrimeve.

Fakulteti i shkencave sociale administron programe studimi të ciklit të dytë: 3 DND me 6 profile dhe 5 MNP me 10 profile.

Me të gjithë stafin akademik janë lidhur kontratat e punës, të cilat janë kater lloje: i brendshëm, i jashtëm, me ngarkese të vecante, senior (i jashtëm)

GVJ konstatoi se kontratat e hartuara në secilin kategori ishin të sakta. Sipas tyre, për pedagogët e jashtëm pagesa kryhej me dy apo tre instalime, jo mbi baza mujore. Ishte interesante që në kontratë përcaktohej që pedagogët me grada shkencore kishin diferencim dhe kjo vlen për stimulimin e pedagoqeve të rinj në kualifikimin e mëtejshëm të tyre.

Në Fakultetin e Shkencave Sociale është hapur vetëm programi i studimit të ciklit të parë "Marrëdhënieve me Publikun – Komunikim" (MP-K), ndërsa programi i studimit të Gazetarisë nuk ka funksionuar në asnjë nga vitet, megjithatë është e ndertuar si program. Për këtë rrjedhojë, argumentet dhe vlerësimet për akreditim do të behen vetëm për degen e MP-K.

Synimi i DNP të MP-K është "...të përgatise specialiste të nivelit universitar ... të aftë të kryejnë funksione të ndryshme në tregun e punës si specialistë të medias dhe komunikimit."

Numri i studentëve ka ardhur në rritje në këto fakultete (32 për 2006 – 2007; në 60 për 2007 – 2008; dhe në 69 për 2008 – 2009) që tregojnë se tregu i punës ende ka nevojë për profesione të tilla. Kjo ka mundësuar edhe që pranimet në këto fakultete të jenë të hapura. Pranimi realizohet me CV dhe formularin e regjistrimit. Kjo është dëkë pozitive se plotëson tregun e punës, por nga ana tjetër mund të krijojë mundësi për diferencë në nivelin e formimit të atyre që hyjnë në degen e MP-K dhe për rrjedhojë influencën edhe punën që do të duhet të behet me ta gjatë viteve të studimit. Mesatarja e studentëve të



pranuar eshte pothuajse e njejte ne te gjitha vitet pranimet (7,17 per 2006 – 2007; ne 7,03 per 2007 – 2008; dhe ne 7,05 per 2008 – 2009). Ne bisedat joformale me studentet ata e ndjejne nivelin e diferencimit midis tyre ne hyrjen ne keto dege, por natyrisht per ta objektivat jane individuale dhe po keshtu realizimet e tyre. *Per kete faze te objektivave afatshkurter te Universitetit kjo eshte e pershtashme, por nese do te zbatohen synimet afatmesme dhe afatgjata te UET – duke u lidhur me profilin elite, do te ishte e keshillueshme qe te behej me provim hyres.*

Nje pjese e ketyre problemeve kapercehet me renditjen qe behet ne pershkrimet e lendeve per literaturen e detyrueshme, plotesuese dhe te rekomanduar. Ne departamentin e MP-K kjo realizohet per shumicen e disiplineve dhe vlen te veçohet “Bazat e marketingut” dhe “Media marketing”.

Kjo specifikohet edhe ne raportin e vetevleresimit ku citohet se ... “Kështu synohet që studentët me rezultate të larta të kenë mundësi të avancojnë në plotësimin e njohurive dhe aftësive të tyre duke shfletuar literaturë plotësuese dhe të rekomanduar për lëndët që ndjekin, të testohen në mënyrë analitike; nga ana tjetër studentët me rezultate më të ulëta orientohen për literaturën bazë që duhet të shfletojnë, e cila është e domosdoshme të përvetësohet për një rezultat përfundimtar pozitiv, duke i dhënë përgjigje të paktën pyetjeve të provimit për kontrollin e njohurive.”

8.1.2 Programet e studimit, organizimi i kurrikulave, ECTS.

Ne filozofine e ndertimit te tij UET dhe hartimit te kurrikulave ka patur per baze *parimin i interdisiplinaritetit*. Ne departamentin e MP-K zhvillohen gjithsej 45 disiplina, nga të cilat 11 të përbëra; 15 të detyrueshme dhe 30 me zgjedhje, nga të cilat studenti zgjedh 7.

Sipas viteve ato jane te ndara:

Viti i parë : Semestri I: 12 lëndë, nga të cilat 6 të detyrueshme dhe 6 me zgjedhje (studenti zgjedh 1 prej tyre); Semestri II: 9 lëndë, nga të cilat 4 lëndë të detyrueshme dhe 5 lëndë me zgjedhje;

Viti i dytë: Semestri I: 9 lëndë në semestrin e parë, nga të cilat 3 lëndë të detyrueshme dhe 6 lëndë me zgjedhje, Semestri II: 15 lëndë në semestrin e dytë, nga të cilat 4 lëndë të detyrueshme dhe 11 lëndë me zgjedhje.

Viti i tretë: Semestri I: 5 lëndë në semestrin e parë, nga të cilat 3 të detyrueshme dhe 2 me zgjedhje; Semestri II: 7 lëndë në semestrin e dytë, nga të cilat 5 të detyrueshme dhe 2 lëndë me zgjedhje. (Në 5 lëndët e detyrueshme të semestrit të dytë, përfshihet edhe praktika dhe punimi i diplomës.)

Paraqitja e mesiperme eshte ne fakt mjaft interesante per t'u studiuar dhe per t'u vezhguar nga afer. Realisht ne perfundim te studimeve tre vjecare studenti do te kete realizuar gjithsej 22 disiplina, 15 te detyrueshme dhe 7 disiplina te tjera qe ai i ka zgjedhur vete nga oferta qe i ben fakulteti. (Ne disiplinat e detyrueshme hyn edhe praktika dhe punimi i diplomes).

Duke pare se studenti mund te zgjedhe 7 disiplina nga nje variacion prej 28 – 30 disiplinash, kjo ne fakt eshte nje vlere e shtuar per studentin per mundesite qe atij i ofrohen per nje formim sa me te plote ne disiplina te vecanta te interesit te tij. Nga ana tjetere fakti qe 7 disiplina nga 22 ne total jane te lira te zgjidhen nga studentet mund te shkatoje ndryshime ne formimin e studenteve. Ky do te ishte gjykimi i shpejtuar nese nuk do te shikonim edhe permbajtjen se cilat jane lendet, nga te cilat studenti mund te zgjedhe. Ne MP-K lendet nga te cilat studenti mund te zgjedhe jane ne kategorine BIII, C dhe D. (rreth 42 kredite) Edhe brenda kategorise C ka disa kufizime per zgjedhjen. Por nga studimi i lendeve rezulton se te gjitha lendet me zgjedhje jane serish afer profilit qe lidhen me marredheniet me publikun dhe komunikimin. (Me perjashtime te lehta te kategorise D nga e cila zgjidhen 2 disiplina/ 12 kredite).



Handwritten signatures and initials at the bottom of the page, including a large signature on the left, several smaller ones in the middle, and a signature on the right that appears to be 'P.W.' followed by another signature.

Nga vezhgimi i praktikës del se ajo realizohet teresisht në përfundim të vitit të tretë me një kohezgjatje 45 dite. Kjo ka anet e saj pozitive pasi i ndihmon studentet në përgatitjen e punimit të diplomës dhe u jep me shumë njohuri për të hyrë në tregun e punës. **Por sugjerohet një shpërndarje e saj të pakten pjesërisht duke nisur që nga viti i dytë. Kjo pasi megjithë përgatitjen në leksione dhe seminare, deri në fund të vitit të tretë studentet nuk e kanë ndjekur punën reale të një punonjësi të marrëdhënieve me publikun.**

Ne vezhgim teresor përfundimtar, i ndërtuar kështu siç është hartuar, raporti i lendeve të detyrueshme krahasuar me ato me zgjedhje realizon synimin e formimit të punonjësve të marrëdhënieve me publikun dhe të aftë të orientohet në tregun shqiptar sipas standarteve të kerkuara.

Ne pershkrimin e sillabuseve (u pane të gjitha sillabuset me rradhe për degen e MP-K) ato ishin të sakta dhe lendet jepnin një formim të plote teorik dhe me ushtrime praktike për studentet.

Konkretisht po nenvizojmë disa prej tyre:

Në grupin e lendeve të marketingut vecojmë: "Bazat e marketingut" (e detyrueshme); "Media marketing" (e detyrueshme); dhe me pas me zgjedhje mund të merren lende si "Fushatat e marketingut dhe elektorale" (specifike opsionale), apo "Sjellja konsumatore" (specifike opsionale). Kjo krijon një mundësi për njohuri të plota themelore të studentëve në këtë drejtim dhe me pas i profilizon ato për të marrë atë drejtim që ata preferojnë brenda akademit të lëndës. Në të dy lendet e detyrueshme "Bazat e marketingut" dhe "Media marketing" për MP-K është drejtë e vendosur kështu për këtë grup studentësh që synojnë të jenë punonjës të marrëdhënieve me publikun. Literatura e lëndës është nga me të spikaturat e fushës "McGraw Hill, "Advertising, media planing" dhe jep konceptet me kryesore të lëndës. Ajo plotësohet edhe me literature të rekomanduara mjaft e përshatshme për fushën.

Po kështu në grupin e lendeve të komunikimit vecojmë "Teoritë e Komunikimit" dhe "Elementet e komunikimit" që të dyja së bashku japin 12 kredite dhe janë lende të detyrueshme. Nga sillabuset që përshkruajnë kapitujt e lëndës dhe nga literatura rezultojnë synimi për një formim sa më të plotë të studentëve. Ky formim mund të avancojë me pas me grupin e lendeve të detyrueshme specifike "Teoritë e komunikimit".

Mjaft i vlefshëm për studentet është përgatitja në grupin e lendeve "Shkrim Akademik I, II" (e detyrueshme); "Bazat e Semiotikës" (e detyrueshme); "Hyrje në analizën e ligjerimit" (e detyrueshme); dhe me pas "E folura në publik" (e detyrueshme). Nga pershkrimi i lëndës, bisedat me pedagogët dhe literatura e ndarë në kapituj, tregohet se lendet janë mjaft formuese dhe të rëndësishme për studentet.

*Një koment këtu do të vrente të nenvizohej se duke u nisur edhe nga niveli i përvetësimit të gjuhës shqipe, me të cilin studentet vijnë nga shkollat e mesme (gjuha shqipe mesohet deri në klasën e 9-të), është e keshillueshme që këto lende duhet të përfshihen si e detyrueshme në programin mesimor. "Gjuha shqipe e aplikuar" ndodhet në CIII në një grup nga të cilat duhet të zgjidhen 2 dhe mundësia e saj për t'u zgjedhur nga studentet është 1/7. **Kjo lende që është në kuptimin e drejtperdrejtë të fjalës mjet pune për punonjësit e marrëdhënieve me publikun duhet t'i kushtohet shumë rëndësi dhe ndofta të futet në grupin e lendeve të detyrueshme.** Në kurikulen ekzistuese ajo jepet si opsionale në vitin e parë, por gjykojmë se ajo duhet të zhvillohet përpara lendeve si "Shkrim Akademik" që gjithashtu fillon që në vitin e parë.*

Gjithashtu e keshillueshme është që edhe disiplina "Psikologji Sociale" që aktualisht ndodhet tek C1 si disipline integruese të jete tek grupimi i lendeve të detyrueshme. Mendojmë se një student që mbaron marrëdhëniet publike dhe komunikim duhet të ketë formim baze në psikologjinë sociale. Kjo është një përvojë në universitetet perëndimore.

Percaktimi i krediteve per disjplinat e ndryshme ne MP-K eshte bere ne perputhje me udhezimet e Ministrise se Arsimit.

Nga studimi i programeve te disjplinave te ndryshme rezulton se ato permbajne ekstrakte interesante per ato cfare permban lenda dhe jane te pasuruara me literature te detyrueshme, plotesuese dhe te rekomanduara, mjaft te mire per studentet. Librat dhe handout te perkthyer e pasurojne me shume informacionin per studentet.

Sic shkruhet edhe ne rregulloren mesimore te programit te studimit per DNP "Marredhenie Publike – Komunikim" disjplinat mesimore dhe veprimtarite formuese qe ofrohen ne kete program rishikohen ne menyre periodike. Ndryshimet propozohen nga Departamenti i Marredhenieve Publike dhe Komunikimit dhe miratohen nga Keshilli i Fakultetit pas konsultimeve me aktore ne tregun e punes. Per kete arsye UET synon te krijojte "Bordin e tregut te Punes".

8.1.3 Stafi mesimdhenes dhe mbeshtetes

Perzgjedhja e stafit ne UET kryhej ne perputhje me kujdes dhe seleksionim akademik e profesional te kerkeses se larte. Njoftimet per pozicione te hapura ne mesimdhenie beheshin nepermjet faqes se Internetit te UET dhe disa here edhe me njoftime ne media. Stafi i pedagoqeve te MP-K qe ishin ne takim me Grupin e Vleresuesve te Jashtem ishin:

1. Eriona Tartari – diplomuar ne France per letersi moderne, titullare e shkrimit akademik
2. Diana Tershana- diplomuar ne 97 Tirane – anglisht
3. Petro Plasa - diplomuar ne Tirane – anglisht
4. Ledia Rovina – Diplomuar ne komunikim nderkombetar ne Itali – jep te drejte komunikimi
5. Belina Budina – diplomuar per gazetari ne UT dhe Master ne Komunikim ne Kolegjin e Goldsmith, Londerjep edhe te UT teorite e komunikimit
6. Eneida Kellezi – Shefild/ Selanik master in marketing, eksperience me AMC
7. Elena Bozheku - perfunduar studimet ne gjuhësi, ne Universitetin e Bari
8. Mimoza Risto/Dema – anglishte

Ne UET ka ardhur duke u rritur numri i pedagoqeve te brendshem dhe te jashtem si edhe numri i pedagoqeve me grada shencore. Raporti pedagog/student aktualisht eshte ne nivelin 1/3 dhe me tej ne degen MP-K pedagog te brendshem/student, ne 1/8 eshte mjaft pozitiv.

Dosjet e pedagoqeve te MP-K ne zyren e burimeve njerezore ishin te plota me dokumentacionin e duhur si edhe te mireruajtura.

Angazhimi i pedagoqeve te huaj, nga Universitetet Evropiane apo Amerikane ne cikle te vecanta leksione ishte mjaft terheqes per studentet dhe pasuronte edhe njohurite e tyre.

Vlen te vihet re se rreth 46% e pedagoqeve te UET ishin ne moshen deri ne 34 vjec, qe nga nje ane sjell mjaft energji dhe fryme te re ne organizmin e mesimdhenes, por nga ana tjeter sjell edhe nevojën e trainimit te vazhdueshem te tyre dhe kjo sidomos per metodat e mesimdhenes dhe organizimit te saj. Ne UET realizohej paraprakisht njohje/ trainimi i pedagoqeve te rinj kur ata fillonin punen, per te njohur filozofine e universitetit e me gjere. Kjo pervoje pasurohej gjate vitit me bashkebisedime me kolegte e departamentit por gjykojme se duhet shtuar edhe me tej gjate vitit.



8.1.4 Mësimdhënia

Procesi mësimor zhvillohet me leksione, seminare, praktika profesionale, detyra praktike, ese/detyra kursi, provime të ndërmjetëm, provime përfundimtare dhe punim diplome. Mësimdhënia sigurohet nëpërmjet leksioneve dhe seminareve.

Vlerësimi i përgatitjes akademike të studentit mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm. Nota përfundimtare është rezultante e kombinimit të disa elementëve: Provimit përfundimtar (40%), Provimit të ndërmjetëm (30%), Esesë (20%), Nivelit të diskutimit në seminare (10%), Frekuentimit të leksioneve (10 pikë bonus)

Përsa l përket hartimit të tezës së provimit, mesa u vu re, përbëhej nga pyetje që kontrollojnë njohuritë, pyetje që kërkojnë përgjigje analitike si dhe pyetje me zhvillim, në formën e esesë argumentuese. Kjo tezë e hartuar në këtë mënyrë është tërësisht objektive dhe anon nga saktësia maksimale e testimit të njohurive dhe përgatitjes së studentit.

Tezat sekretohen dhe hapen në sekretari. Sic u theksua më lart nota përfundimtare është rezultante e kontrollit të vazhdueshëm.

Shkalla e kalueshmërisë për programin e studimit DNP në Marrëdhënie publike – komunikim në sezonin e provimeve në qershor ishte 71%, ndërsa në sezonin e riprovimeve në vjeshtë arriti në 91% për vitin 2008.

Ndofta duhet rishikuar kufiri i poshtem i kalimit dhe i marrjes se notes kufi. Kalimi i nje disipline me 41 pike eshte i ulet per gjykimin tone dhe ndofta duhet rritur me te pakten 4 pike. Kjo mund te shkaktoje levizje edhe ne notat e tjera por gjykojme qe duhen bere disa ndryshime ne kufinjte e vleresimit.

8.1.5 Kërkimi shkencor, botime

Universiteti me anën edhe të UET Press ka bërë një punë mjaft të mirë në botim/perkthim të librave për studentet. Në degen e MP-K veçojmë "Shkrim akademik", "Komunikim Politik" dhe se shpejt do të botohej "Komunikimi Nderkulturor". Keto janë perkthime nga autore të njohur në fushat perkatese dhe të vleresuara në universitetet e huaja.

8.1.6 Përfundime dhe rekomandime për programin e studimit "Marrëdhënie Publike-Komunikim"

Bazuar në pershkrimin e programit të studimit, organizimi i kurrikulave dhe krediteteve në gjykojme që studentet diplomante të DNP "Marrëdhënie Publike - Komunikim" të UET, kanë formimin e duhur në pershtatje me misionin, objektivat e universitetit dhe ligjet dhe rregulloret e percaktuara nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës në Republikën e Shqipërisë.

Si pika të forta të mësimdhënies në "Komunikim – Marrëdhënie Publike", përmendim:

- Infrastruktura e UET si dhe teknologjia (PC, qendra zëri, internet etj.) bëjnë që mësimdhënia të jetë cilësore dhe me parametra bashkëkohore.
- Pajisja e studentëve me literaturën bazë (një pjesë e së cilës botohet nga UET Press) ndikon në nivelin e studimit dhe formimit të studentëve.
- Format e kontrollit dhe vlerësimi i vazhdueshëm është një çështje themelore për përgatitjen sa më cilësore të studentëve. Përmendim po ashtu dhe esetë e tre niveleve (sipas viteve të studimit), të cilat ndikojnë drejtpërsëdrejti në kërkimin shkencor dhe nxitjen e mendimit kritik tek studentët.
- Kualifikimi shkencor i pedagogëve si dhe mundësia që vetë UET siguron për kualifikimin e mëtejshëm shkencor të tyre, duke i lejuar për një periudhë 6-mujore pagesën pa ndërprerje.

Reb

Pub *gy* *Alis* *A* *PH* *PW* *Genas*

- Mundësia e botimit të revistave shkencore nga vetë UET është akses i mirë për pedagogët.
- Organizimi i takimeve të ndryshme (Auditorium), si dhe leksionet e hapura janë mundësi e mirë për formimin e përgjithshëm të studentëve.
- Biblioteka e pasur është një tjetër akses i mirë për përgatitjen e mëtijshme të studentëve.

Për përmirësimin e mëtijshëm të procesit të mësimdhënies në "Komunikim – Marrëdhënie Publike", përmendim:

- Praktika të mos zhvillohet vetëm në semestrin e 6 me 45 ditë të grumbulluara, por të paktën një pjesë e saj të zhvillohet që në semestrin e 4-t. Kjo, mendojmë se do të jetë më produktive dhe do të bëjë që studentit të njihet me praktikën e komunikimit para se të fillojë vitin përmbyllës të DNP. Gjithashtu kjo mund të japë një shans të mirë edhe në përzgjedhjen e temës së punimit të diplomës.
- Do ishte në të mirë të studentëve që në konferencat shkencore të organizuara nga UET të kishte një seksion vetëm me punimet (referimet) e studentëve.
- Trajnimi i vazhdueshëm i pedagogëve të rinj për metodat e mesimdhënies duhet të forcohet edhe me shume nepermjet ëorkshop apo seminareve. Në UET, sic thesohet nga raporti i vleresimit të brendshëm, rreth 46% e pedagogëve janë në grupmoshën 25- 34 vjeç dhe në departamentin e shkencave të komunikimit pedagogët e rinj kanë lende të rëndësishme profesionale. Kjo është pozitive pasi ata sjellin të reja të degeve specifike për të cilat japin mesim. Por duhet trainuar për metodat e dhenies se njohurive tek studentet.

8.2 Vleresimi i Programeve të studimit "Shkenca Politike" dhe "Marrëdhënie ndërkombëtare"

8.2.1 Struktura organizative e Departamentit SHPMN

Departamenti i shkencave Politike dhe Marrëdhënjeve ndërkombëtare ka pësuar një dinamikë zhvillimi nga krijimi në vitin akademik 2006-2007 deri sot. Kështu stafi akademik (brendshëm dhe i jashtëm) në vitin akademik 2006-2007 përbëhej prej 10 pedagogësh; në vitin akademik 2007-2008 numri i personelit akademik u rrit në 20; për vitin akademik 2008-2009 departamenti numëron një personel akademik prej 26 pedagogësh.

DSHPMN funksionon si departament me disa programe studimi. Puna shkencore e këtij departamenti vlerësohet nëpërmjet Senatit. DSHPMN ka aktualisht 9 pedagogë të brendshëm, (1 Profesor të Asociuar, 2 Doktorë dhe 6 lektorë) të cilët e kanë fituar këtë status në vitin akademik (2008-2009). Në Departamentin e Shkencave Politike dhe Marrëdhënjeve Ndërkombëtare janë 9 pedagogë të brendshëm dhe 17 të jashtëm, prej të cilëve 8 janë femra (3 të brendshme).

Rreth 66 % e pedagogëve efektivë janë në grup-moshën 25-44 vjeç dhe 66 % janë me nivel kualifikimi Master. DSHPMN ka deklaruar se kanë 3 pedagogë me gradë shkencore doktor dhe dy në proces doktorature. Nga verifikimet në zyrën e burimeve njerëzore rezultoi se në dosjet personale të stafit akademik të brendshëm janë depozituar dokumente për mbylljen e Doktoraturave të deklaruara. *Mendojmë se nga pikëpamja numerike departamenti plotëson standardet e kërkuara në ligjin e arsimit të lartë.*

DSHPMN kryesohet nga përgjegjësi i departamentit i cili ka një eksperiencë pune pranë universitetit prej 3 vitesh qysh nga themelimi i tij. Çdo pedagog i brendshëm i departamentit kryen detyrat e mësimdhënies si dhe të pjesëmarrjes në aktivitete shkencore që organizon Fakulteti i Shkencave Shoqërore. Aktivitetet në fjalë i shërbejnë si ndihmë të procesit mësimor, përkundrajt një pagese bazë. Ngarkesa mësimore që kryen pedagogu i jashtëm paguhet me orë mbi ngarkesën mësimore të përcaktuar. Departamenti kryen

- 48 -



analizë të procesit mësimor të paktën një herë në vit me pjesëmarrjen e të gjithë stafit akademik në të cilën diskutohen të gjitha problemet që kanë të bëjnë me procesin mësimor. Pjesë e organizimit të brendshëm të departamentit janë edhe formimi i grupeve akademike-shkencore mbi bazën e lëndëve të përafërta. Objekti i punës së departamentit konsiston në ripunimin dhe miratimin e programeve të lëndëve, ndjekja dhe zbatimi i programeve mësimore, propozimi i strategjisë së zhvillimit, kërkimit shkencor, kalendarit mësimor vjetor dhe organizmi i veprimtarive ekstrakurikulare me studentët.

Mendojmë se mënyra e organizimit të brendshëm të departamentit mbi bazën e grup lëndëve është pozitive. Diskutimi i programeve të lëndës i strategjive të zhvillimit dhe planeve të kërkimit shkencor brenda grup lëndëve dhe departamentit të shkencave politike dhe marrëdhënieve ndërkombëtare është konform me detyrat që duhet të kryejë një njësi bazë shkencore në institucionet e arsimit të lartë.

Numri i përgjithshëm i studentëve të regjistruar gjatë 3 viteve në deget SHP është 101 dhe MN është 178, ndërsa numri i pedagogëve të angazhuar është 26. Raporti pedagog/student është 1 pedagog per 10.7 studentë. Megjithatë, po të mbahet parasysh fakti që një pedagog jep më shumë se një lëndë, raporti student/pedagog është shumë i mire.

Departamenti ka politika të zhvillimit si dhe strategji afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë për arritjen e objektivave të përcaktuara. Strategjitë e departamentit konsistojnë: hapja e programeve të studimit të ciklit të dytë; hapja e programeve të studimit MASTER të nivelit të parë dhe në strategjinë afatgjatë: hapja e programeve të ciklit të tretë duke plotësuar kështu të gjitha ciklet e arsimit të lartë.

8.2.2 Analiza e programeve të studimit.

Programi i studimit në shkencat politike dhe marrëdhëniet ndërkombëtare reflekton një ndërthurje ndërdisiplinore si shkenca politike dhe marrëdhëniet ndërkombëtare. Krahas anëve pozitive që ka një përfaqsim i tillë në formimin kompleks të studentit, kjo është edhe një shpërndarje pozitive e lëndëve. Vlen të përmendim si më poshtë:

- Kombinimi i dy programeve të studimit e justifikon për mendimin tonë titullin "politolog" për një diplomë të nivelit të parë. Një gjë e tillë ka marrë miratimin edhe nga drejtuesit aktualë të Departamentit të Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare të cilët janë të mendimit për një vijimësi të specializimit të dallueshëm brenda Departamentit të Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare, që reflektohet edhe në organizimin funksional të departamentit i cili shoqërohet me krijimin e seksioneve dhe specializimeve brenda departamentit.

Lëndët të cilat janë formuese për secilin nga programet e përmendura janë një mbështetje e mirë që lehtësojnë punën dhe nivelin e përvetësimit të dijeve në lëndët bazë dhe të specialitetit. Programi i ripunuar 2006-2009 i plotëson 180 kredite.

Mësimdhënia është e organizuar në leksione, seminare dhe praktika. 70% të ngarkesë totale e zënë leksionet, ndërsa praktika mësimore zë rreth 20 % të ngarkesës. Stafi akademik efektiv mbulon pjesën më të madhe të ngarkesës mësimore, të formimit bazë dhe lëndë të formimit special (rreth 70%), duke mbuluar në total rreth 45 disiplina të programit të studimit për secilin degë me vete. Konstatohet se stafi i brendshëm mbulon mbi 2/3 e ngarkesës mësimore në përputhje me kërkesat e udhëzimit 30. Procesi mësimor monitorohet në mënyrë të vazhdueshme nga departamenti dhe administrata. Para fillimit të procesit mësimor organizohet puna për rikonfirmimin e programeve të lëndëve, literaturën që do të përdoret. Administrata organizon anketimin e studentëve dhe departamenti realizon analizën semestrale dhe vjetore të procesit mësimor. Këto elementë janë mjaft pozitivë në lidhje me monitorimin e vazhdueshëm të procesit mësimor.

Programi i studimit ka të përcaktuar format e vlerësimit të dijeve të studentëve i cili merr parasysh të gjithë aktivitetin vjetor të studentit. Provimet janë të koduara dhe zhvillohen korrekte sipas orarit të përcaktuar.

 - 49 -

Mënyra e vlerësimit i bëhet e njohur studentit që në fillim të lëndës. Provimet ruhen një vit në arkivin e universitetit. Grupi i vlerësimit konstatoi seriozitetin gjatë zhvillimit të provimit, rregullsi në administrimin e fletëve të provimit si dhe ruajtjen një vit të kontrolleve të ndërmjetme dhe provimeve finale.

Në ciklet e studimeve të dy departamenteve, mendojmë se studentëve u jepet mundësia të njihen me konceptet kryesore të marrëdhënieve ndërkombëtare dhe shkencave politike. Lëndët që zhvillohen në departamentet përkatëse janë të përqendruara në konceptimin e analizave të ndryshme politiko-diplomatike çka e bën studimin e lëndëve përkatëse të perceptueshme nga ana e studentëve (*Tek kjo pikë është marrë për bazë pyetësi i plotësuar nga vetë studentët e marrëdhënieve ndërkombëtare*). Grupi i vlerësimit të jashtëm (Nathanaili-Boriçi) nuk kanë qenë prezentë në ndonjë provim të mbajtur në departamentet në fjalë kështu që kjo pjesë e raportit është bazuar tek pyetësorët)

8.2.3 Stafi mësimdhënës dhe mbështetës

Shumica e stafit akademik është me nivelin MASTER. Stafi akademik i deklaruar i brendshëm nga verifikimet e bëra në zyrën financës figuron si i tillë. Në listën e pedagogëve të angazhuar në mësimdhënie përgjatë të viteve akademike figurojnë emra të njohur për një program studimi tre vjeçar. Universiteti ka ngritur procedurat për rekrutimin e stafit. Pedagogët përzgjidhen me konkurs mbi bazën e kriterëve të miratuar në senatin akademik. Emërimi i pedagogëve bëhet nga rektori dhe administratori.

8.2.4 Programet e studimit

Ne Departamentin e Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Nderkombetare, pjese perberese e Fakultetit te Shkencave Sociale, ka dy Programe Studimi (PS) të veçantë : *Shkencave Politike (SHP)*; *Marrëdhënieve Nderkombetare (MN)*. Secili nga keto PS ka gjithsej 45 disiplina, nga te cilat 11 te perbera, 15 te detyrueshme, 30 me zgjedhje, nga të cilat studenti zgjedh 7. Numri relativisht i madh i lendeve mesimore (45) lidhet me natyren integruese te nje pjese te mire prej tyre te cilat jane te perbashketa ne rang fakulteti dhe universiteti. Kjo eshte pozitive dhe i jep nje kohezion me te madh procesit mesimor per tere universitetin duke u mundësuar studenteve nje mobilitet me te madh dhe formim interdisiplinar. Kjo eshte nje praktike e njohur dhe e zbatuar me teper ne universitet amerikane. Por, do të ishte mirë që, numri i pergjithshem i disiplinave, por edhe i atyre me zgjedhje te ishte me i kufizuar dhe me i fokusuar ne pak drejtime kryesore, ne menyre qe studentet te orientohen me mire ne nje treg pune, qe ne vendin tone nuk eshte dhe aq i zhvilluar dhe divers në kërkesat e tij per keto fusha. Shkencat politike dhe marrëdhëniet nderkombetare, siç dihet kanë natyrë nderdisiplinore. Ato kryesisht mbeshteten në kater fusha kryesore: sociologji, ekonomi, histori dhe drejtesi. Pikërisht keto kater shtylla dhe një raport me i baraspeshuar mes tyre duhet te sherbejne si baze e përcaktimit të lendeve te parashikuara ne planin mesimor te dy degeve, veçanërisht per ciklin e pare te studimeve.

Në këto dy PS, (*SHP dhe MN*), janë të angazhuar një numer i konsiderueshem pedagogesh, të brendshem dhe të jashtem; 51 pedagogë ne SHP dhe 52 ne MN. Pra ka nje mbulim te mire te procesit mesimor me pedagogë, gje mendoj se siguron nje angazhim me serioz te pedagogeve dhe per pasoje dhe nje cilësi me te mire te procesit te mësimdhënies.

Struktura mesimore e PS në dy deget eshte e organizuar ne menyre te specifikuar ne disa kategori lendesh: disiplina te formimit te pergjithshem ose bazë, disiplina te formimit karakterizues ose te detyrueshme, disiplina formuese te ngjashme ose integruese, disiplina formuese te zgjedhura. Kjo menyre jep mundesi per nje formim të pergjithshem por dhe profesional te studenteve. Kjo ndikon pozitivisht ne orientimin me te mire te studenteve ne tregun e punes dhe përzgjedhjet qe behen nga pune marrësit ne drejtim te kërkesave te tyre. Raporti ½ midis lendeve te detyrueshme me ato me zgjedhje duket korrekt, pasi nuk le shumë shteg per shpërndarje te vëmendjes dhe punes se studenteve ne drejtim te orientimit te aftësive te tyre individuale per edukim dhe formim profesional. Pune e tyre individuale stimulohet ne menyre te konsiderueshme gjate zhvillimit te procesit mesimor, duke i dhene perparesi



- 50 -

seminareve, eseve te ndryshme ne raport me aspektin didaktiko-teorik, si leksioni. Numri aktual prej 25 studetesh ne grupet e seminareve eshte nje pike tjetër pozitive e procesit mësimor, gje qe siguron nje pune individuale me cilesore dhe seleksionuese me studentet. Ne kete aspekt, nje vlere pozitive perben dhe literatura relativisht e pasur e bashkekohore qe u rekomandohet studenteve. Ajo mund te gjendet pjeserisht ne Biblioteken e universitetit, por sigurohet nga blerje dhe nxitja e perkthimeve dhe botime nga vete institucioni.

8.2.5 Kërkimi shkencor

Kërkimi shkencor është në fazat e para. Organizimi i stafit të brendshëm ka sjellë përparësi në organizimin e kërkimit dhe studimeve shkencore të mirëfillta në departament. Gjatë tre viteve janë botuar libra dhe revista me karakter politik dhe diplomatik në shërbim të departamentit të Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare. Gjithashtu janë përkthyer libra nga autorë të huaj të cilët janë edhe baza e punës në fushën e shkencave politike dhe marrëdhënieve ndërkombëtare. Megjithëse janë bërë disa deklarime në raportin e vetëvlerësimit në lidhje me realizimin e aktiviteteve të ndryshme kërkimore nuk ka evidenca se në ç'kuadër janë bërë këto aktivitete si dhe kush i ka kryer. Universiteti mbështet financiarisht disa aktivitete si p.sh, pjesëmarrje në konferenca, botime etj., por nuk ka zë të veçantë në buxhet për mbështetje të kërkimit shkencor. Nga ana tjetër detyra parësore e departamentit në këto tre vjet ka qenë stabilizimi i programit të studimit, konsolidimi i aktivitetit mësimdhënës, stabilizimi i stafit dhe puna për të krijuar programe studimi të ciklit të dytë.

Departamenti i Marrëdhënieve Ndërkombëtare dhe Shkencave Politike ka strukturë akademike në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë dhe Kartën e Bolonjës (3+2). Shkolla e Lartë Universitare private Universiteti Europian i Tiranës ka filluar aktivitetin mësimdhënës në vitin akademik 2006-2007 .

Njësia ndjek me vëmendje zbatimin e ligjit dhe akteve nënligjore në fuqi dhe ka ndërmarrë hapa për zbatimin e tyre në praktikë. Ka një vullnet të mirë për të menaxhuar njësinë sipas standardeve ligjore, falë cilësisë së stafit.

Njësia ka bërë përpjekje për rritjen e numrit të stafit të brendshëm akademik.

Departamenti i Shkencave politike dhe Marrëdhënieve ndërkombëtare mbështeten dhe nga 2 qendra kërkimi shkencor. Personeli i brendshëm ka kontratë të rregullt pune me punëdhënësin dhe secili prej tyre punësohet pas kalimit të një procedure të rregullt konkurrimi. Pedagogët synohet të punësohen ne rastin kur ata kanë grada shkencore dhe tituj akademikë, konform ligjeve ne Republikën e Shqipërisë.

Strukturat drejtuese dhe vendim marrëse janë ngritur dhe funksionojnë, por është e nevojshme që zgjedhjet, kompetencat dhe raportet mes tyre të rishikohen në përputhje me ligjin për "Arsimin e lartë" dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij.

Cilësia në hyrje dhe dalje e studentëve kërkon më shumë vëmendje. Ka një procedura të saktë të verifikimit të studentëve në hyrje.

Stafi mësimdhënës dhe mbështetës është me cilësi të mirë. Drejtuesi i njësisë në bashkëpunim me drejtuesit e departamenteve tregojnë kujdes në përzgjedhjen e tyre. Ka pedagogë me tituj dhe grada shkencore dhe një numër i konsiderueshëm pedagogësh në kualifikim të lartë.

Rregulli dhe disiplina karakterizon mësimdhënien dhe kontrollin e dijes. Organizimi formal dhe përmbajtja janë në nivele të kënaqshme.

Administrimi i dokumentacionit të programeve të studimit të shkencave politike dhe marrëdhënieve ndërkombëtare është shumë i mirë. Sekretaria mësimore, salla e internetit janë asete të njësisë. Drejtuesi i njësisë garanton një mbarëvajtje të administrimit të saj.

Njësia ka përditësuar programet mësimore dhe ka treguar kujdes për raportet mes lëndëve dhe për shpërndarjen e krediteve. *Ka nevojë për rishikime dhe një ndarje më të mirë të lëndëve dhe të orëve sipas krediteve të caktuara për lëndë.*

Roli i studentëve në mbarëvajtjen e arsimit ishte i prekshëm, ndonëse ka vend për përmirësime të mëtejshme.

Marrëdhëniet studentë /pedagogë ishin të mira.

Kërkimi shkencor është mjaft modest, megjithatë, ka një vullnet të mirë për të vazhduar rritjen e kërkimit shkencor.

Marrëdhëniet me institucionet e tjera ekzistojnë, por ka nevojë të zgjerohen dhe të institucionalizohen.

Infrastruktura e njësive dhe baza didaktike janë të mira.

Është ngritur mekanizmi i vlerësimit të brendshëm të cilësisë.

Pika të forta të Departamentit të Marrëdhënieve Ndërkombëtare dhe Shkencave Politike të Universitetit:

Procesi i Bolonjës ka ecur përgjithësisht pozitivisht për sa i përket shpërndarjes së lëndëve dhe shpërndarjes së krediteve. Kurrikulat e fakultetit janë bashkëkohore dhe mendojmë se janë në funksion të tregut të punës. Programet dhe mësimdhënia bazohet në programe të veçanta autentike por dhe të mbështetura nga universitete të huaja.

Numri relativisht i madh i lendeve mesimore me natyrë integruese, të cilat janë të perbashketa në rang fakulteti dhe universiteti, është një aspekt pozitiv dhe i jep një kohezion me të madh procesit mësimor duke u mundësuar studenteve një mobilitet me të madh për formimin e tyre.

Angazhimi i një numri të konsiderueshëm pedagogesh, të brendshëm dhe të jashtëm siguron një mbulim të mirë të procesit mësimor me pedagogë, një angazhim serioz të pedagogëve dhe për pasojë një cilësi me të mirë të procesit të mësimdhënies.

Organizimi i strukturës mesimore në disa kategori lëndesh si disiplina të formimit të përgjithshëm ose bazë, disiplina të formimit karakterizues ose të detyrueshme, disiplina formuese të ngjashme ose integruese, disiplina formuese të zgjedhura, jep mundësi për një formim të përgjithshëm por dhe profesional të studenteve.

Raportet midis lendeve të detyrueshme me ato të zgjedhura nuk lenë shteg për shpërndarje të vëmendjes dhe punës së studenteve në drejtim të orientimit të aftësive të tyre individuale për edukim dhe formim profesional.

Infrastruktura, metoda dhe teknologjitë e reja të mësimdhënies janë një pikë e fortë për departamentin e shkencave politike dhe marrëdhënieve ndërkombëtare.

Punë individuale e studenteve stimulohet gjatë zhvillimit të procesit mësimor, duke i dhënë përparësi seminareve, esëve të ndryshme në raport me aspektin didaktiko-teorik.

Numri aktual prej 25 studentesh në grupet e seminareve është një pikë tjetër pozitive e procesit mësimor, gjë që siguron një punë individuale me cilësore dhe seleksionuese me studentet.



- 52 -

Studentët konsiderohen aktorë të rëndësishëm të mbarëvajtjes së procesit mësimor dhe mendimet e tyre vilen rregullisht nëpërmjet procesit të vlerësimit të brendshëm institucional, që organizohet çdo vit mësimor.

Pika të dobëta të Departamentit të Marrëdhënieve ndërkombëtare dhe Shkencave Politike janë:

Proçesi i Bolonjës në të cilin mbështeten departamentet nuk është i ndarë në mënyrë korrekte tek pedagogët 50 me 50 (50% e kohës në mësimdhënie dhe 50% e kohës në hulumtime shkencore).

Raportet pedagog i brendshëm / i jashtëm si dhe pedagog i brendshëm / student ne te ardhmen mund të përmirësohen në përputhje me standardet evropiane.

Numri i pergjithshem i disiplinave, por edhe i atyre me zgjedhje te jetë me i kufizuar dhe veçanërisht më i fokusuar në disa drejtime kryesore, në mënyrë që studentet të jenë me komodë në gjetjen e vendeve të punës, sidomos në vendin tonë.

Literatura politiko dhe ajo diplomatike, vendase dhe e huaj në bibliotekë dhe në librari është e nevojshme të zgjerohet si nga larmia ashtu edhe nga tirazhi.

Pranimi i studentëve në universitet në përgjithësi dhe në Fakultetin e Shkencave Sociale nuk ka kritere. Rekomandojmë që për të arritur synimin e krijimit të një universiteti elitari, vendosja e kritereve të pranimit të jetë një nga pikat kryesore të politikës së universitetit.

8.2 FAKULTETI JURIDIK

8.3.1 Struktura organizative e Fakultetit Juridik

Fakulteti Juridik është një nga njësitë kryesore të këtij Universiteti që bashkërendon mësimdhënien, kërkimin shkencor dhe zhvillimin kulturor në fusha mësimore-shkencore, të përafërta dhe të ndërthurura. Fakulteti ofron programe të studimeve të llojeve dhe niveleve të ndryshme, në përfundim të të cilave përfitohet diplomë. Fakulteti organizohet në njësi bazë. Fakultet ka dy departamente (departamenti i së drejtës private dhe departamenti i së drejtës publike) si dhe Qendrën e Studimeve dhe Trajnimeve Juridike.

Numri i punonjësve mësimdhënës, mbështetës dhe administrativ ka patur rritje në vite. Kështu, në FJ gjatë vitit akademik 2006 – 2007 ishin angazhuar në mësimdhënie 19 pedagogë, në vitin 2007 – 2008 kishte 23 mësimdhënës ndërsa në vitin akademik 2008 -2009 janë gjithsej 28 mësimdhënës.

Studimet organizohet në përputhje me Kartën e Bolonjës sipas sistemit 3+2 dhe që do të vazhdojnë më tej me studimet Master të Nivelit të Parë, të Nivelit të Dytë dhe Doktoraturë.

Në veprimtarinë e tij FJ udhëhiqet nga strategjitë afat-shkurtra (1-3 vjeçare), afatmesme (3-5 vjeçare) dhe afatgjata (6-10 vjeçare). Nga verifikimi në praktikë rezultoi se ky fakultet deri tani ka zbatuar me përpikmëri detyrat e caktuara në përputhje me strategjinë e tij të zhvillimit dhe krijon bindjen për sigurinë e realizimit të suksesshëm të këtyre strategjive në të ardhmen.

Në kohën e kryerjes së vlerësimit Dekan i Fakultetit Juridik është Prof. Dr. Ksenofon Krisafi.

Jeta e brendshme e Fakultetit Juridik të U.E.T rregullohet nga këto dokumente bazë: Statuti i U.E.T; Rregullorja mësimore e programit të studimit; Rregullorja mësimore e programit të studimit; Broshura e dokumenteve në zbatim të statutit dhe rregulloreve bazë të U.E.T; Libri i pedagogut.

Këshilli i Fakultetit është organ kolegjal vendimarrës që përbëhet nga Dekani, Përgjegjësit e Departamenteve dhe Përgjegjësi i qendrës së kërkimit dhe zhvillimit. Këshilli i fakultetit kryesohet nga dekani.

Bazuar në Statutin e U.E.T. autoritetet drejtuese të fakultetit juridik janë:

- a) Dekani
- b) Përgjegjësi i Departamentit



c) Përgjegjësi i Qendrës.

Nga raporti i vlerësimit të brendshëm dhe gjatë takimeve me drejtues të FJ morëm dijeni se Dekani është drejtuesi kryesor dhe emërohet në detyrë nga rektori, me mandat 5 vjet me të drejtë rizgjedhje.

Këshilli Shkencor i Fakultetit është organ kolegjal vendimarrës, më i lartë i cili vendos për problemet më të rëndësishme me karakter mësimor dhe shkencor. Ai propozon programe të reja të studimit dhe të kërkimit shkencor, propozon hapjen, ndryshimin ose mbylljen e departamenteve ose njësive të tjera, shqyrton dhe miraton raportin vjetor të dekanit për veprimtarinë mësimore dhe kërkimin shkencor, programon e përcakton në bazë të propozimeve të departamenteve përdorimin e burimeve njerëzore dhe materialeve në dispozicion të fakultetit si dhe i propozon senatit akademik planin strategjik të zhvillimit të fakultetit duke mbikqyrur realizimin e tij.

Këshilli i fakultetit kryhesohet nga dekani. Siç shihet, Këshilli nuk zgjidhet nga Stafi akademik, administrativ dhe studentor, por emërohet, gjë e cila na duket se vjen ndesh me zhvillimet bashkëkohore në Arsimin e Lartë.

Përgjegjësi i departamentit propozohet nga dekani dhe emërohet nga Rektori. Përgjegjësi i departamentit, si njësi bazë e punës mësimore kërkimore është autoriteti më i lartë për këtë njësi. Përgjegjësi i departamentit duhet të ketë së paku gradën Doktor.

Përgjegjësi i departamentit ka këto kompetenca:

- shqyrton planet mësimore dhe programet mësimore dhe propozon ndryshimet e nevojshme
- shqyrton dhe jep mendim për tekstet mësimore që do të përdoren
- ndjek realizimin e programit mësimor sipas planit të miratuar dhe mbikqyr cilësinë e mësimdhënies
- miraton e siglon tezat e provimeve
- mer pjesë në komisionet e rekrutimit për departamentin që drejton
- bën vlerësimin e pedagoëve të departamentit gjatë vitit akademik dhe për këtë qëllim ndjek zhvillimin e një orë leksioni/seminari në auditor me njoftim paraprak së paku 2 (dy) javë përpara.

Nga RVB dhe nga takimet e marra me drejtues të njësisë mësuam se vendimet për funksionimin dhe drejtimin e shkollës në aspektin mësimor dhe shkencor merren nga autoritetet dhe organet drejtuese të saj. Vendimet që kanë të bëjnë me tarifat e shkollimit, punësimin, pagat, investimet, të ardhurat dhe shpenzimet e shkollës merren në çdo rast nga pronari i shoqërisë tregtare ose administratori i ngarkuar prej tij.

Autoritetet dhe organet drejtuese të shkollës mund të bëjnë vetëm propozime e të shfaqin mendime për problemet ekonomike e financiare.

Politikat që kanë të bëjnë me probleme akademike kanë si vendimarrës drejtuesit akademik. Vendimet e dekanit janë shumë të rëndësishme për mbarëvajtjen e arsimimit në këtë njësi.

GVJ vlerëson ndryshimet që po bëhen në menaxhimin e njësisë dhe hapjen e programve të reja. GVJ rekomandon nevojën e ndarjes së qartë të kompetencave mes organeve drejtuese dhe nevojën e zgjedhjes së tyre sipas kërkesave të ligjit të "Arsimit të Lartë në RSH". GVJ rekomandon nevojën e rishikimit të kompetencave të organeve drejtuese kolegjiale duke synuar rritjen e rolit të Këshillit Shkencor dhe përcaktimin e saktë të kompetencave mes dekanit dhe rektorit. GVJ rekomandon që Këshilli shkencor i Fakultetit të zgjidhet nga stafi akademik. Ai të përbëhet nga persona me tituj dhe grada dhe në trupën e të tij të këtë përfaqësim nga administrata dhe studentët. GVJ rekomandon që të përgatiten rregulla më të rëndësishme për Këshillin e fakultetit.

Nga këqyrja e dokumentave e takimeve, konstatohet se niveli i autonomisë realizohet në dy nivele: akademik (autonomia didaktike e pedagoëve për zhvillimin e lëndës) dhe institucional (financiar – evidente pasi është IAL privat). Pedagogët kanë autonomi didaktike me zhvillimin e lëndës së tyre.

Fakulteti respekton debatin mes pedagoëve dhe strukturave drejtuese. Studentët konsiderohen si aktorë të rëndësishëm të mbarëvajtjes të tërë procesit mësimor. Mendimet e tyre vlerësohen në mënyrë të rregullt mes anketimit të tyre për cilësi të veçanta. Një vlerësim i tillë bëhet në përfundim të çdo lëndë.

Fakulteti mban raporte bashkëpunimi të mira me IAL shqiptare dhe të huaja, por këto marrëdhënie kanë nevojë të zgjerohen dhe të institucionalizohen.

 - 54 -



8.3.2 Analiza e programit të studimit “Juridik”

Fakulteti Juridik i U.E.T. ofron programe studimi në ciklin e parë me kohëzgjatje normale 3 vite akademike dhe që realizohen me së paku 180 kredite.

Diloma e Nivelit të Përë paraqitet si më poshtë:

D.N.P. “Jurist i përgjithshëm” ose i shoqëruar me profilet:

- a) Juridik, biznesi
 - b) Juridik, e drejta publike dhe kushtetuese
 - c) Juridik, e drejta europiane dhe ndërkombëtare
- Juridik i përgjithshëm,

Synon përgatitjen e juristëve në nivelin universitar të karakterit të përgjithshëm, të cilët do të kenë bazat për profesionin e juristit, pjesëtarit të zyrave juridike, konsulent juridik.

a. E drejtë biznesi

Synon t’u japë studentëve përmes grupit të lëndëve opsionale njohuri shtesë lidhur me të drejtën për biznesin, sistemin ekonomik, të drejtat e pronësive, format e reja ekonomike dhe kontraktuale etj.

b. E drejtë publike dhe kushtetuese përmes grupit të lëndëve opsionale njohuri shtesë lidhur me të drejtën publike, të drejtën kushtetuese dhe marrëdhëniet e tyre me sistemin politik

c. E Drejtë europiane ndërkombëtare

Synon t’u japë studentëve përmes grupit të lëndëve opsionale njohuri shtesë lidhur me të drejtën e Bashkimit Evropian, traktatet e BE-së, si dhe të drejtën ndërkombëtare, institucionet ndërkombëtare etj.

Në ciklin e dytë të studimeve parashikohen dy kurse (shoqëruar me profilet përkatëse me kohezgjatje normale dy vite akademike që realizohen me së paku 120 kredite.

Diploma e Nivelit të Dytë organizohet në fushën e të drejtës private dhe të biznesit ose e shoqëruar me një nga profilet:

- a) e drejtë private
- b) e drejtë biznesi

Gjithashtu kjo diplomë organizohet edhe në fushën e të drejtës publike e ndërkombëtare.

Diploma Master e Nivelit të Përë parashikohet në 3 fusha:

- a) e drejtë administrative
- b) e drejtë ndërkombëtare
- c) e drejtë europiane

U.E.T. ka parashikuar studimet dhe në MND dhe ato për Doktorature.

Format e kualifikimit të vazhdueshëm në FJ janë trajnimet dhe kualifikimet profesionale të stafit akademik sidomos lidhur me metodat e mësimdhënies (për pedagogët e rinj) si dhe zbatimin e procesit të Bolonjës.

FJ dhe U.E.T. synon në renditjen si shkollë e lartë elitare në vend.



Studentët në Fakultetin Juridik U.E.T. pranohen më mënyrë të lirë, përveç se fakulteti ka disa kritere të vendosura në përmbushje të qëllimit të vet për të qënë një universitet elitare në të ardhmen.

Shpërndarja e studentëve sipas viteve të studimit tregohet në tabelën e mëposhtme:

Referenca	Viti akademik	Numri i studentëve
1	2006-2007	61
2	2007-2008	179
3	2008-2009	177
Totali		417

Nota mesatare e studentëve të pranuar varion, por është relativisht e ulët rreth 7. Nuk administrohen të dhëna specifike për notën mesatare në dalje të studentëve të FJ. Gjithashtu, kalueshmëria e studentëve në sezonet e rregullta është më e ulët, ndërsa në sezonet e vjeshtës është më e lartë.

Grupi i jashtëm i vlerësimit rekomandon drejtuesve të rishikojnë mënyra e pranimi duke përcaktuar kritere përzgjedheje që të mundësojnë rritjen e cilësisë së arsimit në këtë fakultet. Pranimi i studentëve me notë mesatare të ulët ndikon në cilësinë e arsimit.


- 55 -









Fakulteti bën verifikimin e dokumentacionit të studentëve që rregjistrohen në këtë Fakultet. Procedura është e plotë dhe resepktohet në mënyrë rigoroze.

Nga bisedat dhe këqyrja e dokumentave në sekretarinë mesimore të FD rezultoi se dokumentacioni administrohej shumë mirë dhe në përputhje, me rregullat, por mungonte në formën shkresore vetëm Regjistri i Amzes, ndonëse ekzistonte në trajtë elektronike. Nga drejtuesit na u dha garancia e plotë se brenda disa ditëve do të plotësohej ky regjistër edhe në formë shkresore. (kjo u verifikua në vizitën e bërë në dt.04.06.2009 dhe rezultoi se sekretaria po hidhte të gjitha notat në regjistrin e amzës.)

Nga takimet me studentë rezultoi se ka kërkesë llogarie nga pedagogët gjatë viteve, ç'ka shihet jo vetëm në frekuentimin e leksioneve dhe të seminareve, por edhe në kërkesat e tyre për përdorim literature dhe përgatitjes së esse-ve. Në funksion të kësaj pune, studentët kishin në dispozicion një bibliotekë dhe një sallë me kompjutera, e cila funksionte gjatë orëve të mësimit. Nga vizita e grupit në këto mjedise doli se ishin bërë përpjekje të mira për të pasuruar bibliotekën e universitetit me literatura juridike vendase dhe të huaj, por kjo situatë duhet të përmirësohet, nëse mbajmë parasysh larminë e botimeve, tirazhin e tyre dhe numrin e studentëve.

GVJ është i mendimit se drejtuesit e shkollës duhet të planifikojmë një rritje të fondit për pasurimin e mëtejshëm të bibliotekës dhe të rrisë numrin e kopjeve për titull.

8.3.3 Programi i Studimit, Organizimi i Kurrikulës dhe ECTS.

Programi i studimit fillestar ka pësuar përmirësime pas miratimit të ligjit "Për arsimin e lartë në RSH". Programi përmban lëndë me formim të përgjithshëm, të formimit të veçantë, lëndë integruese dhe me zgjedhje.

Sikurse është theksuar edhe me lart, programet e studimit në Fj janë sipas sistemit 3+2 që vjen në harmoni të plotë me ligjin e Arsimit të Lartë dhe Kartën e Bolonjës.

Leksionet zhvillohen në grupe studentësh në ambiente të paisura me mjetet e nevojshme didaktike. Sallat e seminareve ishin për 20-25 studentë. Fakulteti zhvillon mësimet me orë 60 minuta. Frekuentimi i leksioneve në Fakultetin Juridik është fakultativ, ndërsa frekuentimi i seminareve, i punëve laboratorike dhe praktika profesionale janë të detyrueshme në masën 60% për programet e studimit DNP dhe DND, ndërsa për programet e studimit MNP dhe MND frekuentimi i procesit mësimor është i detyrueshëm në masën 80%.

Vlerësimi i përgatitjes akademike të studentit mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm. Nota përfundimtare është rezultante e kombinimit të elementëve përbërës, e njëjtë për të gjithë programet e studimit.

Aktualisht numri i pedagogëve në Fj është 28, nga të cilët 9 janë të brendshëm. Raporti pedagog/student është 1/13, ndërsa raporti pedagogët të brendshëm/studentë është 1/41. *Ky raport duhet të përmirësohet përmes rekrutimit të pedagogëve të brendshëm në FJ.* Numri i disiplinave që ofrohen në programet e studimit DNP në FJ është 35. Në përgjithësi, pedagogët janë përgjegjës për më shumë se një lëndë. Pedagogët e jashtëm dhe senior janë personalitete të fushave të tyre.

GVJ rekomandon që departamentet dhe dekani të rishikojë shpërndarjen më të mirë të lëndëve dhe të orëve sipas krediteve të përcaktuara në lëndë të ndryshme. Praktikave ekzistuese se një pedagog mund të mbajë deri në katër lëndë mesimore u duhet dhënë fund.

Gjatë vizitës së GVJ iu vunë në dispozicion syllabuset e lëndëve. Ata përmbanin informacionin e nevojshëm për studentët si objektivat, temat dhe literaturën.

8.3.4 Stafi Mësimdhënës dhe Mbështetës

Stafi mësimdhënës është rritur nga viti në vit. Sipas RVB dhe të dhënave shtesë të marra gjatë vizitës rezultoi se në Fakultetin Juridik, aktivizohet një numër i konsiderueshëm pedagogësh, që në total janë 28. Në këtë staf përfshihen pedagogët të jashtëm. Nga këta, 9 janë pedagogë të brendshëm dhe 19 të jashtëm. Ky numër është rritur 2.8 është krahasuar me numrin e personelit akademik të angazhuar në vitin akademik 2006 – 2007, dhe 1.2 herë krahasuar me vitin akademik 2007 – 2008.

Shpërndarja sipas departamenteve, është si më poshtë:

 - 56 -

Në Departamentin e së Drejtës Private janë: 4 pedagogë të brendshëm dhe 5 të jashtëm, nga të cilët 3 janë me gradën "Doktor" (1 i brendshëm dhe 2 të jashtëm). Në këtë Fakultet janë të angazhuar edhe 6 lektorë (3 të brendshëm dhe 3 të jashtëm).

Në Departamentin e së Drejtës Publike janë: 5 pedagogë të brendshëm dhe 14 të jashtëm. Nga këta, 4 janë me titullin "Profesor", (1 i brendshëm dhe 3 të jashtëm), 2 me titullin "Profesor i asociuar" (të jashtëm), 4 janë me gradën "Doktor" (1 i brendshëm dhe 3 të jashtëm), 9 lektorë, 3 të brendshëm, nga të cilët 2 janë në proces doktorature, dhe 6 të jashtëm.

Nga ana e drejtuesve të njesisë bëheshin përpjekje për të angazhuar staf të kualifikuar, kryesisht punonjës të praktikës.

Procedurat e përcaktuara për përzgjedhjen e pedagogëve, pagesa më e mirë e tyre, kushtet e mira të punës që ofrohen, janë disa pika të forta që nxisin angazhimin e punonjësve me përvojë si pedagog të jashtëm pranë këtij fakulteti.

GVJ këqyri dokumentacionin e personelit dhe kontratat e lidhura mes punëdhënësit dhe pedagogëve. Kontrata lidhej për pedagogët e brendshëm dhe të jashtëm. Dokumentacioni administrohej në mënyrë të rregullt nga drejtuesi i njesisë.

8.3.5 Mësimdhënia

Mësimdhënia realizohet nga pedagogë të brendshëm dhe të jashtëm që janë specialistë të fushës. Në mbledhjen e tij, Departamenti përkatës vendos lidhur me angazhimin e pedagogëve (të brendshëm dhe të jashtëm) në procesin e mësimdhënies. Ka një shpërndarje të ngarkesës mes pedagogëve të brendshëm dhe të jashtëm. Njesia ka bërë përpjekje për rritjen e numrit të pedagogëve efektive. Megjithatë, duke pasur parasysh rritjen e numrit të studentëve, të lëndëve dhe të programeve GVJ rekomandon rritjen e numrit të pedagogëve të brendshëm.

Një nga pikat e rëndësishme të FJ është puna me studentët. Është caktuar nga një pedagog, i cili orienton studentët, i informon ato për mësimdhënien dhe përfshirjen e tyre në kërkimin shkencor. Njesia i kushtonte rëndësi kontrollit të mësimdhënies gjatë vitit akademik dhe, sidomos gjatë sezonit të provimit.

Megjithë bazën e mirë didaktike dhe të mësimdhënies, në disa lëndë ka nevojë për përdorimin më të mirë të metodave interaktive, sidomos në orët e leksionit.

Mënyra e kontrollit të dijes në përgjithësi është e mirë. Përsa i përket kontrollit të dijes, gjatë takimeve me studentë rezultoi se ka një kontroll të dijeve që shtrihet gjatë gjithë vitit. GVJ këqyri edhe dokumentacionin lidhur me procedurat e caktimit të komisioneve të provimeve sipas lëndëve. Komisionet përbëhen nga dy pedagogë, me formim në fushë.

Kontrolli i dijes është me provim me shkrim. Nuk ka kontroll dijes mes provimit me gojë. Kontrolli i dijes është gjithëvjetor ku një vend të rëndësishëm zë frekuencimi i seminareve, angazhimi i studentit dhe punimet e ndryshme.

GVJ në takim me grupe studentësh mësoi se në pjesën më të madhe të lëndëve, pedagogët mbajnë parasysh ecurinë e studentit gjatë vitit. Nga anketa me studentë, pohohej se testimet hartohen brenda programit mësimor. Ata u shprehën se pedagogët mbajnë parasysh përgatitjen gjithëvjetore të studentëve.

FJ ka një përvojë të mirë në vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe të pedagogëve të saj. Kjo bëhet me anë të një anketimi anonim që bëhet nga studentët dhe që më pas shërben për vlerësimin e pedagogut nga drejtuesi. Para përfundimit të lëndës, studentët vlerësonin pedagogët lidhur me aspekte të tilla si: organizimi i orës së mësimi, dija që transmetohet, marrëdhëniet studentë pedagogë, vlerësimi, metodat e mësimdhënies, etj.

Gjithashtu duke vlerësuar faktin se studentëve të intervistuar kanë vlerësuar si të arsyeshëm lidhjen e teorisë me praktikën, GVJ rekomandon rritjen aspekteve praktike në lëndën ku mundësitë ekzistojnë.

Lidhja e njesisë me institucionet e tjera jashtë procesit mësimor rezultoi e mirë pasi shumica e pedagogëve të jashtëm të angazhuar janë me përvojë në institucione të drejtësisë.

GVJ rekomandon institucionalizimin e marrëdhënieve me institucionet që mund të kontribuojnë në procesin e mësimdhënies dhe, sidomos në realizimin e praktikave mësimore.

Në takimet e GVJ me studentë të viteve të ndryshme dhe nga këqyrja e anketimeve të zhvilluara me ta nga FJ, rezulton se studentët janë të kënaqur me mësimdhënien, kujdesin e treguar nga pedagogët në referimin e literaturës të detyrueshme dhe fakultative.

Në shërbim të pedagogëve dhe studentëve dhe në funksion të mbarëvajtjes së mësimdhënies, funksionon sekretaria mësimore. Për të rritur trasparancën dhe efektivitetin, ajo ishte e informatizuar. GVJ vizitoi bibliotekën e shkollës dhe rezultoi se biblioteka kishte 1300 kopje botime në shqip dhe në gjuhë të huaj. Krahas kësaj biblioteke, salla e internetit mundësonte akses në disa botime dhe faqe interneti profesionale.

GVJ është i mendimit se është e nevojshme rritja e buxhetit për pasurimin e fondit të bibliotekës dhe shtimi i kopjeve të titujve dhe të legjislacionit shqiptar.

8.3.6 Kerkimi Shkencor

Fakulteti Juridik bën përpjekje për bashkëpunim me institucionet shqiptare dhe të huaja në fushën e drejtësisë.

Ka një politikë të përcaktuar të kërkimit shkencor, që përcaktohet në strategjitë e zhvillimit institucional. Njesia ka një plan afatmesëm dhe afatgjatë të kërkimit shkencor, por ai nuk është i detajuar. Duke qënë një institucion i ri, vëmendja është përqëndruar më shumë në mësimdhënie.

Mësimdhënia bazohet në tekste të përkthyer (si "E drejta romake" etj.), tekste të shkruara nga autorë të FJ. Pedagogët e brendshëm janë përfshirë në kualifikimin shkencor në bazë të programeve të tyre individuale. Në përgjithësi vihej re një shqetësim për kualifikimin e tyre pasuniversitar.

Fakulteti Juridik ka botimin e vet, revistën "Jus & Justicia", revistë e cila është në proces akreditimi për t'u regjistruar si revistë shkencore.

GVJ rekomandon që çdo departament dhe në nivel njesie të hartojnë planin e punës shkencore në nivel njesie, në nivel departamenti dhe planin individual të çdo pedagogu. GVJ rekomandon që plane të tilla të hartohen dhe me pas të miratohen në nivel departamenti dhe këshilli shkencor.

8.3.7 Perfundime

Fakulteti Juridik ka strukturë akademike në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë dhe Kartën e Bolonjës (3+2). Shkolla e Lartë Universitare private U.E.T. i ka filluar aktivitetin mësimdhënës në vitin akademik **2006-2007**. Gjatë kësaj periudhë numri i programeve të studimit ka njohur rritje dhe përmirësime.

Njësia ndjek me vëmendje zbatimin e ligjit dhe akteve nënligjore në fuqi dhe ka ndërmarrë hapa për zbatimin e tyre në praktikë. Ka një vullnet të mirë për të menaxhuar njësinë sipas standarteve ligjore, fale stafit, cilësisë së stafit. Njësia ka bërë përpjekje për rritjen e numrit të stafit të brendshëm akademik.


Numri i përgjithshëm i studentëve është rreth 417 ndërsa numri i pedagogëve të angazhuar është 28. Raporti pedagog të brendshëm/student është 1:41. Megjithatë, po të mbahet parasysh fakti që një pedagog jep më shumë se një lëndë, raporti student/pedagogë është më i mirë. GVJ gjykon se raporti pedagog i brendshëm/studentë duhet të rregullohet dhe një nga mënyrat e përmirësimit të këtij raporti është rritja e rekrutimit të pedagogëve të brendshëm në mësimdhënie.

Fakulteti i Juridik ka dy departamente dhe një qendër kërkimi shkencor. Personeli i brendshëm ka kontratë të rregullt pune me punëdhënësin dhe secili prej tyre punësohet pas kalimit të një procedure të rregullt konkurrimi. Pedagogët synohet të punësohen në rastin kur ata kanë grada shkencore dhe tituj akademikë, konform ligjeve në Republikën e Shqipërisë.

Strukturat drejtuese dhe vendimarrëse janë ngritur dhe funksionojnë, por është e nevojshme që zgjedhjet, kompetencat dhe raportet mes tyre të rishikohen në përputhje me ligjin për "Arsimin e lartë" dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij.

Pranimet e studentëve janë të lira, edhe pse ka disa kritere specifike për pranimin e tyre. Cilësia në hyrje dhe dalje e studentëve kërkon më shumë vëmendje. Ka një procedura të saktë të verifikimit të studentëve në hyrje.

Stafi mësimdhënës dhe mbështetës është me cilësi të mirë. Drejtuesi i njesisë në bashkëpunim me drejtuesit e departamenteve tregojnë kujdes në përzgjedhjen e tyre. Ka pedagogë me tituj dhe grada shkencore dhe një numër i konsiderueshëm pedagogësh në kualifikim të lartë. Rregulli dhe disiplina



karakterizon mësimdhënien dhe kontrollin e dijes. Organizimi formal dhe përmbajtja janë në nivele të kënaqshme. Administrimi i dokumentacionit të shkollës është shumë i mirë. Sekretaria mësimore, salla e internetit janë asete të njesisë. Drejtuesi i njesisë garanton një mbarrëvajtje të administrimit të saj. Njesia ka përditësuar programet mësimore dhe ka treguar kujdes për raportet mes lëndëve dhe për shpërndarjen e krediteve. Ka nevojë për rishikime dhe një ndarje më të mirë të lëndëve dhe të orëve sipas krediteve të caktuara për lëndë.

Roli i studentëve në mbarëvajtjen e arsimimit ishte i prekshëm, ndonëse ka vend për përmirësime të metejshme. Marrëdhëniet studentë /pedagogë ishin të mira.

Kërkimi shkencor është ende modest, megjithatë, ka një vullnet të mirë për të vazhduar rritjen e kërkimit shkencor.

Marrëdhëniet me institucionet e tjera ekzistojnë, por ka nevojë të zgjerohen dhe të institucionalizohen.

Pika të forta të Fakultetit të Juridik janë:

- Procesi i Bolonjës ka ecur pozitivisht dhe kjo përbën punën më të fortë për akreditimin e FJ të U.E.T.
- Kurikulat e fakultetit janë bashkëkohore e në funksion të tregut të punës.
- Programet mësimore vlerësohen pozitivisht. Mësimdhënia bazohet në programe të përditësuara dhe të mbështetura në programet e FJ por edhe të fakulteteve të tjera vendase e të huaja.
- Fakulteti Juridik garanton infrastrukura, metoda dhe teknologji të reja të mësimdhënies.
- Sistemi i informacionit është i përshtatshëm dhe aksesit në internet u garantohet si personelit akademik dhe administrativ dhe studentëve.
- Administrimi i dokumentacioneve nga stafi administrativ është korrekt.
- Studentët konsiderohen aktorë të rëndësishëm të mbarëvajtjes së procesit mësimor dhe mendimet e tyre vilen rregullisht nëpërmjet procesit të vlerësimit të brendshëm institucional, që organizohet çdo vit mësimor.

Pika të dobëta të Fakultetit Juridik janë:

- Cilësia relativisht e ulët e studentëve që pranohen në Fakultet, gjë që nuk pajtohet me ambicjet serioze të tij për të qënë një fakultet juridik elitar.
- Raportet pedagog i brendshëm/ i jashtëm si dhe pedagog i brendshëm/student duhet të përmirësohen në përputhje me standartet e B.E.
- Literatura juridike vendase dhe e huaj në Biblioteke dhe në Librari duhet të zgjerohet si nga larmia ashtu edhe nga tirazhi.
- Praktika mësimore profesionale meriton vëmendje të veçante në funksion të formimit profesional të tregut të punës.


8.3 Fakulteti Ekonomik

8.3.1 Struktura Organizative e Fakultetit Ekonomik

Fakulteti Ekonomik u krijua në vitin akademik 2007-2008 dhe kishte një personel akademik (efektiv dhe të ftuar) prej 12 anëtarësh, nga të cilët 8 në Departamentin Financë dhe Banka dhe 4 në Departamentin Biznes dhe Administrim. Këtë vit akademik ky numër është rritur në 56, nga të cilët 45 në Departamentin Ekonomi dhe Financë dhe 11 në Departamentin Biznes dhe Administrim. Ky shpërpjesëtim i numrit të personelit akademik në dy departamentet e këtij Fakulteti, vjen si pasojë e numrit më të lartë të studentëve të regjistruar në programin e studimit Financë-Banka, krahasuar me numrin e studentëve që ndjekin programin e studimit Menaxhim biznesi, dhe mos-hapjes së programit të studimit DNP në Administrim Publik.

Shpërndarja e stafit të brendshëm akademik sipas departamenteve, është si më poshtë:

Në Departamentin Ekonomi dhe Financë janë: 4 pedagogë të brendshëm (2 prof.as, 2 lektor).



Në Departamentin Biznes dhe Administrim janë: 6 pedagogë të brendshëm (2 Dr, 4 lektor)

Regjistrimet e studentëve sipas viteve janë si më poshtëvijon:

Fakulteti	Viti akademik			Totali
	2006-2007	2007 – 2008	2008 - 2009	
Ekonomik	-	74	407	481

Deri tani Fakulteti Ekonomik nuk plotëson standardet numerike për funksionimin si njësi bazë dhe njësi kryesore.

Fakulteti drejtohet nga dekani, i cili është me titullin Prof.As. Përgjegjësat e departamenteve kanë të paktën titullin doktor. Pranë fakultetit është ngritur edhe një qendër kërkimi, e cila është në proces formësimi e sipër. Qendra kishte vetëm një drejtues. Këshilli i Fakultetit përbëhej nga dekani, shefat e departamenteve dhe një student. GVJ sugjeron që t'i kushtohet vemendje plotësimit të standardeve numerike të stafit akademik të brendshëm dhe të merren masat për rikompozimin e këshillit të fakultetit me përfaqësues nga të gjitha njësitë bazë dhe stafi administrativ e përfaqësues të studentëve nga të gjitha ciklet e studimit.

8.3.2 Analiza e programeve të studimit

Në faqen 36 të Raportit të vetëvlerësimit, thuhet shprehimisht që “programet e studimit Ekonomik dhe Administrim Publik nuk janë hapur si pasojë e mungesës së kërkesave për regjistrim”. Në faqen 29 të të njëjtit Raport, në Tabelën: Studentët e regjistruar sipas programeve të studimit dhe vitit akademik, në kolumnën “Vazhdojnë studimet”, në degën “Ekonomiks”, në vitin shkollor 2007-2008 raportohen 2 studentë, ndërsa në vitin shkollor 2008-2009 kjo kategori raportohet me 3 studentë. Në takimet me ekipin drejtues të UET, u tha shprehimisht që sipas rregulloreve të UET, një grup nuk krijohet në qoftë se nuk zgjidhet nga të paktën 15 studentë. Nuk është e qartë si parashikohet të vazhdojnë studimet këta studentë për pjesën e programit që nuk është e ngjashme me ato të degëve të tjera, pa llogaritur që dega nuk deklarohet e hapur.

Duke patur parasysh komentet në paragrafin e mësipërm, gjithë çfarë thuhet në vazhdim në këtë raport u referohet programeve të studimit DNP në Financë e Bankë (FB) dhe DNP në Menaxhim Biznesi (MB).

Programet e studimit që ofrojnë DNP në Financë e Bankë dhe DNP në Menaxhim Biznesi në vitin shkollor 2008-2009 janë në vitin e dytë. Asnjëri prej tyre nuk ka kaluar një cikël të plotë. Të diplomuarit e parë pritet të dalin në vitin akademik 2009-2010.

Diplomat janë ndërtuar me strukturën:

A - Disiplina të formimit të përgjithshëm (bazë) 36 ETC/5 lëndë. 20%

B - Disiplina të formimit karakterizues të programit 90 ETC/9 lëndë. 50%

Nga këto: I. Të detyrueshme për të gjithë: 4 lëndë

II. Të detyrueshme specifike: 3 lëndë.

III. Opsionale specifike: 2 lëndë.

C-Disiplina të ngjashme ose integruese 18 ECT/2 lëndë. 10%

D-Disiplina formuese të zgjedhura/Kurse të lira 12-14 ECT/2 lëndë. 7-8%

E-Veprimtari formuese 18 ECT.

F-Punimi i diplomës. 7 ECT.3-4%.

Duke lexuar përmbajtjen e këtyre kategorive, vihet re se:

Kategoria A është identike për të dy programet DNP (Financë dhe Manaxhim);

Kategoria B I është identike për të dy programet DNP (Financë dhe Manaxhim);

Kategoria B II ka një lëndë identike dhe një pjesërisht të ngjashme për të dy programet;

Kategoria C është identike për të dy programet DNP (Financë dhe Manaxhim);

Kategoria D është identike për të dy programet DNP (Financë dhe Manaxhim);

Kategoria E është identike për të dy programet DNP (Financë dhe Manaxhim).

Në filozofinë e programeve të UET është lëvizshmëria dhe mundësia e zgjedhjes së studentit në disipinat që ofrohen, por nga leximi i kryqëzuar del që nuk ka dallim të konsiderueshëm në ato që ofrohen nga një DNP në tjetrën (për dy diplomat në fjalë). Sikur rastësisht një student në Manaxhim biznesi të zgjedhë në kategorinë C psh lëndët nr 5 dhe nr 6 të kësaj liste (që në fakt kanë të njëjtin numër rendor dhe vlerë kreditesh edhe në listën e kategorisë C të DNP Financë dhe Bankë), formimi i tij do të ndryshojë nga ai i kolegut të diplomuar në Financë vetëm nga 2 lëndë opsionale specifike (B III, max 12 kredite) dhe nga dy lëndë të ndryshme që ka marrë në B II (max 24 kredite), pa përmendur që njera prej këtyre të fundit është pjesërisht e ngjashme (Teori e statistikës dhe statistikë biznesi/statistikë financiare). Pra nga 180 ECT, vetëm 36 kredite diferencojnë programin e studimit DNP Finance&Bankë nga DNP Manaxhim biznesi (pa llogaritur Diplomën).

UET e shoqëron programin e studimit me këshillimin nga pedagogët për përzgjedhjen e lëndëve opsionale. Në këtë mënyrë zgjedhja e lirë e studentëve është e orientuar drejt lëndëve opsionale që përshtaten me profilin e diplomës që do të marrin. Por nga ana tjetër ka kufizimin që një kurs hapet me 15 studentë. Në këtë mënyrë, zgjedhja drejt profilit të kërkuar është e limituar.

Rekomandojmë që të kushtohet vëmendje për të konsoliduar numrin dhe llojin e lëndëve me zgjedhje që ofrohen.

Përputhja me kërkesat e tregut të punës

DNP në F&B dhe MB ofrojnë formim në përputhje me kërkesat aktuale në rritje të tregut të punës për ekonomistë që mund të punojnë në financë apo në manaxhim. Por aktualisht ka një shpërthim ofertash në Arsimin universitar për ekonomistë të kësaj kategorie dhe në një të ardhme të afërt do të ketë një ngopje të tregut. UET do të jetë para sfidës për të përcaktuar se në cilën fashë të këtij tregu do të duhet të specifikohet për të konkurruar.

Programi ka të llogaritura dhe të paraqitura kriteret e transferimit, gjë që e bën të konkurrueshëm me programe të tjera të fushës.



8.3.3 Personeli akademik

Nga takimi i zhvilluar prej grupit të vlerësimit me personelin akademik, rezulton se aktualisht Fakulteti i Ekonomisë ka 11 pedagogë të brendshëm të shpërndarë në dy departamente dhe një qendër studimore. Këta praktikisht mbulojnë të dyja degët Financë dhe Manaxhim. Në Raportin e Vetëvlerësimit, në fq. 45, tabela: Raporti i totalit të numrit të pedagogëve (të brendshëm dhe të jashtëm) me studentët, për kurs studimi, në kollonën "Fakulteti i Ekonomisë" tregon "Pedagogë të brendshëm" për Manaxhim Biznesi 18 dhe për Financë-Banka 17. Vlerësueset mendojnë që është i njëjti grup njerëzish që llogaritet në të dyja.

Duke u mbështetur në tabelën analitike të fq. 111 të Raportit të vetëvlerësimit, e cila duket me afër realitetit të konstatuar, mund të komentohet që raporti pedagogë të brendshëm/pedagogë të jashtëm është jo shumë i favorshëm për përmbushjen cilësore të objektivave të këtyre dy programeve të studimit. UET ka të lidhura 11 kontrata me pedagogë të brendshëm (nga këto 5 femra), 1 me pedagog me ngarkesë të veçantë dhe 12 kontrata me pedagogë të jashtëm, ndërkohë që numri i studentëve pritet të shtohet në këto dy programe studimi. Të gjitha kontratat janë me afat një vjeçar, ose më të shkurtër.

Duke parë CV e pedagogëve të angazhuar në Fakultetin e Ekonomisë mund të vihet re se përveç numrit relativisht të ulët të personelit akademik me grada, të brendshëm e të jashtëm, ka në disa raste edhe një përputhje të diskutueshme midis specializimit të pedagogëve dhe lëndëve që mbulojnë. UET duhet të punojë më shumë për të tërhequr personel akademik me profilizimet përkatëse, i cili nuk mungon në treg.


Ndërkohë UET i ka kushtuar vëmendjen e duhur përgatitjes së personelit akademik duke krijuar mundësi që pedagogë të Fakultetit të Ekonomisë të specializohen e të punojnë për përgatitjen e doktoraturave, etj. E rëndësishme është që orientimi i temave dhe fushave të studimit të jetë në përputhje me orientimet dhe zhvillimet e pritshme të UET, në mënyrë që burimet financiare të përdoren sa më efektivisht.

8.3.4 Mësimdhënia

Mësimdhënia është e organizuar me formën standarde dy semestra për vit shkollor, me lëndë me kohëzgjatje semestrale, me formën leksion/seminar, me shtrirje faktike 60minuta/orë mësimi. Rezulton që përdoren forma të larmishme mësimdhënieje që synojnë integrimin sa më të mirë të studentëve në procesin e nxënies. Nga takimi me studentë të dy viteve, të dy degëve të Fakultetit të Ekonomisë, rezulton se ka vështirësi në pjesëmarrje cilësore të studentëve në lëndë të cilat jepen për të gjitha degët njësoj. Ideja e lëndëve që janë të përbashkëta për disa fakultete, jo medoemos shfaqet në të gjitha rastet në përfitim të studentëve. Ngurtësia e detyruar akademike në lëndë të caktuara, dhe mosndërtimi i kurrikulave me këndvështrim që t'i përshtatet profilit, raportohet nga studentët si pengesë për pjesëmarrjen cilësore në proces.

Në programin e studimit janë parashikuar ngarkesa në auditor dhe jashtë për çdo lëndë. Studentët janë në përgjithësi të kënaqur me metodat e mësimdhënies, të kontrollit të dijeve, të drejtësisë që karakterizon procesin dhe sidomos të vëmendjes që marrin nga pedagogët.

Pjesëmarrja efektive e studentëve në proces sigurohet duke e thyer notën në disa kategori, për të cilat studenti duhet të përgjigjet gjatë simestrit. Në program janë parashikuar kohë të posaçme për feedback dhe ndihmë nga pedagogu i lëndës.



Vlerësueset konstatojnë se tezat paraqiten në përputhje me programin e lëndëve përkatëse, por në disa raste niveli i tyre paraqitet i thjeshtëzuar duke rrezikuar të çojnë në një inflacion të kalueshmërisë së studentëve.

Procesi mbështetet në literaturë në gjuhën shqipe, e cila synohet të silltet tek studenti pas përkthimeve nga literatura më e mirë botërore. Për të dy programet e studimit në këtë Fakultet, vitin e parë dhe të dytë zhvillohen 31 lëndë të detyrueshme dhe 22 me zgjedhje, ndërsa në vitin e trete (që nuk ka filluar akoma) janë 10 të detyrueshme dhe 14 me zgjedhje. Nga informacioni i marrë rezulton që janë të përkthyer dhe të botuara 4 tekste bazë. Lëndët e tjera mbulohen me leksione të parashkruara, me libra të botuar nga pedagoget e jashtëm që japin lëndën, ose botime të tjera. Siç shihet, shkalla e mbulimit me tekste është akoma larg synimeve të vetë UET.

Ky proces është një hap prapa kërkesave, pasi duhej të ishte bërë gati para se të fillonte mësimdhënia dhe jo të kryhej gjatë saj.

Nuk mund të shprehemi për diplomat, pasi Fakulteti i Ekonomisë akoma nuk ka arritur në këto eksperiencë, por nga Raporti i vetëvlerësimit duket që janë parashikuar modalitetet përkatëse.

Biblioteka on-line e vënë falas në dispozicion të studentëve është një pasuri që nuk e gëzojnë të ngjashmit e tyre në universitete të tjera.

8.3.5 Kërkimi shkencor

Kërkimi shkencor është një nga elementet e misionit të UET. Në Fakultetin e Ekonomisë kjo konkretizohet në mënyra të ndryshme, si botimi i Revistës shkencore, inkurajimi i personelit për të marrë pjesë në projekte studimore të iniciuara nga të tjerë, etj. UET ka një predispozicion më të madh ndaj aktiviteteve studimore-shkencore në fusha të tjera. Në atë të ekonomisë, as në Raportin e vetëvlerësimit, as në takimet me personelin akademik të brendshëm nuk rezulton ndonjë aktivitet me peshë i organizuar nga Fakulteti, siç në fakultete të tjera. Ndoshta numri i vogël i personelit akademik të brendshëm, dhe raporti më i madh i atyre pa grada shkencore (vetem 4 punonjës të brendshëm janë me gradën Doktor) pengon organizimet e mëdha cilësore në fushën e ekonomisë. Edhe në opinionin e gjerë, njohja e aktiviteteve të këtij Universiteti në fushën e ekonomisë nuk është shumë e madhe. Më shumë UET gëzon opinion si kontribues në fushat politike. Aktivizimi më shumë në aktivitete shkencore i gjithë forcave kërkimore të brendshme e të jashtme do të rrisë cilësinë e Universitetit në këtë fushë të veprimtarisë.

8.3.6 Studentët

Studentët në UET janë nga gjithë Shqipëria. UET punon për të përhapur imazhin e vet me qëllim tërheqjen e studentëve. Megjithëse në raportin e vetëvlerësimit, në fq 76, në Parimet e pranimit të studentëve thuhet "Nëpërmjet politikave, kritereve dhe procedurave, synohet të përzgjidhen për të vazhduar studimet kandidatet me rezultatet më të larta", nuk mund të thuhet se deri tani ka një politikë të përcaktuar se për cilën kategori të kandidat-studentëve është i interesuar. Shumë shpejt, edhe për arsye që u përmenden më sipër, UET do të duhet të përcaktojë profilin e vet dhe të tërheqë "klientelën" e vet në përputhje me këtë profil. Veçanërisht në Fakultetin e Ekonomisë kjo nevojë megjithëse nuk duket eminente, shume shpejt do të bëhet sfiduese. Janë minimalisht pesë universitete të mëdha vetem në Tiranë që ofrojnë të njëjtin profil formimi.

UET ka të parashikuara qartë kriteret me të cilat pranohen kandidatët.

Nuk mund të vlerësohet cilësia finale e studentëve të Fakultetit të Ekonomisë, UET dhe pranueshmëria e tyre në tregun e punës, pasi asnjë nuk është diplomuar akoma. Edhe të dhënat e kalueshmërisë dhe të notës mesatare janë vetëm në dalje të vitit akademik 2007-2008, pamjaftueshëm për të konkluduar mbi ndonjë tendencë. Vihet re nga të dhënat në fq. 116 të Raportit të vetëvlerësimit, që ka një qëndrueshmëri të mesatares në qershor dhe në vjeshtë. Por edhe kjo kategori ka vetëm dy të dhëna, e pamjaftueshme për të nënkuptuar tendencë.

8.3.7 Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun

Kontaktet dhe bashkëpunimi i Fakultetit brenda dhe jashtë vendit dhe koordinimi i aktiviteteve. Fakulteti ka bashkëpunim me departamentet e tjera brenda universitetit për të realizuar programet e studimit. Ka një angazhim të burimeve të kualifikuara njerëzore të universiteteve publike në procesin e mësimdhënies të programit të studimit të këtij fakulteti.

Mobiliteti i Stafit të Studentëve brenda sistemit të Arsimit të lartë në vend. Mobiliteti i stafit akademik është realizuar nëpërmjet angazhimit në dhënien e cikleve të shkëputura leksionesh apo kursesh të plota në disa universitete të vendit.

Komunikimi dhe bashkëpunimi me institucionet e tjera shtetërore, qeveritare, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë. Ka patur elementë të bashkëpunimit me titullarë institucionesh për probleme të ndryshme të politikës në Shqipëri dhe në rajon.

Bashkëpunimi ndërkombëtar. Ky bashkëpunim është parë në kuadrin e politikës së përgjithshme që ndjek UET. Fakulteti ka marrë pjesë në konferencën shkencore të përbashkët me Universitetin e Tetovës (Maqedoni).

8.3.8 Analize swot për Fakultetin e Ekonomisë

Duke pasur parasysh gjithë sa u konstatua gjatë procesit të vlerësimit, mund të thuhet se FE i UET paraqitet në një situatë që mund të përshkruhet si më poshtë.

Anët e forta (S)

1. Ka një mision të qartë.
2. Punon duke patur në qendër të vëmendjes përmirësimin e cilësisë së shërbimit.
3. Është i orientuar nga klienti (ka përqsasje bashkëkohore në mënyren e bërjes së biznesit).
4. Ka një sistem të brendshëm të kontrollit të cilësisë së mësimdhënies.
5. Ka një sistem treguesish të integruar të kontrollit të dijeve të studentëve.

Anët e dobëta (W)

1. Programet e studimit që ofrojnë DNP në Financë e Bankë dhe DNP në Manaxhim biznesi janë tepër të ngjashme. Diferencimi i tyre bëhet vetëm me lëndë me zgjedhje.
2. Programet nuk janë të provuara akoma në praktikë për vlerën e tyre të plotë. Struktura e tyre është e pakonsoliduar dhe në ndryshim nga një vit në tjetrin.



3. Stafi akademik i angazhuar jo gjithmonë është në fushën e vet të specializimit.
4. Ndarja në seksione është akoma në nivele fillestare duke mos lejuar përqëndrim të ekspertizës akademike.
5. Stafi është kryesisht i jashtëm.

Mendojmë që anët e forta të identifikuara për Fakultetin e Ekonomisë në analizën swot mund të konsiderohen si gjetje pozitive gjatë vlerësimit. Me këtë arsye mund të flitet edhe për anët e dobëta të përfshira në analizën SWOT. Gjithashtu do të donim të vinim në dukje që edhe rreziqet, në qoftë se nuk do të mund të kthehen në oportunitete do të rrezikojnë përmbushjen cilësore të objektivave të FE.

9. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Misioni themelor i UET është aftësimi i studentëve për të analizuar fenomene, ngjarje, koncepte, ligje, politika apo dukuri të caktuara. Produkti që UET-i synon të nxjerrë pas viteve të shkollimit është një student që ka tre karakteristika themelore: 1) ka opinione të forta, 2) di të argumentojë për këto opinione dhe 3) di të ofrojë informacion për argumentet mbi të cilat mbështet opinionet e forta që zotëron. Është ky produkt që do ta diferencojë studentin e UET-it nga studentët e universiteteve të tjerë, veçanërisht nga ata publike.

Struktura organizative është në përputhje me LAL, janë ngritur dhe funksionojnë organet kolegjiale, dhe autoritetet drejtuese, veprimtaria e të cilave rregullohet nga dokumentacioni bazë i universitetit, Statuti, rregulloret e funksionimit dhe mjaft udhëzime të tjera, të cilat janë të miratuara nga senati akademik. Krahas strukturave akademike janë në formim e sipër njësitë e kërkimit (institutet dhe qendrat pranë fakulteteve).

Struktura akademike është në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë dhe Kartën e Bolonjës (3+2). Shkolla e Lartë Universitare private U.E.T. i ka filluar aktivitetin mësimdhënës në vitin akademik **2006-2007**. Gjatë kësaj periudhë numri i programeve të studimit ka njohur ritje dhe përmirësime.

Njësia ndjek me vëmendje zbatimin e ligjit dhe akteve nënligjore në fuqi dhe ka ndërmarrë hapa për zbatimin e tyre në praktikë. Ka një vullnet të mirë për të menaxhuar njësinë sipas standarteve ligjore.

UET kishte një strategji zhvillimi 10 vjeçare, të ndarë në tre faza, e cila orientonte punën e institucionit. Menaxhimi i universitetit deri tani është efektiv, ka një administratë të përgjegjshme që ndjek gjithë punët administrative dhe financiare të institucionit, të cilat dokumentohen dhe ruhen me kujdes.

Megjithëse ka një jetë të shkurtër, UET ka pësuar një zgjerim në programe studimi dhe pranime të studentëve, për të cilat ofrohet një infrastrukturë, literaturë, internet, etj të përshtatshme. Mësimdhënja realizohet në kushte të një monitorimi dhe kontrolli të të gjitha niveleve: lart poshtë, paralel dhe poshtë lart. Metodrat dhe teknologjitë e mësimdhënjes janë bashkëkohore. Janë ngritur dhe funksionojnë mekanizmat e tutoratit dhe këshillimit akademik, këshilli i etikës së bashku me kodin e etikës, komisioni i sigurimit të cilësisë si dhe rregullorja e funksionimit të saj. Universiteti ka vendosur mekanizmat për miratimin e programeve të studimit, për vlerësimin e studentëve, për trajnimet e stafit akademik, ngritjen e funksionimit të sistemit të informimit. Sistemi i dokumentacionit ruhet dhe administrohet me shumë kujdes. Universiteti mbështet të gjithë aktivitetin e tij në rregullore, udhëzime dhe procedura, duke garantuar konsistencë në aktivitetet e përditëshme nga të gjitha njësitë organizative.

Universiteti ka ngritur një infrastrukturë mësimore bashkëkohore, çka dëshmon se financimet që shkojnë për veprimtarinë mësimore dhe kërkimore janë në nivele të kënaqshme.

Në mënyrë të veçantë grupi i vlerësimit të jashtëm evidenton si pika të forta të UET:

- Veprimtaria e Institucionit është e ligjshme dhe e mbështetur në një tërësi dokumentash themelore (Statuti dhe Rregullorja) dhe dokumentash të tjera në zbatim të tyre (rregullore funksionimi të organeve të ndryshme, udhëzues për realizimin e aktiviteteve kryesore). Linja akademike funksionon në përputhje me ligjin e arsimit të lartë. Organet kolegjiale akademike (senati) dhe ato monokratike funksionojnë normalisht dhe janë përgjegjëse për programet e studimit dhe gjithë procesin mësimor. Ngritja e Bordit të Besimit krijon mundësitë e lidhjes së universitetit me tregun e punës.
- Programet e studimit janë të strukturuar mbi bazë të procesit të Bolonjës duke krijuar mundësinë e transferueshmërisë së krediteve. Programet janë bashkëkohore dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës. Kriteret e ndarjes së kreditit në ore mesimi në auditor dhe ore studimi individual janë korekte dhe standarde për çdo disiplinë.
- Drejtimi administrativ i Institucionit është i fortë. Ka një mirëmenaxhim të mirë të gjithë dokumentacionit, evidencave dhe regjistrimeve. Është ngritur njësi për sigurimin e cilësisë (KBSC) dhe janë përcaktuar funksionet e përgjegjësitë e kësaj njësie.
- Janë ngritur mekanizmat e monitorimit dhe kontrollit të procesit mësimor: feedbacku nga studentët, kolegët, drejtuesit, si dhe monitorimi në vazhdimësi i procesit mësimor nga personi përgjegjës për administrimin e procesit mësimor.
- Është ngritur mekanizmi i vlerësimit të dijeve të studentëve që shprehet në programet e lëndëve dhe dokumentohet në regjistrat e vlerësimeve.
- Janë ngritur strukturat për realizimin e studimeve dhe kërkimeve shkencore dhe ka filluar puna në organizimin e këtij procesi të rrëndësishëm. Janë organizuar elementë të kërkimit si botim i katër revistave dhe organizim konferencash.
- Stafi akademik i brendshëm është rekrutuar me kujdes, në bazë të kompetencave të tyre sipas një procesi demokratik e transparent, duke ruajtur raporte pothuajse konstante të tyre me studentët në vite. Stafi trajnohet në lidhje me metodat e reja mësimdhënëse dhe përdorimin e teknologjive bashkëkohore. Stafi akademik i jashtëm përzgjidhet nga kapacitetet më të mira akademiko-shkencore në fushat përkatëse. Raportet e stafit të përgjithshëm akademik me studentët është në përputhje me standardet kobëtare.
- Infrastruktura është e përshtatshme për funksionimn e institucionit dhe realizimin e procesit mësimor (sipërfaqet, auditorët, sallat e kompjuterave, shërbimet e internetit telefonisë, fotokopje). Përdorimi i gjerë dhe ekstensiv të IT dhe të web-sitit shërben për vënien e informacionit në dispozicion të stafit dhe të studentëve.
- Funksionimi i një biblioteke të pasur me hapsira të përshtatshme dhe të mjaftueshme për kapacitete studentore dhe me literaturë të mjaftueshme bashkëkohore; egzistenca e një librarie në shërbim të studentëve si dhe funksionimi i UET-press për të përmbushur të gjitha nevojat për botime të stafit akademik.
- Përfshirja e studentëve në të gjitha nivelet e vendimmarrjes dhe organizimi i tyre në shoqata studentore si dhe roli i tyre në procesin mësimor dhe jo vetëm e identifikon UET si një Institucion që ka në qendër studentin. Janë ngritur shërbimet e këshillimit dhe tutoriatit për studentët duke i ndihmuar ata në rrugën e formimit profesional, por edhe formimin individual e të vazhduar. Është realizuar

mbështetja me bursa dhe subvencionime të studentëve të talentuar dhe në nevojë, organizimi i leksioneve të hapura, ekspozitave, dhe aktivitete të tjera të hapura publike.

- Bashkëpunimi kombëtar e ndërkombëtar

Pikat e dobëta

- Organet kolegjiale vendimmarrëse (senati akademik dhe këshillat e fakulteteve) nuk kanë raporte të përshtatshme përfaqësimi nga stafi akademik, për të siguruar një mekanizëm të balancuar votimi në vendimmarrje. Këshillat e fakulteteve nuk kanë marrë formën e tyre të plotë me përfaqësim nga stafi akademik.
- Standardet numerike për funksionimin e një fakulteti apo departamenti nuk plotësohen nga të gjitha njësitë kryesore dhe njësitë bazë. Përjashtim bën Fakulteti e Shkencave sociale me të dy departamentet e tij, të cilët plotësojnë standardet numerike të njësisë bazë dhe të stafit efektiv me tituj e grada. Raportet pedagog i brendshëm/ i jashtëm si dhe pedagog i brendshëm/student duhet të përmirësohen në përputhje me standartet e B.E. Qendrat dhe Institutet nuk kanë marrë formën e plotë si njësi bazë dhe njësi kryesore.
- Edhe pse Institucioni ka një strategji të qartë 10 vjeçare zhvillimore të plotë, mungon zbërthimi i strategjisë në plane pune konkrete me indikatorë të matshëm, të cilat do të jenë bazë për vlerësimin e efektivitetit të punës së strukturave të UET-it.
- Mekanizmi i hartimit dhe rishikimit të programeve të studimit i është lënë zyrës së zhvillimit të kurrikulave, duke anashkaluar rolin e departamentit dhe të këshillave të fakulteteve. Në statut të rishikohen përgjegjësitë e shprehura në lidhje me hartimin, rishikimin dhe vlerësimin e programeve të studimit.
- Universiteti nuk ka vendosur kriteret dhe tregues sasior e cilësorë përzgjedhës në hyrje për studentët që pranohen në UET, gjë që nuk pajtohet me ambicjet serioze të tij për t'u bërë universitet elitar.
- Në UET funksionojnë shumë elementë të sigurimit të cilësisë, por nuk ka një sistem të mirëfilltë Institucional të sigurimit të cilësisë. Njësia e sigurimit të cilësisë nuk ka marrë formën e saj të plotë për realizimin e funksioneve të saj. Deri tani ka kryer vetëm rolin e grupit të vlerësimit të brendshëm. GVB nuk duhet të përbëhet prej drejtuesve të njësive bazë dhe të administratës së universitetit, pasi ka konflikte të interesit. RVB të bëhen mbi bazë analize të njësive kryesore dhe jo në nivel universiteti.
- Puna kërkimore shkencore nuk është e planifikuar nga njësitë bazë dhe të kalojë në procesin e miratimit të tyre në senatin akademik. Në buxhet nuk ka zë të veçantë për punën kërkimore shkencore të planifikuar. Mbështetja financiare bëhet duke kaluar drejtpërsëdrejti nëpër linjën e administratorit. Në statut dhe rregulloret nuk janë përcaktuar qartë lidhjet ndërmjet instituteve dhe qendrave të kërkimit pranë fakulteteve.
- UET nuk ka plan për mbështetjen e kualifikimit të stafit të ri. Një përqindje jo e vogël e stafit të brendshëm mban një ngarkesë të madhe që përgjithsisht llogaritet me ngarkesë në auditor mbi 300 orë dhe me numër disiplinash që shkon në raste të caktuara edhe deri në 4.

Mbështetur në analizën e mësipërme gjykojmë se Universiteti European i Tiranës është një institucion i arsimit të lartë që ka ngritur punën e tij mbi baza të shëndosha, që ka demonstruar rritje si në sasi (programe studim, numër studentësh), ashtu edhe në konsolidim e institucionit dhe në përmirësimin e proceseve dhe aktiviteteve kryesore të tij, duke dhënë besueshmëri tek

shoqëria se sistemet e ngritura prej tij të sigurimit të cilësisë dhe të standardeve të mësim-dhënies e kërkimit shkencor, garantojnë konsistencë dhe përmirësim të vazhdueshëm të cilësisë në realizimin e misionit të tij.

REKOMANDIME PER PERMIRESIM TE METEJSHEM:

Në funksion të përmirësimit të punës dhe eliminimin e pikave të dobëta të evidentuara, GVJ rekomandon sa më poshtë vijon:

- UET të vendosë në prioritetet e tij plotësimin e standardeve numerike (staf i brendshëm akademik) për funksionimin e njësive kryesore dhe njësive bazë, si dhe konsolidimin e tyre; për të rregulluar standardet në lidhje me shpërndarjen e ngarkesës dhe të mos lejojë pedagogë të japin 5 disiplina. Plotësimi i këtyre standardeve është prioritet me fillimin e programeve të studimit të ciklit të dytë (DND dhe MNP)
- Të përmirësohen raportet e përfaqësimit në senatin akademik për të siguruar një mekanizëm të balancuar votimi në vendimmarrje dhe një përfaqësim më të madh të studentëve. Të saktësohen disa nga funksionet e senatit në lidhje me projektbuxhetin, programet dhe planet disavjeçare të zhvillimit si dhe autoriteti vendimmarrës për këto procese. Të konsolidohen këshillat e fakulteteve duke rishikuar edhe një here përgjegjësitë në lidhje me hartimin, rishikimin periodik dhe ndryshimin e programeve të studimit, duke shmangur përplasjet e përgjegjësive me zyrën e zhvillimit të kurrikulave.
- GVJ rekomandon nevojën e rishikimit të kompetencave të organeve drejtuese kolegjiale duke synuar rritjen e rolit të Këshillit Shkencor dhe përcaktimin e saktë të kompetencave mes dekanit, këshillit shkencor, rektorit dhe senatit akademik.
- Drejtimi i lartë i universitetit të marrë masat për zbërthimin e strategjisë në plane konkrete veprimi, të cilat duhet të jenë të matshme, të monitorueshme dhe objekt i analizave të vazhdueshme.
- UET të bëjë planifikimet e tij të brendshme mbi bazën e mundësive dhe kapaciteteve maksimale të përballimit të fluksit të studentëve për çdo fakultet dhe të përcaktojë për çdo vit numrin maksimal të hyrjeve në universitet. GVJ rekomandon të rishikohet mënyra e pranimit të studentëve duke përcaktuar kritere përzgjedheje që të mundësojmë rritjen e cilësisë së arsimit në këtë UET.
- UET duhet t'i kushtojë rëndësi parësore konsolidimit të instituteve dhe qendrave, saktësisht të funksioneve dhe lidhjes së tyre me Fakultetet dhe departamentet, përcaktimi i fushave studimore dhe të kërkimit të tyre, si dhe mekanizmat financiarë për mbështetjen e tyre.
- Me rritjen dhe konsolidimin e universitetit bëhet e nevojshme krijimi i mekanizmave mjaft të qartë, transparent dhe jodiskriminues për mbështetjen dhe financimin e aktiviteteve shkencore, në të gjitha njësitë e UET si dhe për krijimin e kushteve për kualifikimin e stafit të ri akademik.
- GVJ rekomandon që çdo departament dhe në nivel njesie të hartojnë planin e hollësishëm të punës shkencore në nivel njesie, në nivel departamenti dhe planin individual të çdo pedagogu.
- Universiteti të marrë masa për organizimin më të mirë të KSBC dhe të sigurojë mungesën e konfliktit të interesit në përbërje të GVB. RVB të hartohen mbi bazën e vlerësimit të brendshëm institucional të fakulteteve dhe jo përgjithësuere për universitetin. Raportet të karakterizohen nga një frymë analitike kritikuese dhe t'i shërbejnë vetë institucionit për të përmirësuar punën e tij. UET të punojë për ngritjen e një sistemi të plotë të sigurimit të cilësisë në të gjitha aktivitetet e tij.

Tirane, me 29 qershor 2009



Handwritten signatures in blue ink, including a large signature on the left, a smaller one on the right, and several others at the bottom.